

Në edicionin e XXXV të tij, Salloni i Librit në Torino, një ndër ngjarjet eltrare më të rëndësishme jo vetëm në Itali por edhe në Europë, mirëpret si të ftuar nderi Shqipërinë. Në vijim një bisedë me Kryetarin e Shoqatës së Botuesve Shqiptarë, Petrit Ymeri dhe disa mendime, ide e mejtime për këtë aktivitet nga drejtoresha e QKLL Alda Bardhyli dhe Shkrimtarët Lea Ypi, Bashkim Shehu, Besnik Mustafaj, Ylljet Aliçka dhe Liridon Mulaj.

PËR HERË TË PARË, SHQIPËRIA E FTUAR SI VEND MIK NË SALLONIN E LIBRIT TË TORINOS

Mes shkrimtarëve përfaqësues të letërsisë shqipe janë Besnik Mustafaj, Fatos Kongoli, Ylljet Aliçka, Lea Ypi, Ornela Vorpsi, Gëzim Hajdari, Artur Spanjoli, Durim Taçi, Stefan Çapaliku, Ardian Ndreca, Bashkim Shehu, Virgjl Muçi, Liridon Mulaj, Andreas Dushi e të tjerë.

DEBATI MBI ANTOLOGJINË

Edhe dy fjalë për “Antologjinë e poezisë moderne shqipe” të Rudolf Marku dhe orvatjet e tij për ta mbrojtur me zhurmë e agresivitet proçkën e bërë

PAS PROÇKËS – BROÇKULLA DHE SULMË TË PASKRËPULLTA!

Nga Agim Vinca

(fq. 7)

SHKËMBIM MENDIMESH PËR ANTOLOGJINË

Nga Rudolf Marku

(fq. 9)

MJERIMI I NJË LAUREATI ANTOLOGJIK

Nga Dr. Durim Çaça

(fq. 8)

SHËNIME MBI LIBRAT

Mbi romanin e fundit të Luan Ramës “Një mungesë kaq e gjatë” (*Une si longue absence*)

“REPUBLIKA E KORÇËS DHE FRANCA”

Nga Jean-Paul Champseix

(fq. 5)

Mbi vëllimin poetik “Heraldikët e borës”

NIKO KACALIDHA: AS KAÇAK I VJESHTËS DHE AS HARRAQ I UDHËVE

Nga Fatbardh Amursi Rustemi

(fq. 13)

“Arbëreshët midis realitetit dhe mitit” i autorit Fatmir Toçi

KONTRIBUT PËR NJOHJEN E HISTORISË DHE KULTURËS ARBËRESHE

Prof.Asoc.Dr. Bashkim Vrekaj

(fq. 6)



ÉMILE NELLIGAN


Një nga lirikët më të
mëdhenj të poezisë
frankofone në Kanada

(fq. 14)

Përktheu dhe përgatiti Flurans Ilia

Si i kontrabandoi e bija
e Shagallit pikturat e tij
nga Europa e pushtuar
prej nazistëve

(fq. 22)



FISHTA... AKADEMIKU, “OPERA OMNIA” DHE KOLIQI NDËRMJET

Nga Frano Kulli

Me Gjergj Fishtën, ka ndodhë diçka prej feniksi; një ringjallje prej hirit të vet. Rikthimi ka ndodhë vetvetishëm, si një duf i mbrendshëm, i ndrymë, që shpërthen e përhapet në ajrë sapo të bjerë në kontaktin e parë me lirinë. Kjo ndodhi atëherë, kur agoi sërish liria mbas territ të gjatë të dhunës, në kapërcyellin e vitit '90 të shekullit që shkoi.

(fq. 10)

BIBLIOTEKË

Durim Taçi

(fq. 16)

Lëkura

Timo Flloko

(fq. 18)

Burgu i zemrës

Xhevair Lleshi

(fq. 20)

Tre tregime

Qazim Shehu

(fq. 15)

Pse vonoi ajo grua?

Spiro Qirzidhi

(fq. 12)

Vrasja e pelikanit

Rexhep Polisi

(fq. 17)

Mes brymës së lotit

Prezantohet në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Selanik romani i autorit Ylljet Aliçka, “Valsi i lumturisë” i sapobotuar në gjuhën greke

(fq. 5)

Në kujtim të regjisorit Kristaq Mitro
SHQIPËRI, TI TË VRET!

nga Roland Gjoza

(fq. 21)

ExLibris Forum

PËR HERË TË PARË, SHOQIPËRIA
E FTUAR SI VEND MIK NË
SALLONIN E LIBRIT TË TORINOS

Në edicionin e XXXV të tij, Salloni i Librit në Torino, një ndër ngjarjet eltrare më të rëndësishme jo veç në Itali por edhe në Europë, mirëpret si të ftuar nderi Shqipërinë. Në vijim një bisedë me Kryetarin e Shoqatës së Botuesve Shqiptarë, Petrit Ymeri dhe disa mendime, ide e mejtime për këtë aktivitet nga drejtoresha e QKLL Alda Bardhyli dhe Shkrimtarët Lea Ypi, Bashkim Shehu, Besnik Mustafaj, Ylljet Aliçka dhe Liridon Mulaj

Në Sallonin e Librit të Torinos, Shqipëria si e ftuar nderi përfaqësohet nga disa shkrimtarë të sugjeruar si nga autoritetet brenda Shqipërisë, ashtu edhe nga botuesit e pranishëm aty. Mes tyre ka emra si Besnik Mustafaj, Fatos Kongoli, Ylljet Aliçka, Lea Ypi, Ornela Vorpsi, Gëzim Hajdari, Artur Spanjoli, Durim Taçi, Stefan Çapaliku, Ardian Ndreca, Bashkim Shehu, Virgjil Muçi, Liridon Mulaj, Andreas Dushi e të tjerë. Kalendari i plotë i aktiviteteve gjendet online në faqen zyrtare të *Sallonit*.

Disa nga këto të ftuar si dhe nga organizatorët shqiptarë vijnë në këtë shkrim me mendimet e tyre, idetë e ndjesitë për këtë çast jo të parëndësishëm për letërsinë tonë.

Petrit Ymeri: Me librin ne tashmë jemi në Europë.

Sivjet Shqipëria është vendi i ftuar në Sallonin e Librit të Torinos. Nga ju si kryetar i Shoqatës së Botuesve Shqiptarë, si është prituri kjo ftesë?

Është hera e parë në historinë kulturore të Shqipërisë që ne jemi të ftuar në një aktivitet ndërkombëtar të librit, si Paese Ospite, pra vend mik. Salloni i Librit në Torino është ndër dy-tre ngjarjet librore më të mëdha në nivel europian. Sigurisht kjo është një gjë entuziaste për të gjithë ne botuesit, autorët, edhe për institucionet shtetërore pa dyshim, sepse në fund të fundit është një vlerësim i punës sonë shumëvjeçare. Pa dyshim që edhe Shoqata e Botuesve Shqiptarë, në krah të Ministrisë së Kulturës dhe të Qendrës Kombëtare të Librit, është e angazhuar në punën për paraqitjen e Shqipërisë në Torino. Janë gati 10 shtëpi botuese që do të marrin pjesë në ditët e Sallonit, do ta vizitojnë atë dhe do të jenë sigurisht edhe në pavijonin shqiptar. Do të jenë edhe një grup i madh autorësh që do marrin pjesë në aktivitetet e programuara dhe do të kenë mundësi të shkëmbejnë mendime e përvoja edhe me botues apo kolegë të huaj. Pra mendoj se pjesëmarrja jonë e organizuar atje do të jetë një përvojë shumë e mirë dhe entuziaste.

Çfarë do të thotë për letërsinë shqipe prania e saj në një ngjarje të përmasave të tilla? Mos ndoshta nëpërmjet saj, edhe Shqipëria po i afrohet Europës përherë e më tepër?

Për letërsinë shqipe mendoj se është një konfirmim i punës së mirë që bëjmë të gjithë bashkë, krijuesit dhe botuesit,

por edhe institucionet në përgjithësi. Tashmë janë të shumtë autorët shqiptarë që përkthehen e botohen nëpër Europë. Pra në një kuptim, Shqipëria edhe me këtë pjesëmarrje, edhe me këtë njohje të vlerave krijuese dhe botuese, po bëhet gjithnjë e më shumë pjesë e Europës. Faktikisht, Shqipëria, Shoqata e Botuesve, shtëpi botuese të veçanta dhe autorë, prej shumë e shumë vitesh marrin pjesë në të gjitha aktivitetet ndërkombëtare të librit. Pjesëmarrja e parë e Shoqatës së Botuesve Shqiptarë në Frankfurt që është panairi më i madh botëror, është 30 vjet më parë. Më pas kemi pasur shumë e shumë pjesëmarrje si shoqatë, të shtëpive botuese në panairët ndërkombëtarë edhe në Fankfurt, në Bolonjë, në Paris, në Gjenevë, në Selanik, në Leipzig për 7-8 vjet me radhë etj. Kjo rrugë bashkëpunimi dhe përvoja dëshmon që nëpërmjet librit ne jemi bërë pjesë e Europës, ashtu sikurse jemi bërë pjesë e Europës nëpërmjet bashkëpunimeve të shumta që ka Shoqata e Botuesve dhe shumë shtëpi botuese në projekte të mëdha europiane. Është shumë i rëndësishëm fakti që botuesit shqiptarë, autorët, përkthyesit janë pjesë e bashkëpunimeve të shumta me institucionet europiane që mbështesin botimet, përkthimet, kualifikimet e autorëve dhe përkthyesve, pra pa hyrë në detaje libri shqip dhe institucionet shqiptar të librit, në radhë të parë shtëpitë botuese, janë në Europë gjithnjë e më shumë. Edhe pjesëmarrja në Sallonin e Torinos është një dëshmi e re dhe shumë domethënëse e faktit që me librin ne tashmë jemi në Europë.



Mos ndoshta është edhe rasti të sqarohet, sado pak, lista e shkrimtarëve shqiptarë? Shumë shpesh, përherë në fakt, çdo listë shkrimtarësh që përfaqëson Shqipërinë në një ngjarje ndërkombëtare kontestohet dhe sulmohet, me justifikimin se nuk po shkojnë të duhurit. A ka një përgjigje nga ju për këtë?

Tek ne, sidomos në ambientet krijuese, haset shpesh kundërshtia, përfolja, diskutimi me të drejtë ose jo i shumë zgjedhjeve që bëhen. Mendoj se është normale që gjërat edhe të diskutohen e të thuhet, sepse kjo sigurisht që ndihmon. Për t'u kthyer tek autorët që do të jenë në Torino, unë mund të jap një përgjigje për sa jam në dijeni, pra që ShBSh ka propozuar disa autorë, edhe fituesit e çmimit europian të letërsisë, edhe dy shkrimtarë të rinj Andreas Dushi dhe Liridon Mulaj. Propozimet tona në përgjithësi janë pranuar. Ka edhe shumë autorë të tjerë që do të jenë atje, shkrimtarë të mirë, të njohur, të botuar edhe në gjuhë të tjera. Në dijeninë time, përgjithësisht propozime janë bërë nga Ministria e Kulturës dhe

Qendra Kombëtare e Librit dhe botues të ndryshëm. Më duhet të them që ftesa për pjesëmarrje dhe propozime ka qenë për të gjithë botuesit. Patjetër që mund të ishin edhe të tjerë autorë, por ndofta edhe një situatë nxitimi (sepse përgatitjet u bënë vetëm brenda tre muajve), u bë shkak për vërejtje dhe ndofta kanë të drejtë edhe disa autorë që mund të ishin aty, por çdo gjë është subjektive, është relative.

Panairët ndërkombëtarë janë një mundësi shumë e mirë për autorët: të krijojnë ura të reja komunikimi në gjuhë të tjera nëpërmjet botuesve të huaj si dhe për botuesit: të shërbejnë si ura të reja komunikimi nga autorë ndërkombëtarë. Pa botuesin, autori do ta mbante për vete artin e tij, apo jo? Në kontekstin e Sallonit të Torinos dhe jo vetëm, si një ndër pak botuesit më me eksperiencë dhe histori në Shqipëri, si do ta vlerësonit këtë raport?

Pa dyshim që panairët e librit ashtu sikurse aktivitetet ndërkombëtare janë ura lidhëse dhe komunikimi me kultura të tjera, me vende të tjera, autorë dhe botues të huaj. Dhe është shumë e rëndësishme një gjë që unë e them gjithmonë, botuesit dhe sidomos autorët, duhet të dalin jashtë kuadrantit ku rrojnë zakonisht. Për fat të keq: kuadrantit të vogël. Edhe botuesit mësojnë e përfitojnë shumë nga pjesëmarrjet në panairët e mëdha të librit, nga takimet me kolegët, me shkrimtarët, nga vizitat në stendat e shtëpive të mëdha dhe të vogla botuese, nga marrja pjesë në aktivitetet që bëhen nëpër botë. Pa dyshim, edhe për autorët është e rëndësishme që të kenë pika të tjera kontakti dhe mundësi për të mësuar duke u bërë pjesë apo duke ndjekur aktivitete dhe diskutime të ndryshme. Autorët tanë, përkthyesit, sidomos të rinjtë, duhet të njohin përvoja të reja, edhe të mësojnë në kuptimin e vërtetë të fjalës. Kur të kenë mundësi të ndjekin shkolla apo kurse krijimi, kurse shkrimtarie, që janë kudo nëpër botë. Shkrimtarët apo përkthyesit nuk bëhen dot vetëm me talent, por me shumë punë, por edhe me përgatitje teorike, përgatitje të tjera studimore. Panairët e librit janë ngjarje ku edhe shkrimtari e ndien akoma në fort aromën e krijimtarisë në kulturat e tjera dhe gjuhë të tjera. Edhe nga kjo pikëpamje është shumë e rëndësishme prania atje.

Dhe në fund, meqë jemi te komunikimi ndërmjet letërsive, kulturave dhe gjuhëve, mendoni se është në nivelin e duhur komunikimi ndërkulturore Shqipëri – Botë dhe Botë – Shqipëri? Kemi mbetur peng i dëshirës për simbiozë me perëndrimin në kurriz të lindjes duke e lënë këtë të fundit në heshtje? Apo nga pikëvështrimi juaj çështja është ndryshe?

Më duket se tashmë ne jemi të përgatitur, kultura jonë, institucionet tona kulturore, ku futen dhe shtëpitë botuese, janë gjithnjë e më shumë të përgatitur dhe të aftë për këtë që ju e quani komunikim ndërkulturore me botën, me atë botë të madhe jashtë nesh. Është shumë e rëndësishme që edhe autorët ta kenë më shumë përgjegjësinë ndaj vetes, ndaj krijimtarisë së tyre, ndaj lexuesit të tyre. Është e rëndësishme që me sa duket edhe bota ka filluar të njohë gjithnjë e më shumë këtë realitet të vogël letrar shqiptar. Sigurisht ne duhet të jemi të hapur për të gjitha kulturat dhe qytetërimet, por vështrimi ynë duhet të jetë gjithnjë e më shumë realizimi i dëshirës drejt perëndimit aty ku janë edhe aspiratat tona, jo vetëm kulturore.



BASHKIM SHEHU: Në Torino nuk po perfaqësohet letërsia e një kombi, po e një shteti

Është pa dyshim një ngjarje e rëndësishme për letërsinë e Shqipërisë, ashtu sikurse do ishte për letërsinë e çdo vendi, po të kemi parasysh prestigjin e Sallonit të Librit të Torinos. Por më duket letrarisht e papërshtatshme që është marrë si kriter shtetësia, apo vendlindja e autorëve, e jo gjuha shqipe, duke lënë jashtë kësaj autorë me vlerë nga treva të tjera gjuhësore të shqipes. Pra, nuk perfaqësohet letërsia e një kombi, po e një shteti. Ndërkaq, për mua si autor, afermendsh që ka rëndësi prania në këtë Sallon të Librit, sepse është një rast i mirë për t'i dhënë një impuls komunikimit me lexuesit italianë, aq më tepër ngase vitet e fundit kam botuar dy romane në Itali. Kam qenë edhe vjet, po përveç dëshires, kam edhe kureshtje të shoh si do jetë këtë vit, në kontekstin kolektiv të letërsisë së një vendi. Sigurisht, varet edhe nga organizimi, dhe nuk është gjë e lehtë. Kam qenë para njëzet e pesë vjetësh në një event analog në Francë, por të organizuar nga shteti francez.

LEA YPI: Iniciativa të tilla mënyra më e mirë për të zhvilluar një identitet kulturor që tejkalon ndarjen gjuhësore dhe gjeografike

Marrëdhëniet historike mes Shqipërisë dhe Italisë janë të thella dhe kanë luajtur një rol të rëndësishëm në letërsinë shqiptare, si nga pikëpamja e temave ashtu edhe në formimin e shumë shkrimtarëve, disa prej të cilëve kanë zgjedhur të studiojnë në Itali ose të shkruajnë në gjuhën italiane. Është një lidhje e ndërtuar mbi ideale, dashuri dhe frymëzim, por gjithashtu e rëndësishme është edhe e kaluara e largët e pushtimit kolonial dhe ajo më e afërta e armiqësisë, dyshimit dhe ksenofobisë. Periudha ime e studimeve në Itali ishte thelbësore për formimin tim intelektual:



ishte në Sapienza që zbulova shkrimet e Benedetto Croce-s dhe Antonio Gramsci-t. Unë besoj se iniciativat si Salone, që synojnë të thellojnë njohjen reciproke nëpërmjet letërsisë, janë mënyra më e mirë për të zhvilluar një identitet kulturor që tejkalon ndarjen gjuhësore dhe gjeografike dhe i shtyn të dy popujt të përballojnë më mirë sfidat e përbashkëta.

BESNIK MUSTAJ: Vendosja e letërsisë shqipe në qendër të vëmendjes së Sallonit është një konfirmim i vlerave universale që përmban kjo letërsi

Salloni i Torinos është njëra nga dy - tri ngjarjet europiane më të mëdha në sherbim të librit. Aty mbledhen botues, autorë, agjentë letrarë nga e gjithë bota. Po ashtu edhe lexues italianë.

Vendosja e letërsisë së një vendi në qendër të vëmendjes së kësaj bote profesionistësh të letërsisë, në këtë rast Shqipëria, është pa dyshim një konfirmim i vlerave universale që përmban kjo letërsi. Në këtë kuptim, drejtuesit e Sallonit të Librit të Torinos 2023 i kanë bërë një “dhuratë” shumë të çmuar kulturës tonë kombëtare nga e cila përfitojnë të gjithë autorët shqiptarë klasikë e bashkëkohorë. Për mua si njëri nga autorët e pranishëm është një rast i mirë për të folur para një



publiku të huaj për kontekstin historik, shoqëror e kulturor prej nga buron letërsia ime. Po ashtu është një rast i mirë për të folur edhe për veprën time brenda dhe jashtë sallorit e për të takuar botuesit italianë të kësaj vepre.

YLLJET ALIÇKA: Suksesi nga dështimi janë shumë pranë

Është rast i rrallë, madje mund të rezultojë dhe unik si ftesë, pra qenia e të ftuarit special nga një Panair i përmasave të tilla si ky i Torinos. Është rasti për të përshëndetur atë apo ata që e bënë të mundur këtë gjë. Rrjedhimisht mënyra e shfrytëzimit apo menaxhimit të kësaj hapësire, ashtu siç mund të sjellë shpalosje reale të vlerave e arritjeve cilësore të letrave shqipe, shumë lehtë mund të shndërrohet dhe në një prezantim klientelist, klisheist që jo rrallë herë ka karakterizuar prezantimet tona kulturore jashtë vendit.

Thënë ndryshe, dhe në këtë manifestim kulturor, suksesi nga dështimi janë shumë pranë, pasur parasysh këtu dhe faktin e një pjesmarrjeje të konsiderueshëm shkrimtarësh nga e gjithë bota, me disa nobelistë apo kandidatë të tillë, gjë që dikton për një ndërgjegjësim apo relativizim të pritshmërive që mund të ëndërrojë secili prej nesh me mundësitë reale që ofron ky event .

Në nivele individuale, natyrisht për secilin nga ne, është një mundësi apo hapësirë joshëse për të promovuar veten dhe letërsinë që bëjmë, ku krahas përgjegjësiave tona kolektive kombëtare (sadoqë nuk jam shumë partizan i termit



letërsi shqipe, apo taxhikistanase, për mua letërsia është sa universale aq dhe individuale), pra secili do përpiqet të luftojë me mjetet apo taktikat e tija për tu promovuar apo kapur ndonjë vëmendje.

LIRIDON MULAJ: Shkrimtarët shqiptarë që jetojnë në itali mbase e kanë bërë më të lehtë rrugën për ne të rinjtë që aspirojmë të jemi në një të ardhme pjesë e një tregu letrar italian.

Fakti që Shqipëria këtë vit është vend i ftuar në panairin ndërkombëtar të Torinos mendoj se përbën një ngjarje në jetën publikë dhe kulturore shqiptare si fillim dhe më pas në atë italiane. Duke parë emrat që do të jenë panelistë të diskutimeve të shumta para lexuesit italian vërej një lloj përfshirjeje zhanresh, emrash, brezash dhe institucionesh. Është gjë e mirë pjesmarrja dhe hapësira që i dedikohet botimeve arbëreshe si pararojë e marrëdhënieve tona kulturore prej shekujsh dhe sigurisht botuesve të cilët uroj ta kenë mision promovimin e autorëve të tyre shqiptare në tregun dhe editorinë italiane. Nevoja për të lidhur ura të forta bashkëpunimi është e rëndësishme. Besoj se ky është dhe qëllimi i këtij panairi dhe ftesës që i është bërë Shqipërisë.

Sigurisht e prita me shumë kenaqësi ftesën për vetë faktin se Italia mbetet një nga kryeqendrat botërore të artit e për rrjedhojë dhë të letërsisë por krahas kesaj ndiej dhe një lloj pergjegjesie sepse niseshte prezantosh letërsine e një vendi te vogël si Shqiperia në një tokë të letërsisë së madhe, në atdheun e Dantes, Calvinos, Ungaretit, Montales , Magrisit e deri te Cogneti.

Mbas renies së komunizmit, Italia u bë shtëpia e dytë e qindra mijëra emigrantëve shqiptarë të cilët ndërtuan jetën e tyre atje e për rrjedhoje dhe profesionet dhe aspiratat e tyre. Keshtu kryesisht lexuesi Italian është njohur me letërsinë shqipe dhe realitetin tonë nëpërmjet subjekteve të shumta, kryesisht me ato lloj subjektesh që dëshmojnë periudhen komuniste në Shqipëri. Kjo le të themi ka qene dhe një lloj atraksioni ekzotik letrar me të cilin shkrimtarët shqiptarë dhe lexuesit italianë kanë ndërtuar një simbiozë interesante

Në Itali jetojnë dhe shkruajnë disa emra të mirë të letërsisë të cilët mund të përcaktohen si shkrimtarë shqiptarë por edhe italianë referuar gjuhës në të cilën shkruajnë dhe bazuar në faktin e gjuhës si atdhe i shkrimtarit (shumë prej ketyre shkrimtareve shkruajnë ne dy gjuhe).

Prezenca e shkrimtarëve dhe poetëve tane atje si Anilda Ibrahimi, Elvira Dones, Gëzim Hajdari etj e kanë bërë më të lehtë mbase rrugën për ne të rinjtë që aspirojmë të jemi në një të ardhme pjesë e një tregu letrar italian.

Edhe pse jam koshient se lexuesi italian është nje lexues i kultivuar me shije estetike të larta jam gjithashtu i vetëdijshem se ne shkrimtarët e rinj shqiptarë të pranishëm në panairin e Torinos (dhe jo vetëm) kemi historitë dhe dëshmitë tona për të rrëfyer. Mbase kjo mbetet dhe sfida jonë në raport me letërsinë e huaj.



ANDREAS DUSHI: Është bukur të flasësh në Itali për letërsinë tënde

Ftesa për të marrë pjesë në Sallonin e Torinos më kujtoi vitin 2019, kur në një rezidencë artistike në Campobasso të Molises, diku thellë brenda jugut të Italisë, qytet pa as edhe një turist të vetëm, më pyeti një shitës kartolinash të bëra vetë se nga isha. “Shqipëria,” i thashë. Ai buzëqeshi e, pasi më dhuroi kartolinën që doja të blija, më tregoi gjerë e gjatë origjinën e tij arbëreshe në italisht dhe me dy-tre fjalë më përshëndeti në arbërisht. Po ato ditë, i ftuar në universitetin e atyshëm (salla *Euklid*, e mbaj mend mirë), mes të pranishëmve ngrihet dora e dikujt që më bëri një pyetje shqip. Ishte studente nga Durrësi, e ardhur me projektin Erasmus atë vit aty. Pasi mbaroi takimi, u ndalëm e më tregoi historinë e saj.

Po ato ditë, lëviza për në Romë ku takova një komunitet shqiptarësh që priste priftin, mikun tim dom Markun për të kremtuar meshë. Edhe ata, në bisedën pas meshe më treguan historitë e tyre. Dhe si përfundim, secila histori ishte ndryshe, nga ajo e arbëreshëve, te ajo e studentes me në mes atë të dhjetra, në mos qindra emigrantëve. Dhe sigurisht, secili syresh atë histori që ma tregoi mua e kishte treguar kushedi sa e sa herë në rrethe me miqtë e vet italian.

Ne tani, disa shkrimtarë me një gjuhë amë që flitet nga pak njerëz, po shkojmë në Torino të flasim për letërsinë tonë, të tregojmë historinë e saj, jo të letërsisë shqipe por të letërsisë tonë individuale, ndoshta duke e kontekstualizuar në suaza kombëtare. Mes gjithë këtyre historive të jashtëzakonshme – tërësisht të vërteta – treguar publikut italian ditë për ditë nga bashkëkombasit tanë, është bukur të flasësh për letërsinë tënde, ndoshta t’u ngjallësh kureshtje se si ajo paraqet realitetet e njohura prej tyre, apo t’u thuash se përposë tyre ka edhe të tjerë. Pra, e përmbledh në një fjali shumë kollaj: Është bukur të flasësh në Itali për letërsinë tënde.



ALDA BARDHYLI: Përgjatë ditëve të Panairit, gjuha shqipe do të dominojë përmes prezantimeve që do të jenë në të gjitha hapësirat kryesore.

Prezantimi i letërsisë shqipe në edicionin e 35-të të Panairit të Librit në Torino, është një ngjarje e rëndësishme për kulturën shqipe. Për vetë kontekstin historik në të cilën letërsia shqipe u zhvillua për më shumë se gjysmë shekulli, përshfaqja përpara një audience të madhe ndërkombëtare e një historie aspak të ngjashme jo vetëm me vendin fqinj (ftues), por me shumë vende të tjera evropiane, e bën këtë pjesëmarrje të marrë përmasa gati historike.

Historikisht bota kulturore shqiptare dhe latine kanë qenë simboli i europianizmit. Kjo zonë është zona tipike e europianizmit, e vetmja hapësirë ku botohej letërsi artistike që në mesjetë. Dy gjuhët kanë qenë herët pjesë e një filozofie të përbashkët, si pjesë e kulturës së parë europianiste. Mos harrojmë që përkthimi i letërsisë antike të autorëve italianë të mesjetës kanë pasur një rol të rëndësishëm orientimi në rilindjen tonë kombëtare. Kanë qenë e vijnë të jenë frymëzim për breza e breza të tërë shkrimtarësh, të cilët kanë reflektuar në veprat e tyre vlerat më të mira të këtyre leximeve.

Ministria e Kulturës së Shqipërisë, ka ndërtuar një program të pasur me më shumë se 30 aktivitete të cilat do të rrëfejnë Shqipërinë përmes librit. Nga diskutimet mbi temat e ndjeshme të letërsisë sot, por dhe tek etapa të rëndësishme të letërsisë shqipe të cilat grishin kureshtjen e çdo kritiku apo lexuesi të huaj. Përgjatë katër ditëve të Panairit, gjuha shqipe do të dominojë përmes prezantimeve që do të jenë në të gjitha hapësirat kryesore të panairit.

LETËRSIA SHOQPE E PRANISHME NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR TË LIBRIT NË SELANIK

Nga data 4-7 Maj u zhvillua në Selanik edicioni i 19 i Panairit të përvitshëm Ndërkombëtar të Librit, një ndër Panairit më të njohura ballkanikë dhe evropianë.

Vend i ftuar special në këtë edicion ishin Shtetet e Bashkuara me pjesëmarrjen e mbi 20 botuesve amerikanë dhe shkrimtarëve si James Wood, Claire Messud, Richard Jackson, Nell Zink, Saskia Vogel, Meg Rosoff...

Nga letërsia ballkanike promovuan veprat e tyre shkrimtari i njohur bullgar Georgi Gospodinov dhe Lana Bastašić.

Shqipëria u prezantua në këtë Panair me librat e me librat e tyre të sapo botuar në gjuhën greke: Rita Petro, Arjan Leka dhe Ylljet Aliçka,

Me rastin e daljes në gjuhën greke të romanit “Valsi i Lumturisë”, Panairi përfshiu në programin e tij zyrtar dhe një takim të shkrimtarit Ylljet Aliçka me lexuesit.



PREZANTOHET NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR TË LIBRIT NË SELANIK ROMANI I AUTORIT YLLJET ALIÇKA, “VALSI I LUMTURISË” I SAPOBOTUAR NË GJUHËN GREKE NGA SHTËPIA BOTUESE PLETHORA.

Nga data 4- 7 Maj u zhvillua në Selanik edicioni i 19 i Panairit të përvitshëm Ndërkombëtar të Librit.

Vend i ftuar special në këtë edicion ishin Shtetet e Bashkuara me pjesëmarrjen e mbi 20 botuesve dhe shkrimtarëve amerikanë.

Me rastin e daljes në gjuhën greke të romanit “Valsi i Lumturisë”, në programin zyrtar të këtij Panairi u realizua dhe një takim i shkrimtarit Ylljet Aliçka me lexuesit.

Promovimi i romanit të Aliçkës u shoqërua nga një reportazh dhe intervistë e televizionit shtetëror grek ERT3.

Romani “Valsi i lumturisë” është përkthyer në gjuhën greke nga Andrea Zarballa dhe botuar nga shtëpia botuese Plethora.



Dihet tashmë që në mars të vitit 1917 ushtarakët e Ushtrisë së Orientit në jug-lindje të Shqipërisë krijuan atë që quhej Republika e Korçës: koloneli Descoins i dërguar nga gjenerali Sarraill i zboi autoritetet greke që kishin pushtuar Korçën dhe kjo për arësye ushtarake: Venizellos anonte atëherë nga Aleatët ndërsa mbreti Konstantini I preferonte gjermanët. Ushtria franceze administrimin e qytetit dhe të zonës përreth ia besoi në atë kohë shqiptarëve. Dhe në mënyrë solemne u nënshkrua një Protokoll me një këshill prej 14 anëtarësh dhe me krijimin e një xhandarmërie si dhe hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Flamuri i kuq me shqiponjën e zezë dy-krenare u valavait në ndërtesat publike mbi të cilin duken dhe tri ngjyrat e flamurit francez. Madje u shtypën dhe pulla shqiptare të cilat sot kanë një vlerë të madhe. Kjo liri veprimi, për popullin ishte një e papritur e madhe, për çka për një kohë të gjatë shqiptarët do të ruanin mirënjohje për Francën. Dhe mirëkuptimi ishte i plotë. Në Republikën e formuar dhe që funksiononte tashmë kanë ardhur ushtarë nga e gjithë perandoria franceze, që nga Senegali e deri nga Indokina, të cilët iu përkushtuan luftës. Përballë tyre ishin gjermanët, austriakët, çekët.... Dhe betejat ishin shumë të ashpra. Luan Rama frymëzohet nga letrat e luftës së kolonel André Ordionit, i cili zëvendësoi kolonelin Descoins, letra të cilat ia dërgonte familjes së tij. Një nga këto letra evokon një zbulim makabër. Gjatë një rikonjicioni nëpër male, ky officer zbulon gjashtë trupat e ushtarëve austriakë. Ata nuk kanë asnjë plagë lufte, thjesht i ka zënë një stuhi dëbore dhe aty kanë ngjirë. I prekur nga kjo dhe për habinë e atyre që e shoqërojnë, ai i varros këta ushtarë armiq me nderimin ushtarak duke qëlluar batare në ajër. Luan Rama e përdor këtë letër si dhe disa letra të tjera për të krijuar pastaj këtë histori e aventurë shqiptare.

Dhjetë vjet më vonë, prindërit e njërit prej ushtarëve austriakë i shkruajnë kolonelit Ordioni duke i kërkuar që ti shoqërojë në Shqipëri për të gjetur trupin e djalit të tyre. Por koloneli, që është një i plagosur lufte, vuan ende dhe në fillim heziton të shkojë me ta drejt Shqipërisë por më në fund ai vendos të shkojë në vendin e shqiponjave, pasi pa të asgjë nuk mund të bëhej. Ai shoqërohet dhe nga Petro, i cili gjatë luftës ishte një jetim që koloneli më pas e adoptoi. Luan Rama evokon këtu një fakt real: historinë e një kapiteni francez i cili kishte adoptuar dy fëmijë që mbetën jetimë si pasojë e bombardimeve. Duke mos patur tashmë as shtëpi e as prindër, ata ndjekin nga pas regjimentin e tij që të mund të ushqeheshin. Petro është përshkruar në roman si një Gavrosh që në rrobat e leckosura të trupit ka vendosur dekoratat e të vrarësve austriakë që gjen në fushën e betejës. Në Korçë koloneli është mjaft i njohur dhe ardhja e tij pritët me shumë dashuri. Korça është një qytet ku francezët ndihmojnë në zhvillimin e qytetit, në ndërtimin e mullinjve, të një çentrali elektrik, në hapjen e punishteve të ndryshme, etj. Në Korçë ka shtëpi shumë të bukura dhe me kopshte. Dhe ndërkohë kolonelit i zgjohen kujtimet e luftës. Ai kujtohet dhe për oficerin çek të kapur rob nga francezët i cili mes tyre “ndjehej i lirë, sikur të mos ishte i burgosur”. Gjatë bisedës me të ato ditë lufte ai i tregon se sa shumë i urrente gjermanët, duke pohuar se ajo luftë nuk ishte e tija. Dhe biseda e tyre vazhdon më pas rreth një gote vere. Por kolonelit i duhet të marrë udhët e maleve bashkë me prindërit e tronditur të ushtarit austriak. Pas disa kërkimesh më së fundi ata gjejnë trupat e ushtarëve. Kjo histori të kujton nga larg « Gjeneralin e ushtrisë së vdekur të Kadaresë », një roman i botuar nga “Albin Michel” në vitin 1970 ku përshkruhen kërkimet e trupave të ushtarëve italianë të rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore

Një shënim kritik i profesorit dhe kritikut francez Jean-Paul Champseix, studjues i veprës së Kadaresë, mbi romanin e fundit të Luan Ramës « Një mungesë kaq e gjatë » (« Une si longue absence ») botuar para disa muajsh në Paris nga Fauves Editions. Artikulli është botuar në revistën Autrement, në Paris.

« Romani i shumëpritur i Luan Ramës na ndriçon me një ndjeshmëri të madhe një faqe të historisë që duhet ta zbulojmë sërish... »

"REPUBLIKA E KORÇËS DHE FRANCA"

Nga Jean-Paul Champseix

Kush e kujton që Franca ka kontribuar për pavarësinë e Shqipërisë gjatë Luftës I Botërore? Romani i ri i shkrimtarit dhe diplomatit shqiptar Luan Rama na e kujton këtë.

nga një prift dhe një gjeneral italian. Dhe koloneli francez kujton: “Në vdekjen e atyre ushtarëve kishte një pafajësi të madhe. Jo, vdekja nuk vinte nga transhetë, mitralozët, bombat. Ishte një vdekje pa armiq.” Dhe kolonelit i kujtoheshin kufomat e ushtarëve që mbushnin Verdunin, si prehë e zogjve grabitqarë. Ai nuk donte që kjo gjë të përsëritej. Por eprorët e tij ushtarakë do ta qortonin këtë varrim me nderime të ushtarëve armiq në lartësitë e maleve shqiptare.


Luan Rama nuk harron të kujtojë dhe një ngjarje të trishtë që e hidhëroi shumë qytetin e Korçës. Pas largimit të kolonelit Descoins, prefekti i policisë shqiptare Themisokli Gërmenji, i cili i qëndroi Francës gjithnjë besnik, u arrestua në mënyrë të pashpjegueshme dhe u gjykua për tradhëti nga gjykata ushtarake franceze në Selanik ku dhe u ekzekutua. Tregohet kështu kufta diplomatike që bënë grekët, të cilët kërkonin ta bënë për vete jugun shqiptar të konsideruar nga ata si « Vorio Epir ». Por kur francezët u larguan, « Ushtria e Orientit » u kujdes që pushtetin t’ua linin shqiptarëve, për t’ju kundërvënë kështu

ambicjeve helene. Luan Rama na sjell dhe një detaj tjetër të padëgjuar : rreth 20 ushtarë komitaxhinj që dyshohej se bashkëpunonin me armikun ishin dërguar më pas në kampet e punës së detyruar në Cayenne ! Sot në Korçë është ende varreza e ushtarëve francezë ku përkrah Dupont Georges dhe Libreton Nicolas prehen në paqe dhe Abd-ek-Kader, u Tan Thi apo Boubakri Ickoy Baradji.

Para largimit nga qyteti i Korçës, konsulli i Austrisë, një ish ushtarak dhe ai, vjen për të falenderuar kolonelin për trupat e gjetur. Gjatë bisedës, që të dy zbulojnë papritur se gjatë asaj lufte ata kanë qenë në të njëjtin vend duke luftuar kundër njeri-tjetrit dhe se kjo luftë tashmë u duket absurde. « Që nga ajo kohë, kemi lënë pas nesh veç kujtime dhe të vdekur » - thotë diplomati. Lexuesit që duan ta shohin romanin e Luan Ramës në kuadrin e vet historik mund të lexojnë dhe librin e kolonelit Descoins, paraqitur mjaft mirë nga Grégor Marcchal apo librin « Një oficer francez në Ballkan » prezantuar nga nipi i kolonelit Ordioni, Dominique Danguy des Déserts, i cili ka botuar aty letrat dhe fjalimet e kolonelit gjatë luftës

në Shqipëri. Në këtë roman pikasim se ushtarakët francezë edhe pse të zënë në një luftë të përgjakshme, u interesuan dhe u lidhën shpirtërisht me këtë vend, duke kërkuar ta mbronin, në kundërshtim me ministrinë e Jashtme në Quai d’Orsay që nuk donte ti zemëronte grekët e italianët të cilët kishin pretendime territoriale ndaj Shqipërisë. Këtë dëshmon Luan Rama me kthimin e kolonelit të moshuar tashmë i cili nuk e ka harruar atë kohë dhe që mirëpritet nga populli atje. Pas luftës, në Korçë u ngrit liceu francez i Korçës i cili do të formonte një pjesë të madhe të elitës shqiptare. Atëherë profesorët francezë gjallëronin jetën e qytetit me shfaqje teatrale dhe koncerte. Nëpër rrugë, në kafene, shpesh thuhej « bonjour » dhe « merci ». Qyteti u mbiquajt « Parisi i Vogël ». Rrugët mbanin emrat e Viktor Hygosë, Lamartine, gjeneralit Sarraill, etj. Liceu do të mbyllej nga Musolini gjatë pushtimit italian të vitit 1939. Ishin nxënësit e këtij liceu që shoqëruan plot dashuri largimin e profesorëve francezë të cilët u dëbuan nga pushtuesit italianë. Drejtori i liceut, Xavier de Courville, anëtar i Action Française dhe mik i Barrès, përballë okupatorëve italian reciton fabulën « Ujku dhe qengji ». Meqë nxënësit nuk mund të thërrisnin « Rroftë Franca », ata ushtuan thirrjen « Rroftë La Fontaine » ! Mësimet në këtë lice kishin një fyrmë nacionalizmi, çka ndikoi në të ardhmen e vendit pas lufte. Veç të tjerash, një nga nxënësit që më pas u bë mësues i moralit në lice, në vitin 1937, do të na linte pas dhe disa kujtime. Ky ishte Enver Hoxha...

Nën regjimin komunist, qyteti i Korçës u la disi pas dore. Katedralja e tij ishte shatërrruar dhe gurët e saj u përdorën për ndërtimin e stadiumit të qytetit. Shumë ikona u shkatërruan gjatë Revolucionin Kulturor të vitit 1967, por njerëzit me kurajo arritën ti shpëtojnë. Propaganda atëherë i ironizonte këta « borgjezë » që përdornin fjalë frëngjisht në jetën e përditshme. Dhe është e mundur që në këtë përqeshje endej një lloj nostalgjie për të ardhmen që do të vinte. Këtë thekson dhe romani i shumë mirëpritur i Luan Ramës për të na ndriçuar me një ndjeshmëri të madhe një faqe të historisë që duhet ta zbulojmë sërish.



Studimi Arbëreshët i autorit Fatmir Toçi, pavarësisht modestisë së autorit që e cilëson si një vështrim të shkurtër historik dhe kulturor është aktualisht studimi më i plotë për arbëreshët dhe, pa dyshim, ky përbën edhe kontributin më të rëndësishëm. Kjo lidhet me faktin se deri më sot studimet për arbëreshët kanë qenë fokusuar kryesisht në gjuhën dhe kulturën e tyre dhe sudiuesit që janë marrë me arbëreshët kanë qenë kryesisht gjuhëtarë. Përkundër kësaj tendence z.Toçi ndjek linjën kronologjike të emigracionit arberësh duke sjellë informacione me interes që e datojnë fillimin e tij që në fund të shek.XII dhe, më konkretisht, fillimisht në vitin 1199 dhe, më pas, në vitin 1272 me dokumenta që dëshmojnë praninë e një ngulimi arbëresh pranë Brindisit. Dëshmi të tilla ndryshojnë perceptimin e deritanishëm për emigrimin e arbërve drejt Italisë si një process i nxitur nga pushtimi osman i trojeve arbërore pas vdekjes së Gjergj Kastrioti Skënderbeut. Dokumentet noteriale të përdorura nga autori që dëshmojnë shitëblerje pronash nga arbëreshë dhe, rrjedhimisht, themelimin e ngulimeve arbëreshe gjatë viteve 1396-1429 në Palermo, ashtu si dhe themelimin e ngulimeve të tilla në rajone të tjera sidomos në Italinë e Jugut dëshmojnë qartë se emigrimi i arbërve drejt Italisë ishte, sipas autorit, një dukuri në rritje gjatë shek.XV që u nxit ndjeshëm pas vdekjes së Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe rënies së kalave të Krujës (viti 1478), të Lezhës dhe Shkodrës (viti 1479) dhe pushtimit osman i Peleponesit (në vitet 1533-1534). Sigurisht emigrimi i arbërve ishte një zgjedhje personale që kishte si shtysë kryesore motivin ekonomik. si në shumicën e emigrimeve, por në rastin e arbërve emigrimi pas pushtimit Osman kishte edhe motiv fetar dhe social, pasi osmanët imponuan një mënyrë jetese lindore në dallim nga ajo perëndimore që arbërit ushtronin para pushtimit Osman. Lidhur me shkaqet e emigrimit arbëresh autori vë në dukje disa veçori që lidhen jo vetëm me motivin ekonomik, por edhe me faktin se një pjesë e emigrantëve si burim jetese zgjedhën mercenarizmin duke ofruar shërbim ushtarak jo vetëm për mbretërinë e Napolit apo republikat dhe pricipatat e ndryshme italiane, veçanërisht asaj veneciane, por edhe për mbretëri si ato franceze, spanjolle, angleze dhe deri tek Rusia cariste. E veçanta e mercenarizmit arbëresh lidhet me faktin se ata merrnin me vete familjet e tyre duke u vendosur përfundimisht në vëndet ku shërbenin. Mbretëria e Napolit ishte vendi ku mercenarët arbëreshë gjetën terrenin më tërheqës, duke filluar nga viti 1444 duke u vënë në shërbim të mbretit Alfons në luftën e tij kundër anzhuinëve dhe, më pas, të dërguar nga Gjergj Kastrioti Skënderbeu në ndihmë të aleatit të tij, mbretit të Napolit, Ferdinandit, për të mundur kundërshtarët e tij. Mbretëria e Napolit i mirëpriste emigrantët nga trojet arbërore dhe gatisulli i Peleponesit jo vetëm si mercenarë por edhe për të populluar rajone të mbetura shkratë nga luftërat dhe epidemitë. Ngulimet arbëreshe në Itali u pasqyruan edhe në topografinë e rajoneve të ndryshme, si në rastin e krijimit gjatë viteve 1461-1466 të Albania Tarantina dhe Albania Salentina, në territorin e mbretërisë së Napolit, të banuara kryesisht nga mercenarë arbëreshë dhe familjet e tyre. Lidhur me emigrimin arbëresh në Itali autori zgjeron njohuritë tona duke dëshmuar vështirësitë e këtij emigrimi sidomos në fazat më të hershme të tij që lidhen si me qëndrimin nganjëherë jomiqësor të banorëve vendas ashtu dhe me gjendjen e vështirë ekonomike që bëhej shkak për revolta kundër feudalëve vendas që shfrytëzonin arbëreshët e varfër. Krahas kontinentit emigracioni arbëreshë u vendos edhe në ishuj si Korsika dhe Sardenja, ku ngulimet u themeluan nga emigrantë nga

Studimi “Arbëreshët midis realitetit dhe mitit”
i autorit Fatmir Toçi

KONTRIBUT PËR NJOHJEN E HISTORISË DHE KULTURËS ARBËRESHE

Prof. Asoc. Dr. Bashkim Vrekaj



trojet arbërore dhe nga Peleponesi. Në emigracionin arbëresh drejt Italisë, krahas njerëzve të thjeshtë dhe të varfër u përfshi edhe një pjesë e aristokracisë arbëre të kohës duke filluar nga bashkëshortja dhe djali i mitur i Gjergj Kastrioti Skënderbeut, pjestarë të familjes së Vrana Kontit (Kastrioti), familjarë dhe pasardhës të Muzakajve që u vendosën në mbretërinë e Napolit dhe në Pulia, fisnikë arbër si Dukagjinët dhe Topiajt që u vendosën në Venecia, me të cilën kishin vendosur raporte gjatë procesit të kalimit të qyteteve bregdetare arbërore (me përjashtim të Vlorës) nën sundimin venecian me kërkesë të finkëve arbër që nuk donin pushtimin e këtyre qyteteve nga osmanët.

Me interes për emigracionin e fisnikërisë arbërore në Itali është harta e feudeve të tyre, një pjesë të dhuruara nga mbretëria e Napolit dhe pjesa tjetër e blerë prej tyre. Lidhur me fatin e bashkëshortes dhe djalit të Gjergj Kastrioti Skënderbeu autori sjell të dhëna interesante duke ndjekur gjenealogjinë e tyre dhe duke arritur në përfundimin se kjo gjenalogji u shua me vdekjen e Irenës, e bija e Ferdinandit, biri i Gjon Kastriotit dhe stërmbesë e Gjergj Kastrioti Skënderbeut, dhe vazhdimin e trashëgimisë kastriote nga fëmijë të paligjshëm të Ferdinand Kastriotit. Autori në studimin e tij sjell paralele midis arbëreshëve si luftëtarë në atdheun e tyre dhe si mercenarë, që në atë kohë quheshin stratotë, jashtë vendit të tyre, duke filluar nga Italia deri në mbretëritë e Spanjës, Francës, Anglisë dhe deri në Rusinë cariste. Me këtë rast duhet sqaruar se stratotët e shek.XV nuk kishin të bënin me stratotët bizantinë të shek.X pasi, ndërsa këta të fundit ishin bujqë që kishin marrë në përdorim ngastra toke nga Perandoria Bizantine për të shërbyer në ushtri kur u bëhej thirrje, ndërsa stratotët e shek.XV ishin mercenarë që luftonin me pagesë në shumicën e tyre ndërsa në mbretërinë e Napolit një pjesë e tyre shpërblehej edhe me ngastra toke. Fakti që një pjesë e arbëreshve shërbenin si mercenarë jo vetëm në Itali por edhe jashtë saj dëshmon se ata kishin zgjedhur shërbimin ushtarak si mënyrë për

të siguruar jetesën dhe, natyrisht, kjo lidhet me aftësitë luftarake të tyre në vazhdim të një tradite shumëshekullore. Lidhur me mercenarët arbëreshë duhet vënë në dukje se ata që shërbenin në vende të tjera bazën e kishin në Itali ku jetonin familjet e tyre. Aq të kërkuar ishin mercenarët arbëreshë sa me ta ishin krijuar reparte të veçanta të përbërë nga himariotë në Venecia dhe reparti Mbretëror (Real maqedon), në fakt i përbërë nga arbëreshë, në mbretërinë e Napolit.

Krahas kronologjisë së emigracionit arbëreshë në Itali autori sjell të dhëna për mënyrën e jetesës së tyre duke theksuar faktin e krijimit të ngulimeve arbëreshe pranë njëri – tjetrit, gjë që ndikonte në marrëdhënie më të ngushta midis tyre dhe në ruajtjen më të mirë të gjuhës, traditave dhe kulturës. Rol të rëndësishëm në ruajtjen e traditave dhe kulturës arbëreshe luajti kisha rrugëtimin e së cilës autori e ndjek hap pas hapi deri në ditët tona. Në historikun e religjionit arbresh në Itali autori thekson rolin e papa Klementi IX (Albani) me origjinë arbëreshe. Siç dihet kisha krahas religjionit në atë kohë luante rol të rëndësishëm në arsimimin e njerëzve pasi pranë institucioneve kishëtare ose me iniciativë të tyre krijoheshin kolegje, seminare dhe manastire.

Duke filluar nga viti 1731 institucione të tilla arsimore krijuan edhe arbëreshët me Kolegjin Korsini, në vitin 1734, me themelimin e seminarit abëresh në Palermo, dhe në vitin 1733 edhe me themelimin e Kolegjit Shën Maria në Siqeli, për vajzat arbëreshe. Pavarësisht se në këto institucione mësimore fetare nuk mësohej gjuha arbërishte ato patën rol vendimtar për arsimimin e arbëreshve dhe krijimin e elitës intelektuale të tyre që do shquhej sidomos gjatë shek.XVIII-XX.

Lidhur me intelgjencën arbëreshe autori krahas figurave të njohura si Barleti, Beçikemi, Lekë Matranga, Jul Variboba, De Rada na njeh edhe me figura pak apo aspak të njohura si Nikollë Brankati, Nikollë Filja, Nikollë Keta dhe Gjergj Guxeta, i cili themeloi kolegjin arbëresh në Palermo

dhe botoi në vitin 1734 veprën “Kronikë e Maqedonisë deri në kohën e Skënderbeut”. Në kohën kur në trojet shqiptare të pushtuara nga osmanët kultivohej kryesisht letërsia fetare me botime në gjuhën arabe, në mjedisin arbëresh botoheshin vepra shqip si “Doktrina e Krishterë” me autor Lekë Matrenga (1592), e cila përbën botimin e dytë shqip pas Mesharit të Buzukut (1555) dhe përmban vlera të veçanta gjuhësore pasi dëshmon gjuhën arbërore të shek. XV, pikërisht gjuhën e folur të kohës së Gjergj Kastrioti Skënderbeut. Letërsia arbëreshe njohu lulëzimin e saj gjatë shek. XIX me autorët e njohur De Rada, Dhimitër Kamarda, Gavril Dara I Riu, Zef Serembe, Zef Skiroi etj, sipas autorit e vijuan në shek. XX autorë si Françesko Solonaja, Domeniko Belici, Karmel Kandeva, Luka Perone etj. Nga institucionet arsimore arbëreshe dolën edhe figura të njohura politike, midis të cilëve Françesko Krispi dy herë kryeministër i Italisë së bashkuar (1887-1891 dhe 1893-1896). Lidhur me kishën e frekuentuar nga arbëreshët autori sqaron se, pavarësisht se ajo quhej kisha greke e ritit bizantin, pasi arbëreshët e vendosur në jugun e Italisë vinin kryesisht nga viset jugore të Arbërisë dhe nga Peleponesi, ku praktikoheshin njëritrit, ndërkohë ushtruesit e fesë ishin në shumicën e tyre arbëreshë.

Lidhur me religjionin autori trajton dhe konfliktet midis kishës së të ardhurve (shumica arbëreshë, por edhe grekë) dhe kishës latine vendase, e cila synonte konvertimin e praktikantëve arbëreshë nga riti bizantin në atë latin, gjë që pati rezultate konkrete. Sipas autorit arbëreshët që u vendosën në Italinë e Veriut, sidomos në Venecia, dhe që vinin kryesisht nga viset veriore të Arbërisë gjetën të njëjtin rit latin si në vendlindje dhe kjo ndikoi në një asimilim më të shpejtë të tyre, në krahasim me arbëreshët e jugut të Italisë, pasi kisha nuk shërbeu si ruajtëse e traditave dhe kulturës arbëreshe.

Autori në studimin e tij për arbëreshët nxjerr në pah rolin e tyre si pararendës të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe kontribues aktiv për krijimin e një Shqipërie të pavarur. Në katedrën e gjuhës shqipe të themeluar dhe drejtuar nga De Rada u arsimuan jo vetëm rilindas, si Luigj Gurakuqi, Thimi Mitko e Zef Jubani por edhe intelektualë dhe patriot të mëvonshëm si Mehdi Frashëri, Anvi Rustemi, Kolë Kamsi, Gjike Kuqali, Aleksandër Xhuvani, Sejfulla Malëshova etj. Për ironi të fatit atë që duhej të bënte Dheu mëmë për bijtë e vet të larguar e bënte pikërisht bijtë e larguar për Dheun mëmë të pushtuar. Të vendosur në një vend pa paragjykime racore dhe pa synime ekspansioniste ndaj trojeve shqiptare, diaspora arbëreshe jo vetëm u konsolidua si komunitet duke ruajtur gjuhën, kulturën dhe traditat, por duke mbajtur lidhje të vazhdueshme me tokën mëmë u bë në një farë mase një Atdhe i dytë që ndihmoi me sa mundi atdheun mëmë.

Tani në kushtet e një asimilimi gradual por të vazhdueshëm arbëreshët kanë nevojë më shumë se kurrë për mbështetjen e atdheut të tyre. Autori duke parë dhe njohur nga afër gjëndjen e komunitetit arbëresh në Itali konstaton me keqëardhje pikërisht rrezikun e asimilimit dhe shuarjes graduale të identitetit arbëresh në kushtet e globalizmit. Sigurisht nuk bëhet fjalë për ndonjë politikë asimiluese të shtetit italian, i cili ligjërisht garanton të drejtat e arbëreshëve si komunitet, por problemi është më i komplikuar dhe i vështirë për t`u zgjidhur pa një mobilizim jo vetëm të elitës arbëreshe, por sidomos të shtetit shqiptar, i cili e ka detyrë kushtetuese kujdesin ndaj shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve shtetërorë.

Le të shërbejë ky studim si një kujtesë për institucionet që e kanë për detyrë kujdesin ndaj diasporës shqiptare të vjetër dhe të re.

Pasi e bëri proçkën, duke e përjashtuar gjysmën e letërsisë shqipe, autori i “Antologjisë së poezisë moderne shqipe”, Rudolf Marku, po zhvillon një luftë donkishoteske me të gjithë ata që kanë shqiptuar qoftë edhe një fjalë kritike për “antologjinë” e tij, duke mos i kursyer “kritikët” nga akuzat, shpifjet, fyerjet dhe denigrimet. Kështu, pasi i qëron hesapet me Ali Aliun, Mehmet Krajën, Sokol Çungën (këti ia deformon emrin duke e quajtur Çungu), Durim Çaçën, Dem Metalinë, Muharrem Jakupin, Mujë Buçpapën (kalimthi edhe me Ymer Çirakun dhe të ndjerët Dalan Shaplllo e Alfred Uçi), e edhe me “zonjushën Klara Kodra”, si e quan me cinizëm, merret doemos, edhe me mua, “Dr. Agim Vincën”, si ka qejf të më quajë ai, edhe pse unë nuk i nënshkruaj shkrimet e mia e as librat e mi me titullin “doktor” e as “profesor”.

Më mjafton emri dhe mbiemri.

Dhe, ja ç'është për mua autori i "Antologjisë së poezisë moderne shqipe", Rudolf Marku, në pretendencën e tij groteske me titull "Grotesku i diskutimeve për antologjinë e poezisë shqipe", të botuar në numrin e fundit të gazetës "ExLibris" (6 maj 2023).

“Ndërsa Doktor i hapsirave Maqedoni e Veriut- Kosovë- Shqipëri, i cili është vetë studjues i letërsisë, poet dhe hartues Antologjish, jo pak i njohura Dr Agim Vinca, shkruan se Antologjia meriton as më shumë e as më pak se sa asgjësim total!

Ajo që më çudit është se si Dr. Agim Vinca, një dishepull i njohur i doktorit tjetër, Dr. Aliut në katror (shih Hylli Dritës)- viti 1997, një patriot tepër luftarak, zbutet dhe squllet bash atëherë kur duhej të tregoej trim dhe patriot... Para disa vitesh të mira, kur kremtohej dhe 50 vjetori i Festivalit prestigjioz të Poezisë në Strugë, (atë vit vetë Kryetari i Komunës së Strugës ishte shqiptar), u ftuan mbi 100 poetë nga e gjithë bota, mes tyre dhe beatnik i famshëm Alain Ginsberg. Kishte dhe shumë poetë, kritikë, studjues, gazetarë dhe Doktorë shqiptarë, mes tyre dhe Dr. Ali Aliu dhe poeti Doktorial Agim Vinca!''.

Teksti është përshkruar besnikërisht, me copy-paste, ashtu siç ka dalë nga pena e Rudolf Markut. Po e ndërpres për një çast citimin për ta komentuar paksa këtë pjesë të paragrafit dedikuar mua, për t'iu kthyer pastaj vazhdimisht të tij.

Askund në shkrimin tim me titull “Poeti laureat me shikim separat!”, të botuar në gazetën “Koha Ditore” në Prishtinë (16 prill 2023) dhe te gazeta “Nacional” në Tiranë, nr. 675, 14-21 prill 2023, nuk e kam përdorur shprehjen “asgjësim total”. (Fjala “asgjësim” dhe togfjalëshi “asgjësim total” nuk hasen askund në shkrimin tim, sepse “asgjësimet”, as të pjesshme e as totale, nuk janë pjesë e formimit tim profesional dhe etikës sime intelektuale).

Kjo një. E dyta. Dishepull i *"Dr. Aliut në katorr"*, siç spekulon Rudolfi, nuk kam qenë ndonjëherë, por loja me emrat e njerëzve (në këtë rast të Ali Aliut) është joserioze dhe e pandershme. Dhe e treta (e vërteta): Në vitin 1997, kur qenkësh kremtuar 50-vjetori i "Festivalit prestigjioz të Poezisë në Strugë", unë, Agim Vinca, as nuk kam qenë i ftuar e as nuk kam marrë pjesë në këtë manifestim letrar (madje nuk kam qenë fare në Strugë në gusht të atij viti), në të cilin paskësh qenë i pranishëm Rudolfi ynë, siç del nga teksti i tij. Si mund ta quajmë ndryshe këtë pohim pos gënjeshtërt? Rrenë klluve, do të thoshte Podrimja i "Lum Lumi"-t.

Shkojmë tutje, duke ia dhënë fjalën vetë Rudolfit, për të derdhur dëngla të tjera, edhe më skandaloze se të parat.

“Natyrisht maqedonasit e shfrytëzuan rastin për ta kthyer takimin prestigjioz ndërkombëtar në një manifestim të nacionalizmit maqedonas. ‘Ishtë si manifestimi në Munich-un e nazistëve të sapo ardhur në pushtet- shkruan më vonë Igjelles Jounard, ish drejtorë e Qendres së Librit të Montpellier, Francë- kudo flamuj maqedonas dhe kudo banda muzikore maqedonase luajtur nga burra me kostume kombëtare. Dhe britma zëlarta për lavdinë e Maqedonisë,, I vetmi që protestoi për manipulimin e Takimit Ndërkombëtar të Poezisë për qëllime propagandistike të nacionalizmit maqedonas ishte Francezja Igjelles Jounard. Dhe ironia më e madhe është se më të zellshmit për ta kundërshtuar protesten e vetmuar të Igjelles

Edhe dy fjalë për “Antologjinë e poezisë moderne shqipe” të Rudolf Markut dhe orvatjet e tij për ta mbrojtur me zhurmë e agresivitet proçkën e bërë

PAS PROÇKËS – BROÇKULLA DHE SULME TË PASKRUPULLTA!

Nga Agim Vinca

Jounard ishin, sipas kujtimeve të Francezes fisnike, vetë poetët pjesëmarrës shqiptar të Maqedonisë (së Veriut, natyrisht)”.

Nuk e di a duhet ta përsëris se unë nuk kam qenë pjesëmarrës i "Mbrëmjeve Strugane të Poezisë" (edicioni i vitit 1997), gjë që mund të verifikohet (po qe nevoja) nga botimet dhe dokumentacioni i këtij manifestimi letrar, prandaj nuk kam pasur mundësi as të protestoj e as të tultam, por për të parë se sa është serioz antologjisti ynë në përpjekjet e tij për ta mbrojtur proçkën e vet, flet një e dhënë tjetër e këtij paragrafi.

Për të qenë sa më “bindës”, Rudolfi përmend një emër të përveçëm: emrin e “Francezes Jigelles Jounard”. Nuk ekziston në Francë dhe askund tjetër në botë, një grua me këtë emër! Në ngutje e sipër dhe i trulllosur nga goditjet që i qenkëshin bërë antologjisë së tij, “poeti laureat” nuk i verifikon gjërat, nuk merr mundimin të hulumtojë sado pak, kështu që poetit francez Gil Jounard ia ndërron gjininë dhe nga burrë e bën grua! (Ec e besoji njeriut që bën këso gafash!).

Më vjen mirë nëse poeti francez Gil Jounard (Zhil Zhunar) ka reaguar kundër euforisë nacionaliste maqedonase, po Rudolfi ynë pse heshti, vallë, pse s'e tha një fjalë, nëse jo si shqiptar, së paku si intelektual?!

Thuhet se fundi e zbukuron veprën, kështu edhe përrallën e Rudolfit për heshtjen “deri në reticencë” të poetëve dhe studiuesve nga Maqedonia “në Strugën që përshkruan Jounard”, edhe pse sa më përket mua e vërteta është diametralisht e kundërt me atë që mëton Mic Sokoli ynë Rudolf.

“Dhe janë po të njëjtët poetë dhe studjues
të heshtur deri në reticencë në Strugën që
përkthejnë Jounard, të cilët shfaqen me
një shpirt luftarak guerilas tani, kundër

Antologjisë së Poezisë Moderne Shqipe të hartuar nga Rudolf Marku.”

Në librin tim "(Po)etika e sjalës", botuar në vitin 2010 në Tetovë, kam një kapitull të tërë me shkrime për festivalin "Mbrëmjet Strugane të Poeziës": kapitullin me titull "Nën flamujt e albanofobisë", që hapet me shkrimin "Kur digjen flamujt, ç'kuptim ka poezia?!", të botuar fillimisht në gazetën "Flaka e vëllazërimit" (29 gusht 1993) dhe mbyllet me polemikën e madhe me kryetarin e atëhershëm të Këshillit Drejtues të Festivalit, shovenin Zoran Ancevski, të zhvilluar në gazetën maqedonase "Utrinski vesnik" në mars-prill 2005.

Dhe reagimet e mia nuk kanë qenë si pjesëmarrës në festival, sepse nuk kam qenë i tillë, por thjesht si krijues dhe intelektual. (Për djegien e flamurit nuk reagoi as i ngarkuari me punë i Republikës së Shqipërisë në Shkup, e as grupi i poetëve pjesëmarrës nga Tirana, për nder të të cilëve edhe që vënë flamuri shqiptar, sepse përdorimi i tij në IRJM atëbotë ishte i ndaluar, kështu që reagimi im që i vetmi për këtë akt shovinist në “qytetin e poezisë”).

Ndaj manifestimit letrar “Strushki vecheri na poezijata”, që mbahet në vendlindjen time, kam qenë gjithmonë kritik dhe mendimin timor e kam shprehur publikisht, jo vetëm në shqip, por edhe në maqedonisht.

Në vitet 2002-2004 kam qenë anëtar i Këshillit Drejtues të MPS, që përbëhej nga pesë anëtarë (katër maqedonas dhe një shqiptar) dhe kam dhënë dorëheqje para se të më kalonte mandati për shkakt të Statutit të ri të Festivalit, ku nuk parashihej përdorimi i gjuhës shqipe. E pata dërguar punën deri në Gjykatën Kushtetuese, por pa sukses dhe kur statuti u miratua me shumicë votash, duke më mbivotuar mua anëtarin e vetëm shqiptar, nuk më mbeti tjetër veçse të jepja dorëheqje.



Betejën intelektuale që kam bërë unë për gjuhën dhe kulturën shqiptare në Maqedoni dhe në përgjithësi, e cila, në njëfarë dore, vazhdon edhe sot, Rudolf Marku nuk mundet as ta imagjinojë, por kjo s'është temë e bisedës, prandaj preferoj të kthehem në temë: tek "antologjia" e Rudolfit. Kjo antologji është e gabuar që në start, sepse niset nga koncepti shtetëror e jo kombëtar dhe gjuhësor. Pretendimi për kinse kriter estetik është një fluskë, sepse duke përfshirë vetëm poetë nga Shqipëria shtetërore (fjala është për poezinë e sotme) privohet *a priori* nga vlera estetike poezia e krijuar jashtë sinorit shtetëror.

Siç kam theksuar edhe në shkrimin tim të parë “Poeti laureat me shikim separat!”, ky botim, i përgatitur nga “poeti laureat” refugjat në Londër dhe i financuar e promovuar nga Ministria e Elvës dhe Qendra e Aldës në Tiranë, kështu siç është, nuk mund të jetë antologji e poeziës shqipe, gjë që është e pakontestueshme për çdo njeri normal. Të huajt e paraqesin letërsinë shqipe si një, kurse Rudolfi e ndan! Dhe, në vend që të kërkojë falje, sulmon e akuzon.

Por ky botim nuk mund të quhet as antologji e poezisë moderne shqipe, sepse me përmbajtjen e tij nuk e përballon këtë barrë. Autorët e prezantuar në të, jo të gjithë, por një pjesë e mirë e tyre, në mos shumica, nuk mund të quhen “modernë” në kuptimin teorik dhe historiko-letrar të kësaj fjale, gjë që për njohësit e modernes në art është po ashtu plotësisht e qartë.

“Termin *Poezi moderne* e kam përdorur në një vështrim thjesht personal (...) në kuptimin e një poezie që mund të ishte shkruar në çdo kohë”, nënvizon Rudolphi. Dakord. Dante, Shekspiri, Gëte, Bajroni, Hygoi, pa shkuar t’u Safoja, Homeri, Eskili, Virgjili e të tjerë, kanë krijuar poezi “që mund të ishte shkruar në çdo kohë”, por nuk e përfaqësojnë “poezinë moderne”. Rudolf Marku është dashur ta lexonte së paku librin e studiuesit gjerman Hugo Friedrich (Fridrih) “Struktura e lirikës moderne” (Struktur Der Modernen Lyrik), të përkthyer pothuajse në të gjitha gjuhët e Evropës, për të parë se ç’është moderniteti në poezi dhe cilët poetë mund të quhen modernë në kuptimin tipologjik të fjalës, sepse moderniteti është kategori përcaktuese e jo vlerësuese, siç kuptohet gabimisht ndër ne dhe siç e ka kuptuar, në të vërtetë keqkuptuar, edhe antologjisti ynë. Ajo që në letërsinë evropiane quhet lirikë moderne fillon me Bodlerin, Rembonë, Malarmenë, vazhdon me Apolinerin, Lorkën, Ungaretin, Pol Valerinë, Eliotin, Sen-Xhon Persin e të tjerë. Përdorimi individual i termave në diskursin letrar shkakton kaos dhe anarki.

Në shkrimin “Fahrenheit 451”, të botuar edhe në “ExLibris”, edhe në “Nacional”, duke dashur të tërheqë paralele mes “situatës” së krijuar pas botimit të “Antologjisë” së tij dhe djegies së librave në sistemet totalitare, Marku i referohet romanit të njohur distopik të shkrimtarit amerikan Ray Bradburi, “Fahrenheit 451”. Aluzioni është i qartë, por shndërrohet në bumerang. Djegiet janë të ndryshme dhe jo vetëm fizike. Rudolf Marku ka djegur, me a pa dashje, një letërsi të tërë: letërsinë e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Ballkan, tok me atë të arbëreshëve të Italisë. Rrjedhimisht, veprimi i tij do të mund të cilësohej si: Farenhajt 2023!



E enjte 11. Maj 2023

[Gjurmë](#) | [Opsione](#)

Aktualitet

Intervista

Mbledhje

Kurizazhi

Shprehjet

Opinion

Analiza

Dokumenti

Reportazhi

Fotoreportazhi

Veprimtari

Arteset

Shfaqja

Shprehjet

Opinion

Analiza

Dokumenti

Reportazhi

Fotoreportazhi

Veprimtari

Arteset

Më ofruan para ta vrisja një komandant të UÇK-së dhe një publicist

SHIK-u dëmtuesi më i madh i UÇK-së (2) në intervistën p...



Shtrirja e Mishkoviqit, përfshiu Shqipërinë e Kosovën

shteti serb po e akuzon për përfitim

FILIMI LAJME OPINION INTERVISTA SPORT BOTA E YJEVE HI-TECH LIFESTYLE IMPRESUM



ROGNER HOTEL TIRANA

REGISTRIM DHE INFO info.tirana@rogner.com +355 4 2255035

duke filluar nga

OFERTA VERORE 75€

Email shërbime
Printo
Vetem tekst

Më të lexuara



Më ofruan para ta vrisja një komandant të UÇK-së dhe një publicist

Shqiptari që ndërtoi helikopter

Shkup: Aksidenti i rëndë, përplasen dy makina

Shqiptari që "turpëroi" Tadiçin dhe Jeremiçin në "Harward"

Siria mund të sulmohet nga Shqipëria?

Më të komentuarat




Edhe birrat pa alkool janë haram

Maqedonia do t'i shesë mbeturina Shqipërisë

Bleona Qereti zhvishet krejtësisht në det

BDI hedhë poshtë propozimin për zgjedhje të parakohshme

BDI kërkoi zgjidhjen e emrit dhe jo zgjedhje



Këthe poeti dhe krijtori i mirnjohur letrar, Prof. Dr. Agim Vinca, ka mbledhur vendimin e kryetarit të Strugës Zijadin Sela, për të bojkotuar Mbrëmjet Strugane të Poezisë për shkak të mospërdorimit të gjuhës shqipe në veprimtaritë e tij, është plotësisht i drejtë dhe i arsyeshëm. Është koha e fundit që të ndërpritet kjo praktikë diskriminuuese dhe fyese ndaj gjuhës shqipe në qytetin e Strugës, ku këtë gjuhë e flet më tepër se gjysma e popullsisë së tij, por edhe në Maqedoni në pjesë të thjeshta, thotë poeti

Vinca, i cili në vitin 2005, për shkak të mosrespektimit të gjuhës shqipe dhe dorëheqje nga Këshilli i Drejtues i Mbrëmjeve Poetike të Strugës.

Mirëpo, festivalin, sipas Vincës, do të duhej ta bojkotojnë, për të njëjtat arsye, edhe poetët shqiptarë nga Maqedonia, Kosova e Shqipëria, si dhe anëtarët shqiptarë të Këshillit të Drejtues, e jo të vazhdojnë të marrin pjesë në të si të mos kishte ndodhur asgjë.

"Në krijuesit kemi obligim shumëfish më të madh se politikanët ta mbrojmë dinjitetin e gjuhës në të cilën shkruajmë dhe të kulturës së cilës i takojmë. Që gjendja të ndryshojë duhet angazhimi i të gjithëve – intelektualë, krijues, politikanë etj. - dhe në radhë të parë, do të thosha, i partisë që është partaner e koalicionit qeveritar në Republikën e Maqedonisë, e cila ka obligim ligjor t'i mbrojë të drejtat e shqiptarëve në këtë shtet", përfundon Vinca.

Në parashtrimin tonë të gjatë polemist kritik- kulturologjik të një jave më parë (“Objeksione dhe përsiatje, “Veshun me diell, mbathun me hanë”, ExLibris, 29 prill), sillnim argumente për mangësi të antologjisë më të re të poezisë shqipe, (por dhe një përligjje të një botimi të tillë poetik prej një poeti, sipas ndjesisë së tij estetike subjektive, që s’mund të diskutohet, veç se kjo ndjesi duhej të ishte më e zgjeruar dhe në poetë të tjerë të rëndësishëm të shqipes sonë poetike të sotme), përgatitur nga poeti R. Marku, në aspekte kryesore të konceptimit dhe publikimit në fjalë.

Në reagimin e tij prisnim të shtjellonte në të njëjtën mënyrë, (jo për të “mbrojtur” të ashtuquajturën veprën e vet, sepse në kohën tonë nuk akuzohet askush për shijet dhe përzgjedhjet e tij estetike por, thjesht, me dashamirësinë dhe fisnikërinë e krijuesit të një lloj idealiteti të kësaj përmbledhjeje të re të lirikës sonë, (inspirimi, frymëzimi estetik, përfshirja e autorëve të tij të dashur, përmes mbresës vetjake, etj.).

Kështu, p.sh. përse ai e ndien intuitivisht Bogdanin si poet modern, ndërkohë që arti i tij i sibilave është ai klasik, (gjë që ne paraqitëm gjerësisht dallimin mes këtyre drejtimeve estetike, duke sjellë shembull, bie fjala, modernen, manieristen spanjolle të Gongorës dhe klasiken monumentale të poetit tonë, të dy, thuajse bashkëkohës të shek.XVII).

Apo, përse mendon se poetët e Shqipërisë politike përfaqësojnë më mirë poezinë e re moderne shqipe, (të cilët, mendon se i njeh më mirë, ndërkohë që një poet laureat mendohet ta njohë poezinë e gjuhës së tij, jo vetëm atë që shkruhet në territorin shtetëror, por dhe atë në të gjithë hapësirat ku ajo krijohet në botë), ndërsa ata të trojeve, që patën ndikimin dhe inspirimin e modernitetit më të lartë artistik, për shkak të rrethanave historike, (ndërkohë që në Shqipëri vepronte terrori komunist, poetët e trojeve ishin të lirë për të gjitha drejtimet moderniste, me kusht që të mos kërkonin lirinë kombëtare në terrorin shovinist serb), duke lënë pa përfshirë poetë të mëdhenj të lirikës moderne shqipe të kohës së re, (që i kemi përmendur tashmë, gjer te postmodernisti i gjeneratës së sotme, A. Apolloni, etj.).

Gjithashtu, përse mendon se antologjia e tij individuale, (personale, vetjake), është më e mirë se një antologji kolegjiale e poezisë që, siç paraqitëm me shembuj botimesh, këto të fundit, janë më të sukseshme dhe shpërfaqjen si monumente letrare të poezisë shqipe dhe asaj botërore.

Dhe, së fundi, përse mendon se është e pranueshme, paraqitja e antologjisë së tij, me krijime të poetëve të tjerë, si një vepër autoriale, kur në të gjithë botën dhe në traditën shekullore të publikimeve të këtij karakteri, paraqiten thjesht, si përzgjedhje, përmbledhje, përgatitje, përpilim, nga përzgjedhësi, përmbledhësi, përgatitësi, përpiluesi përkatës, (për të cilat sollëm shumë paraqitje veprash të tilla letrare). Gjë që nuk duket të jetë shumë legale dhe e ndershme, në moralitetin e dinjitetin e krijuesit, duke e paraqitur (përmbledhjen apo përzgjedhjen e “sajuar” me poezi të të tjerëve) me emrin e vet autorial, që në ballinë, me të cilin paraqiten veprat origjinale. Sepse kështu, me “vepra” të përpiluara apo të kompiluara, do të na shfaqeshin “autorë” “origjinalë” pa fund.

Por, ndërsa Marku “ligjëron” se “shkrime akademikësh, me tituj profesorë, doktorë shkencash, të cilët nuk mund t’i dallosh prej shkrimeve të njerëzve të rrugëve, me inatin që mbartin, me mungesën e elegancës dhe sofistikimit të të shprehurit, pa llogaritur mungesën e argumenteve profesionale, në debatin ku duan të marrin pjesë”, vetë ky, “mentori” ynë, një inatçor sarkastik, shpërfaq gjuhën e rrugës, me fyerjet, denigrimet, përçmimet ndaj kritikëve të përmbledhjes së tij, që “vërshojnë” veçanërisht ndaj studiuesve të letërsisë të nivelit të lartë, “me tituj shkencorë”, përmes “paravolive” të tij ironike “elokuente” meskine, që, në thelb, janë po “kulturë” e rrugës së injorimit dhe poshtëritimit. Për shkak se këta, vënë në dyshim autoritetin e tij letrar të poetit laureat. Ngaqë, poezia më e bukur shqipe e kohës sonë, për Markun, është ajo e anëtarëve të komisionit zyrtar të ministrisë së Kulturës që e votuan dhe i dhanë titullin “Laureat i Poezisë” dhe ai, si “mirënjohës”, iu kthen “nderin” duke i përfshirë në antologjinë e tij pragmatiste.

Dhe, në vend të objeksionit fisnik, që përmendëm në krye, Marku, ky “masovik revolucionar” i “kontrollit punëtor e fshatar në veprim”, iu vë një “fletë-rrufe” (apo “dacibao”, që përmend ai), gjithë kritikëve krijues e intelektualë e, veçanërisht, siç vumë në dukje, ndaj atyre të nivelit më të lartë, (akademikëve, doktorëve të shkencës, etj.), për “shfaqje të huaja intelektualiste”. (Dhe, ndoshta, do të ëndërronte t’i shihte me gjunjë të përveshur e krahë të përveshur, në baltrat e orizoreve të Kinës së Revolucionit të saj Kulturor të dikurshëm).

Por, siç duket, është hera e parë që ndeshet me një frymë kritike kaq totale, (ndoshta, nuk mund të sjellë dot asnjë rast që të jetë vlerësuar pozitivisht ky publikim i tij antologjik), në gjithë këtë polemikë disajavore, herë-herë të dhembshme e të sertë. (Ngaqë është mësuar, siç duket, vetëm me lavde parathëniesh e recencash të porositura miqsh). Dhe nis kështu, me një mllef të hidhtë të “logorive” e “paravolive” kundër studiuesve shkencorë, ngaqë “laureati” ynë nuk mund të përballojë një kritikë të nivelit të lartë, por, shumë-shumë, do të pranonte një kritikë të gjuhës të rrugës të cilëve mund t’iu kthehet e t’iu hakërrehet po me këtë nivel. (Dhe në ato pak parashtrime apo “argumente të tij”, mes “lumi” të fyerjeve dhe përçmimeve, paraqitur me një “elegancë të sofistikuar”, përsërit e përsërit po ato pasazhe të pasthënies së vet, për një luftë antologjish që na qenka bërë dikur në Amerikë, apo që, gjithkush që paska në mendje antologjinë e tij, ta botojë e ta bëjë publike, etj., a thua se kjo qenka e gjithë kultura artistike e këtij laureati).

Dhe ja, pasi kërkoi në gugëll dhe pa që “Antologjia e poezisë ballkanike”, botuar dhe në shqip, në Athinë, më 2006, ku përfshihet dhe ajo shqipe, me përfaqësimin historik (të Shqipërisë



politike, Kosovës e diasporës, të pandarë, unike e tërësore, si shpirti i kombit të vet), pa se nuk ekzistonte, (M. Buçpapaj, Fb, 2 maj), ndërkohë, më pas, zbuloi se ishte vetëm një “fletushkë”, (antologjia në fjalë, me 525 faqe) dhe më tej pa se ekzistonte, por e kishin krijuar ca “zhdanovistë”. Dhe, ç’është më e dhembshme, antologjia e poezisë shqipe e këtij grupi kolegjial “zhdanovist” bashkëpunëtorësh, (Y. Çiraku, A. Uçi, D. Shaplo, A.Zarballa, Z. Morava, A. Mato), në përbërje të poezisë së Ballkanit, qëndron më lart se antologjia personale e krijuesit “perëndimor” Marku. (Që, përveç të tjerash, ky i fundit, ka treguar një mungesë serioziteti dhe sjellje “çapraze” në paraqitjen tekstuale duke i shfytëruar nga ngjyrimi i tyre leksikor e drejtshkrimor të origjinalitetit, si, bie fjala, në poezitë e D. Agollit, (për të cilat ankohet, me të drejtë, e bija e poetit të shquar lirik). Kështu, vargun e poetit :” e ndofta kjo ish dashuria”, Marku e sjell në trajtën : “dhe ndoshta kjo ish dashuria”; apo vargun original: “ atyre, -vazhaze të bukura, shën. ynë.- dorën me gaz mund t’ua zgjatja”, “antologjisti” ynë e sjell në formën :”atyre dorën me gaz mund t’ua mbaja”, etj.. Pa folur pastaj për pikësimin, që ky se ka fare “për hatër” ta pasqyrojë besnikërisht atë të origjinalit,e që ka aq shumë rëndësi, në shpërfaqjen e ndiesisë së lirizmit, etj.).

Pas kësaj, fshin komentin tim kritik dhe më bllokun mua në fb-un e vet, duke parë si të vetmen mënyrë “komunikimi”, me tjetrin, mendimin tjetër, këndvështrimin ndryshe, bllokimin e këtij tjetri.

Pasi injoroi, përçmoi dhe denigroi studiues dhe personalitete të shquar të shkencës letrare shqiptare, në të dy anët e kufijve, në tv dhe gazeta dhe, duke parë një parashtrim tonë të gjatë polemist kritik e kulturologjik, në një pasqyrim me detaje të argumentimit rreth problematikës së publikimit antologjik në fjalë, në numrin e mëparshëm të “ExLibris”, 29 prill, botuar dhe nga “Nacional”, 30 prill, (përmendim, me këtë rast, se në botimin në këtë të fundit, të shkrimit tim, ka qenë në të drejtën e botuesit, për mënyrën e tij të nxjerrjes në pah të një shkrimi, që e çmon të rëndësishëm, për vëmendjen e lexuesve të tij kulturorë, duke e përforcuar titullin e shkrimit, me një okelio të vet, sepse unë nuk çoj shkrime me okelio të gatshme gazetareske), këtë radhë, Marku, në “ExLibris”, (6 prill), me sajesa libeske të groteskes së tij, me paravoli historish sançopance, universitete lakrash etj. bën objeksion dhe nis së pari, “debatin” e tij, me “një farë Dr. D. Çaça”, pra, me mua, që, siç shprehet, një emër jo i njohur, që mund të identifikohet vetëm përmes një titulli shkencor. Pastaj vijon me “argumente” të tilla, në lidhje me polemikën time, (rreth antologjisë në fjalë), për universitetin e Laknasit, laknash e lakrash, (siç quan ai Universitetin shtetëror të Tiranës dhe Akademinë e Studimeve Albanologjike, dy institucionet më të rëndësishme shkencore të shtetit tonë, të fushës së studimeve të mia filologjike universitare e doktorale), për bibliotekën e pasur të Babrrukës, më tej, për Synejin e vendlindjes sime, një fshat i rrethit të dikurshëm të Durrësit, sipas kartës sime të identitetit, pranë Kavajës, (se ç’lidhje ka vendlindja ime, kaq larg me Tiranën dhe rrethinat e saj, ku unë nuk banoj e jetoj atje, vetëm ky “laureati” ynë i “shquar” mund t’i japë “dum”).

(Bëjmë një parantezë, me këtë rast, se vendlindja, qoftë ajo toponimi më i padëgjuar, prejardhja familjare, shoqërore, etj., që burojnë prej saj, në kontaktet e para me botën e njerëzit, kurrë nuk mund të jetë objekt denigrimi, për më tepër, për një poet që mban shpirtin e botës dhe që ndihet, me humanizmin e tij të pakufishëm, si qytetar i gjithë kësaj bote. Përkundrazi, edhe Laknas-i, edhe Babrruja e rrethinave të Tiranës, që përçmon aq shumë poeti ynë “elitar”, edhe Syneji, vendlindja ime e dashur, etj., janë po kaq të dashur e të shenjtë për secilin bir të tyre e që çdokush e merr me vete, këtë vendlindje të vet të përjetimeve të para, (aq më tepër, poetike), jo thjesht, për nostalgji e mall, por dhe si nderim, kudo që shkon nëpër botë. (Ashtu si dhe malet e Lezhës së Markut, marrin rrugën dhe bëjnë udhëtim të gjatë deri në Britani, për të shkundur borën në prag dhe për të hyrë brenda, -në ëndërr, në përmallim,- në shtëpinë e tij në Londër. Poezia “Malet”, “Një ballkanas në Londër”, 2012).

Por, veç kësaj, (vendlindjes sime që s’ka lidhje me Tiranën periferike, ku unë nuk banoj e jetoj atje), “syrit vigjilent të Partisë”, “operativit të zonës” “informatorit” të Markut, që zhbirilon akoma dhe sot, në biografitë personale të para tridhjetë viteve, (madje “ushta” e tij e ndryshkur e denigrimit, po të vazhdonim dhe ne me parodinë e tij të groteskes libeske donkishoteske), e “kalorësit fytyrëvrerosur të vetë sojliut tonë mendjemprehtë”), pasi ka “çpuar” me radhë dinjitetin e personaliteteve dhe krijuesve të shquar të kulturës e shkencës letrare shqiptare të Kosovës e Maqedonisë që, sipas tij, na paskan qenë bashkëpunëtorë të pushtetit represiv serb dhe të atij shtypës sllavomaqedonas (A.A., M. K., A.V., etj.), dhe, pasi iu vë nga Dr. përtallëse gjithë të tjerëve, (S.Ç. etj.), “çpon” më tej një tjetër kritik të tij, “si pinjoll të një ish-sigurimi, D. M.,etj., - shih, “ExLibris”, 6 prill), pra, teksa

merr hov drejt meje, “syrit vigjilent” të tij i ka shpëtuar “fakti”, apo “argumenti”, se, kursi im i plotë i anglishtes është zhvilluar, jo nga Shuaipi, që nuk e njoh se kush është e që s’ka asgjë të keqe dhe po të ishte “mësuesi” im, madje do të ketë qenë njeri i kulturuar, përderisa zotërontë gjuhën angleze që, në qytete të vegjël, në vitet ’80, pak njerëz e kishin një kulturë të tillë, (se ç’lidhje ka kjo, se nga kush e paskam mësuar anglishten, me “antologjinë” e tij të poezisë shqipe “të tjetërsojtë” dhe me parashtrimet tona kritike rreth saj, një zot e di, siç thuhet në këto raste, por ja që duhet t’i japim një përgjigje, ironisë harbute të Markut), por nga Beat Foster, një misionar zviceran, që kishte kryer studimet e larta për teologji në Britani dhe që erdhi dhe u vendos bashkë me familjen e tij, në një banesë pranë vendlindjes sime, duke hapur një qendër misionare dhe humanitare, në vitin 1992, ku unë, krahas leksioneve metodike të metodave të kohës, zhvilloja dhe një anglishte të bisedave fillestare familjare, me atë, fëmijët e tij dhe me të shoqen, teksa na shërbente çajin ritual të pasdites me biskotat përkatëse, (që iu shpreh, me këtë rast, gjithë nderimin e sinqertë, kudo që të jenë). Dhe që, për shkrimësinë time eseistike letrare shqipe, nuk më ka dalë e nevojshme ta perfeksionoj njohjen e kësaj gjuhe, me një anglishte refugjati të Londrës, si poeti në fjalë.

Në parantezë, kjo, ngaqë brezi im, në të gjithë arsimimin e tij, ka patur si gjuhë të huaj, rusishten, thuajse në të gjithë Shqipërinë, -qytete të vegjël e shkolla rurale,- ndërsa anglishtja zhvillohej vetëm në pak qytete kryesore, (nderoj, me këtë rast, mësuesen time të mrekullueshme të rusishtes të gjimnazit të Kavajës, Dh. Karkini, si dhe pedagogen time dinjitoze të gjuhës ruse të fakultetit të filologjisë së Universitetit të Tiranës, (ose kujtimin e saj), Gj. Aleksi. (Një rusishte që s’na hyri kurrë në punë, por që sot është bërë një gjuhë e vlefshme kulturore, turistike, biznesi, etj. si çdo gjuhë në botën tonë të hapur të sotme).

Por një mendje e kthjellët, (pa delirin e madhësisë apo marrëzinë e madhështisë) thotë, (në këto raste) jasht sarkazmës së pafuqishme dhe groteskes libeske se nuk ka ndonjë lidhje kursi i anglishtes së dikujt të zhvilluar nga dikush, para më shumë se 30 viteve, më 1992, me polemikën rreth antologjisë së re të poezisë shqipe, të promovuar pak javë më parë.

Siç duket, për Markun, mendjen bizare të tij, funksionon ende, dhe pas dekadash demokraci, taktika e vjetër (komuniste): Godit dhe zhvlerëso autorin e shkrimit kritik, me “fakte” të jetës personale të dhjetëra viteve më parë, se shkrimi me materien e tij të përmbajtjes, zhvlerësohet vetiu, “për arsye biografike”.

Duke qenë se për Markun e “famshëm” jam një anonim, pa ndonjë emër dhe që, në vend të tij, përdorkam për identifikim një titull shkencor, le t’i paraqitem thjesht dhe përmbledhtas. (Edhe pse nuk merrem me letërsi, për emër, por si një mënyrë të jetuari që më plotëson, më realizon e më përmbush shpirtërisht e estetikisht, ndërkohë që, po qe se ajo që krijoj e shpërfaq, - poetikë e eseistikë letrare kritike,- paraqiten si vlera më të gjera kulturore të jetës sonë shoqërore, aq më mirë. Ndërsa bërja “emër” me pagesë deri në 500 euro për 10 minuta televizive te moderatorë emisionesh tv-sh, -të veshur me zhveshje që s’kanë lexuar një libër në jetën e vet, - apo me recensionë me pagesë, më neveriten). Jam autor i disa botimeve artistike dhe studimore, botimi më i fundit, ai i para disa muajve me eseistikë letrare kritike, “Shenjime të literaritëtit” që, nëse do të kishte ndonjë kureshtje, mund ta shfletojë (dhe kalimthi), në librarinë “Adrion” dhe në libraritë e tjera kryesore të Tiranës. Po, kështu, nëse do të vijonte më tej interesimi i tij kulturor, mund të shfletonte gjithashtu dhe botimin tonë tjetër, “Diskursi i tragjikës në letërsinë shqipe”, këndvështrime të thelluara kulturologjike, në “një horizont të ri të dijes”, siç do të thoshte Hans Gadamer, (vlerësuar kjo punë ime, si një ndihmesë me vlerë në studimet tona të disiplinave të reja shkencore siç janë ato semiolinguistike e hermeneutike të shkencës sonë të sotme, nga akademikët tanë etj.). (“Për dreq”, përsëri na dalin këta akademikët që, ky lloj mizogjini, i urren dhe i ka tmerr kaq shumë, -jo gratë,- por studiuesit letrarë të nivelit të lartë). Madje, indinjohet që gazeta serioze “ExLibris”, i jep një hapësirë të gjerë polemikës sonë kulturologjike duke menduar se faqet e saj janë veç për broçkullat e tij, me lakra e synete.

Nëse do të shërbenin si parashtrime kritike letrare, për “Antologjinë” aktuale “argumente” të tilla mjerane, (të dhëna biografike të dhjetëra viteve më parë, apo sarkazma të tij parodike, me marrëzi të tilla, si “universiteti i lavdishëm i Laknas-it”, “doktori i Laknasit”, “çorbë laknasiane për artikull kritik”, “mjeshtri i Laknasit”, “biblioteka më e pasur deri në Babrrukë”, “anglishtja e kursit të profesorit ambulant” e marrëzi të tjera “plot elokuencë” të këtij deliranti, (një mjerim i skajshëm, shpirtëror, intelektual e “poetik”), mund të vazhdonim dhe ne me të tilla “të dhëna”, por që s’janë argumente, (apo, dhe po të ishin, do të qenë po aq mjerane, sa dhe ato të antologjistit në fjalë), si: vepra letrare, që mund të konsiderohet e plotë, e këtij autori, tashmë

në një moshë prej kohësh, mbi të shtatëdhjetat, nuk ka zënë vend në programet, tekstet e antologjitë shkollore të sistemit të arsimit tonë parauniversitar dhe, kuptohet, as që bëhet fjalë për detyra kursi apo punime diplome të studentëve të letërsisë, aq më pak për teza doktorature të studiuesve të rinj, rreth veprës së tij poetike e romanore (ndërkohë që poetë të tjerë të brezit të tij janë prej kohësh pjesë programesh shkollore dhe monografish studimore. Madje, kur pyeta njëherë studentët e mi të letërsisë, të Universitetit publik të Durrësit se ç'kishin lexuar nga poetët e sotëm duke iu paraqitur dhe një botim të fundit poetik të autorit të polemikës sonë, përveç përmendjes së dy-tre autorëve të rinj, vetëm një vajzë tha se e kishte dëgjuar një herë këtë emër në një emision televiziv, etj.).

Këtu është rasti të bëj një parantezë për një gjykim tonë në parashtrimin tonë të gjatë të mëparshëm, (Objeksione dhe përsiatje, "Veshun me diell, mbathun me hanë", ExLibris, 29 prill), në lidhje me tre poetë, poezia e të cilëve, në perceptimin tim, është e një niveli mesatar, ndërkohë që shpërfaqen si prozatorë të spikatur. Autori i romanit të shquar, "Dueli", lexuar që në botimin e parë, (në revistën e çmuar "Alef" të botuesit "të vogël" fisnik, G. Çoçoli, që ka sjellë në shqip 10 poetët e mëdhenj amerikanë të shek. XX, në përmbledhje antologjike të tyre më vete, në shqipërime mjeshtërore, (sigurisht, jo përkthime të Markut), si dhe shkrimtarë të shquar për herë të parë në shqip, si: L.Kraznohorkai, T. Bernhard, etj.), por dhe në romane të tjerë të këtij shkrimtari të njohur, si, romani po kaq i shquar "Fabula rasa" e të tjera vepra romannore të mëpasme, deri te më e fundit, ndoshta, (meqenëse akoma s'më ka rënë në dorë) "Ngjizja e papërllyeme", është një nga autorët që e çmoj së tepërmi, edhe për eseistikën e tij letrare, bie fjala, në paraqitjen e poetëve, si Hatibi, Belliu, etj., gjer dhe me entuziazmin me të cilët inkurajon të rinjtë në librat e tyre të parë poetikë, si poeten e re, Sh. Axhami, revista "Illz", etj; si publicist me "Thembrën e akcilit", por dhe si përkthyes i poetëve të mëdhenj rusë, Brodski, ("Stacioni në shkretëtirë", Mandelshtam, ("Tristia"), etj.. Ndërkohë që poezia e tij, nuk më "ngjit" në shijen time subjektive estetike, (kriteri kryesor, i pretenduar, edhe i Markut, për antologjinë e tij të poetikës shqipe), ngaqë më duket e një sintakse të kalkulluar dhe të komplikuar, megjithëse, siç kam parashtruar gjatë në shkrimin e mëparshëm, e ndërlikuara dhe e tensionuara janë vetitë e modernes, ndaj qartësisë dhe të harmonishmes së strukturës prozodike klasike. (Le të jemi njëherë të sinqertë me veten, ta hajë dreqi, jasht politesës dhe kortezisë hipokrite të klaneve dhe tarafeve kulturore të kryeqytetit, -që janë jo drejtime e rryma letrare, - ku provincializmi është ulur "këmbëkryq", më shumë se në qytetet e vegjël të ashtuquajtur provincialë)!

A nuk do të ishte më bukur që, për antologjistin tonë, në vend të arrogancës e fodullëkut cinik, p.sh. kur përçudnon emrin e poetit (të ndjerë) të njohur të viteve "60, Vehbi Skënderi, në Skënder Vehbiu, kur përtall filologen e shquar, tashmë e moshuar, duke iu drejtuar si "zonjusha K.K.", a "poetin doktoral" A. V;

apo, në vend të megalomanisë, (kur shprehet se antologjinë më të bukur e krijon ai që lexon që në fëmijëri e që bëhet shkrimtar më pas, duke aluduar për antologjinë e tij, kur, kush shkrimtar i ardhshëm nuk është magjepsur fillimisht nga leximet e tij fëmijërore, si kontakti e komunikimi i parë me artin e letërsisë?);

apo që, në vend të narcisizmit, (kur përzgjedh veten e vet, në antologjinë që bën po vetë, për poezinë e të tjerëve, me një arrivizëm të paskrupullt, teksa përjashton prej saj poetët e mëdhenj Podrimja e Shkreli, ndërkohë që "në Kosovë, -siç vë në dukje, portali kulturor "Hejza", në një editorial të saj për antologjinë në fjalë, - ka shkolla të poezisë shqipe e që as nuk e kanë në "hesap" poezinë e Rudolf Markut").

Sjellim në vëmendje, se poeti laureat, në këtë rast, R. Marku, kishte për detyrë, në mandatin e tij 2-vjeçar "shtetëror", (2020-2022), pikërisht të promovonte poezinë shqipe të gjithë hapësirës së saj, siç shpresuan edhe dy ministret e Kulturës të dy shteteve tona, të pranishme në ceremoninë zyrtare të laureimit në fjalë, të cilat nuk do të dëshironin ta shihnin të ndarë në: poezi të Shqipërisë, poezi të Kosovës, poezi të diasporës, (në një botim të financuar, natyrisht, nga "shteti amë" e që Marku e "paska kuptuar" kaq ngushtë "estetikisht", vetëm për poezinë e Republikës së Shqipërisë), siç doli të ishte, dhe në të vërtetë, e ashtuquajtura "Antologji e poezisë shqipe" e të ashtuquajturit "Laureat i poezisë shqipe".

Pra, a nuk do të ishte më bukur që përgatitësi i antologjisë në fjalë, në vend të reagimeve nervoze përtallëse, përçmuese e poshtëruese për kritikët e përmbledhjes së tij, të mund të bënte jo një "mbrojtje", (se nuk mund të gjykohet shija estetike e dikujt, siç thamë që në krye), por një shpërfaqje të mrekullueshme të "veprës" së vet, (në vend të këtij dufti idhnak, pa argumente), si, bie fjala, çfarë e ka ngazëllyer në perceptimin estetik të një poeti, ç'e ka tronditur në personalitetin krijues të një poeti tjetër, ç'metaforë e ka "goditur" në një poezi, p. sh. të një poeteje të re fillestare që, menjëherë, pa një, pa dy, e ka shënuar ta përfshijë, i lumturuar befasisht? Dhe kështu, për të gjithë autorët e tij të dashur, po të ishte e nevojshme, (apo për ata që janë parë me mëdyshje nga kritika), gjer tek i fundit.

Një projektion "argumentesh" estetikë shpirtërorë të sinqertë, siç e do natyra e fisnikëria e poetit, por dhe dinjitoze, njëkohësisht. Duke u shpërfaqur kështu, njerëzor e i ndriçuar, me qashtërinë e çiltërinë e një profeti, edhe sikur kritikak e gjithë botës, të drejtoheshin kundër publikimit të tij.

Për ta përmbyllur, i gjithë publikimi në fjalë (që bëmë objeksion të parashtrimit tonë të gjatë të mëparshëm kritik - kulturologjik dhe të këtij reagimi polemik), në rastin më të mirë mund të merret si një trill antologjik poeti, (i bukur "çmendurish", në ajthin e tij vetjak estetik), por që, edhe s'duhet t'i jepet kaq rëndësi e të merret seriozisht, si çdo trill.

Një shkëmbim mendimesh mbi Antologjinë e Poezisë Moderne Shqipe, me Muharrem Jakupin, në lidhje me kritikën dhe atë që ai e quan kriter gjeografik të Antologjisë

SHKËMBIM MENDIMESH PËR ANTOLOGJINË

Nga Rudolf Marku

I dashuri Muharem Jakupi,

Të falenderoj për komentin e sinqertë. Desha të bëj dy sqarime në lidhje me shqetësimet tuaja:

E para, kritikët. Kur flas për kritikët, unë (dhe të tjerët si unë) nënkuptojmë ata të cilët pretendojnë se janë kritikë profesionalë dhe njohës të mirë të letërsisë. Por që në të vertetë, në kundërshtim me pretendimet që kanë, me paaftesinë e tyre për ta studjuar letërsinë si të tillë, e kanë gjykuar atë si jo të tillë, me mjetet jo letrare, me anësi politike dhe ideologjike. Kur Ali Aliu përjashtoi nga Antologjia e vet, në Vitin 2002, Budin, Bogdanin dhe Fishten, ai niset nga këndvështrime jo kritike, por ideologjike, madje shumë të dyshimta, pa e justifikuar këtë perjashtim me asnjë kriter letrar a estetik! E njëjta logjikë aplikohet, kur K. Bihiku e kritikon Asdrenin për kërkime formaliste, duke rekomanduar mosbotimin dhe mospërfshirjen e poezisë së tij 'Merzi Vjeshtë'. Ose lexo dhe komentet kritike mbi Jeronim de Raden, një shkrimtar madhor i letërsisë Shqipe që sot e kesaj ditë spjegohet me termat Atdhetar, revolucionar, patriot, mërgimtar... Plus që kritikët jo kritikë kanë zgjedhur dhe lavdëruar dhe vazhdojnë të zgjedhin dhe të lavdërojnë gjithnjë krijimet më jopërfaqësuese të autorëve tanë!

Nga ana tjetër, nese unë flas për të metat e këtyre kritikëve, nuk do të thotë se jam a pretendoj të jem kritik letrar. Nuk duhet të jesh piktor ose poet të flasësh për pikturën a poezinë!

Kam respekt për të gjithë kritikët që e analizojnë letërsinë dhe krijimtarinë letrare me mjetet e letërsisë, të cilët flasin permes mjeteve shprehëse të saj, që flasin për formen, që e shohin poezinë shqipe si pjesë të poezisë botnore, edhe atëherë kur nuk jam 100% dakort me shijet e tyre, te tillë si i ndjeri Ardian Klosi, një erudit dhe njohës i mprehtë i letërsisë, apo Ardian Vehbiu a ndonje tjetër; i respektoj mendimet e tyre, edhe pse shpesh herë nuk jam në një mendje me atë që sot përmbledhet brënda asaj që thërret negativisht *Cancel Culture*. I respektoj, sepse sido të jenë, janë studjues dhe kritikë të vertetë profesionalistë, që sjellin argumente formale në ndihmë të asaj që argumentojnë, sepse sjellin argumente bashkëkohore dhe logjike, dhe, mbi të gjitha, dinë të shkruajnë!

E dyta: Antologjia që dhe ju e kritikoni (dhe askujt nuk i shkon ndërmend të të quaj kritik), është hartuar për prezantimin e poezisë së shkruar në shtetin shqiptar. Nuk jam nisur të hartojë një Antologji mbarë shqiptare, siç shprehen shumë vetë! As dhe një Antologji me kriter gjeografike, kriter të cilin e konsideroj *non sens*, siç e kam



sqaruar në një shkrim në ExLibris! Sespe po të nisemi që të hartojmë një Antologji Gjeografike, ku mund t'i vendosim, në ç'cep gjeografik dhe kufitar, Poetët tanë të mëdhenj si Nolin, Konicen, Camajn, Naim Frashërin, Çajupin, Seremben, Zef Skiroin?

Antologjia mbarëshqiptare do të kërkonte një vizion tjetër dhe një strukturë tjetër, ndoshta një grup autorësh që e njohin mirë poezinë shqipe që shkruhet ne Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Ata autorë që njoh nga Kosova, më pelqejnë dhe i admiroj, por jam i bindur se ajo çka njoh unë, është veç nje grimcë e së tëres! Prandaj vendosa të hartoj një Antologji të asaj që njoh! Ndaj dhe ajo është një Antologji që mban veç emrin tim të përvetçëm si hartues i saj, duke nënkuptuar se do të ndiqet nga dhjetra, mos dhe nga qindra, Antologji të tjera.

Edhe diçka tjetër: gjatë viteve të fundit, edhe poezia shqipe në shtetin shqiptar, edhe ajo në Kosovë e Maqedoni e Mal të Zi, është shtuar me shumë autorë të rinj, të cilët në fakt nuk janë dhe aq të rinj në moshë! Duke botuar vazhdimisht poezi gjithëpërfshirëse, këtyre autorëve te paevidentuar kurr nga kritika, nuk do t'u bjerë rasti kurr të përfshihen e të evidentohen, ngase vendet e Antologjive e zënë emnat e fosolizuar dhe te shenjëtruar, të cilët janë mësuar me qenë të përjetshëm! Kjo ishte njëra nga arsyet që më shtyu të botoj një poezi shqipe të asaj që njoh - me prurjet deri te emnat më te rinj! Madje, edhe duke e botuar Antologjinë kështu siç është, kam lënë padrejtësisht jashtë Antologjisë dhe shumë poetë të tjerë të Shqipnisë, që do ta kishin merituar për të qenë pjesë e kesaj Antologjie! (dhe këtyre autorve u kerkoj të falur!)

Nga ana tjetër, mendoj se herë pas here dhe për vetë Kosoven dhe dinjitetin e saj intelektual, por dhe shtetëror, do të qe mirë që të dali me Antologjinë e vet të poezisë shqipe. Prishtina ka Shtetin e vet të pavarur, Ministrinë e vet të Kulturës, po ashtu si dhe Tirana. Natyrisht jo gjithmonë, por herë pas here, a nuk do të qe më mirë të botoheshin, krahas Antologjive gjithë përfshirëse (të tilla mund të kemi të botuara mbi 100 Antologji nga të dyja anët) dhe Antologji të poetëve të Kosovës dhe Antologji të poetëve nga Tirana, si Antologji alternative, si një mundësi e evidentimit të zhvillimeve më të fundit të poezisë në Prishtinë dhe në Tiranë? Nëse poezia Shqipe e Kosovës, e Malit të Zi dhe ajo e Maqedonisë së Veriut do te botoheshin përherë si appendix, si një shtesë e Poezisë së Tiranës (me 30 autorë nga shteti shqiptarë, dhe vetem me 3 a 4 autorë nga Kosova), një gjë e tillë do të bënte efektin e kundërt, duke e zvogluar rolin dhe rëndësinë e vetë poezisë shqipe të Kosoves dhe të Maqedonisë. Sa kohë të vazhdoj kjo traditë, që në emrin e ' patriotizmit', ne do të vazhdojmë ta paraqesim poezinë *e gjysmës tonë* si një periferi te poezisë që shkruhet brenda kultures mbarëpërfshirëse, poezia shqipe e shkruar në Kosovë dhe Maqedoni do të konsiderohen si Hirushet e letërsisë Shqipe prej vetë kritikëve hipokritë që flasin kinse për ' të miren e saj'.

Të falenderoj sinqerisht për komentin tuaj!

Ps: mund ta shtjelloja më hollësisht piken e dytë sidomos, por nuk është vendi këtu. Ndonjë ditë do shkruaj më gjatë rreth këtij problemi, për të nxitur ndoshta, në shtypin shqiptar, një debat më të gjërë!



1- Dy fjalë për rileximin

Me Gjergj Fishtën, ka ndodhë diçka prej feniksi; një ringjallje prej hirit të vet. Rikthimi ka ndodhë vetvetishëm, si një duf i mbrendshëm, i ndrymë, që shpërthen e përhapet në ajrë sapo të bjerë në kontaktin e parë me lirinë. Kjo ndodhi atëherë, kur agoi sërish liria mbas territ të gjatë të dhunës, në kapërcyellin e vitit '90 të shekullit që shkoi.

Fotografia e tij nuk u shfaq menjëherë. Solucionet e lirisë e shfaqen figurën e tij me ngadalë dhe në paqe, tamam sikur stampohet një pelikul e vjetër filmi në dhomën e errët.

Jashtë dhomës së errët, te korridoret e lirisë kishte nisë një garë e rrëmujëshme e e furishme, me turravrap se kush të merrte më shumë kredite emërpërmendjeje. Në sintoni me gjithëcka tjetër euforike që ndodhte asokohe.

Për do vite të mira flitej e përmendej, me rend e pa rend, i mvisheshin atij edhe lãvde që s'kishin qenë të tijat e s'kishin pasë lidhje me të, e s'ishte nevoja për to, kurse ajo çka vetë Fishta ishte, vetë shkaku i përmendjes, ajo që e kishte pasë kthyer emrin e tij në një mit qysh në gjalljen e vet, pra vepra e tij letrare e të gjitha gjinive që ai kishte lëvruar dhe veprimi i tij publik në dobi të Shqipërisë e Shqiptarëve, vijonte të ishte prap e strukun në harresë e nuk e kishte kapërcye ende prapun e dritës. Tek tuk filluan të dalin prej skutliqeve të shtëpive qytetëse e të periferive, kopje të "Lahutës...", ndonjena edhe me autografin e vetë autorit, më së tepërmi për të dëshmuar rezistencën e heshtur ndaj dhunës e rregjimit që e administronte atë, sikurse do persona të tjerë, në të njëjtën sintoni, mund të recitonin pa u ndalë njëmijë e më shumë vargje prej saj.

U rikthye botimi i "Hyllit të Dritës", filluan të ribotohen disa prej veprave ("Lahuta...e para), Kurse nga Roma, në shtatorin e 1992-shit do të na kthehej retrospektiva e parë e shkruar: "Gjergj Fishta-Jeta dhe veprat" me autor Pal Duka Gjinin (Daniel Gjeçaj), ish nxënësi e më pas bashkëmësues me vetë Fishtën në Liceun "Ilyricum"- shkollën françeskane në Shkodër. E para përmbledhje jetëshkruese e Poetit mbas asaj që më 1941, kishte përgatitë At Benedikt Dema, e tjetrës së po të njëjtë vit, që e kishte nxjerrë revista "Shkëndija" në Tiranë, nën përkujdesjen e Ernest Koliqit, një vit mbasi Fishta ishte nisë në botën e qiellit...Po pati edhe studime serioze përreth kryeveprës së tij; "Lahuta...ngjizja mitologjike"(Tonin Çobani) ase "Fishta satirik" (Stefan Çapaliku). Kurse sipërmarrja e parë për një "Opera omnia", e cila pati mbetë një projekt i paplotësuar i Institutit të Studimeve Shqiptare nga viti 1942, filloi në vitin 2001 dhe mbaroi ne vitin 2012. Që është edhe botimi i parë, i plotë i veprës së Fishtës (Enti botues "Gjergj Fishta").

Duke qenë në krye të këtij projekti editorial, në bashkëpunim me një redaksi të zgjedhur studiuesish, njohësit më të thellë të shkrimtarit dhe veprës e kam ndjekë në të gjitha dimensionet krejt atë që mund të thirrej "rikthimi i Fishtës". Me linjën e drejtë e me zigzaget që ajo ka përshkruar përgjatë dekadave te kohës së lirisë; me pohimin dhe me heshtimin si një mënyrë mohimi, me moskuptime dhe me keqkuptime, me paragjykime jashtëletrare prej nostalgjikësh të së shkuarës e me shpërfillje prej podiumeve të epërme "moderniste" të parisë letrare.

Përpyekja ime modeste për t'i shqyrtuar këto dukuri është ajo që kam dashtë të përcjell në faqet e këtij libri, si një njeri i dhomës së errët të laboratorit fishtian.

2-Dëshmia e Ernest Koliqit: ¹


Emnimi i At Gjergj Fishtës antar i Akademisë Italiane.

¹ Ernest Koliqi "Veprat, Vëllimi i pestë: Publicistikë", fq.128 (Nga "Shejzat" nr. 9-12/1972)

Nga libri "Fishta, rileximi në kohën e lirisë"


FISHTA... AKADEMIKU, "OPERA OMNIA" DHE KOLIQI NDËRMJET

Nga Frano Kulli



"...Fatkeqsisht, disa prej atyne që hiqen si supernacionalistë, pozitë të cilën fituan tue ndejtë strukun mbas një patriotizmi fals, e qortojnë poetin për faktin se me 1939 pat pranue me u emnue Akademik i Italisë. Akuzojnë mendjemadhsisht për mungesë patriotizmi mjeshttrin, i cili harxhoi tanë jetën e vet për t'u mesue shqiptarve se si me e dasht atdheun. Dhe akuza, jo veç në Shqipninë e sotme, por mjerisht edhe

në ndonji pjesë të Diasporës, ka gjetun një lloj kodifikimi. Dhe nuk synohet me u denigrue thjeshtë njeriu dhe politika e tij aqsa komuniteti prej të cilit ai rrjedhë, besnikëria ndaj traditave që i japin tharm veprës, e qytetnimi perëndimor që na ushqen me shpirtin e madh. Tue i akordue interpretuesit të shpirtit shqiptar titullin akademik, Italia dishronte me nderue Shqipninë. Qeshë i pranishem në Romë në



Letër e Prof.dott. Angelo Leoti i Universitetit të Bolonjës.
Arkivi qëndror i Shtetit, F.17, (Gjergj Fishta) D.5.F.4.

qeshorin e vitit 1933 kur u muer vendimi në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Më kishin thirrë për tu këshillue rreth çështjes në fjalë. Morën pjesë në këtë mbledhje, veç tjerëve, Zenone Benini nënsekretar për çështjen shqiptare. Ambasadorët Jakomoni i San Savinio e Karlo Straneo.

U kërkoj ndjesë ndijuesve të nderuem nëse jam i detyruem me përmend ndërhyrjen që bana me këtë rast. Ndjej si detyrë me e zbulue këtë të vërtetë, për me e davaritë hijen me të cilën përpiqen me errsue kujtimin e Poetit, të cilin e pata udhërrëfyes dhe mbështetje në rrugën time letrare.

Benini, që drejtonte mbledhjen, njoftoi se qeveria Italiane, për t'i nderue në mënyrë konkrete vlerat kulturore të kombit shqiptar, propozonte tre shkrimtarë si antarë të Akademisë së Italisë. Emnat që u përmenden ishin: Patër Gjergj Fishta, Terenc Toçi, Ernest Koliqi. Benini e dalloj menjëherë se fytyra qe kontraktue. Kishte shpresue me e pa tue shkëlqye nga krenaria, sepse më pyeti "Nuk e miraton këtë ide?" U ndieva i detyruem me folë me sinqeritetin ma të thellë. U përgjigja se ideja më dukej shumë e mirë e që një nderim kaq i naltë për vlerat e kulturës shqiptare do t'i kënaqte e do ti mbushte me krenari tanë shqiptarët, por shtova se Koliqi duhej konsiderue si një autor, cikli letrar i të cilit vijonte me qenë në zhvillim, kësisoj ende nuk ka mbërrit në atë pikë që i jep kunorzimin e përhershëm një shkrimtari.

Sa për Toçin, nuk mund të mohoj se asht një koltivues i vyeshëm i studimeve juridike e një gazetar i stervitun, por nuk ka botue asnjë vepër letrare a shkencore të tillë, sa me meritue dinjitetin e Akademikut. E mbylla me fjalët se në të tre këta emna, Fishta asht i vetmi personalitet i pakundërshtueshëm, i denjë për t'u pranue në bashkësinë e naltë kulturore italiane, me që ai dhe vetëm ai, përmblyhte në vete dhuntinë ma të shkëlqyeme të krijimtarisë artistike të rracës.

Benini, tue drejtue kah të pranishmit, vlerësoi konceptin e naltë, që unë kisha për Akademinë e Italisë. Mandej deshti me dëjtë nëse ekzistonte në Shqipni ndonji tjetër shkrimtar që meritonte me ndejtë përkrah Fishtës. U përgjigja, simbas pikëshikimit tim modest, se ekzistonin dy shkrimtarë shqiptarë që s'do të kishin ba figurë të keqe në gjinin e Akademisë: zz. Fan Noli e Faik Konitza, por shtova se banonin prej shumë kohësh në Amerikë. Kështu Fishta ishte i vetmi që u emnue akademik i Italisë. Emnimi, tue qenë se nuk ishte paralajmëruë gjeti në befasi. Fundja tue njoftë natyrën e tij krenare, qeshë i sigurtë se do ta kishte refuzue me përçmim vlersimin e naltë, nëse do t'ishin përfshi edhe dy shqiptarë të tjerë me merita letrare ma të pakta. Sigurisht se do ta kishte refuzue, e jo për mendjemadhsi, por sepse tue pranue krahas tij dy të tjerë mjaft ma të pakët se ai për nga formimi letrar, emnimi do t'ishte zveshë nga vlera e vërtetë e do të kishte marrë kuptim tjetër.

Kur mbas ceremonisë, e pashë në gjinin e Akademisë së Italisë, më shprehu tanë entuziazëm fjalët që i kishte thanë Papa Piu XII:

"Jam i kënaqun për emninin tand akademik, sepse nëpërmjet teje nderohet Urdhni i Shën Françeskut e kombi shqiptar"

Mandej poeti e la këtë temë dhe nisi të më shprehë brengat e tij për situatën evropiane. Ishim në fillimin e 1940-ës.

Nji fat i kobshem po na ndjek!" – thirri renkueshëm, a thue se po fliste me vete – "E druej fort për të ardhmen e Shqipnisë..."

Letër e Prof.dott. Angelo Leoti

Prof.dott. Angelo Leoti, i Universitetit të Bolonjës, ekspert i gjuhës shqipe, i diplomuar për gjuhët orientale në Institutin

oriental të Napolit, autor i “**L’albanese parlato**” **vocabolario italiano-albanese-albanese italiano (dialetto gegho)**, Milano 1916, i shkruan Fishtës:

(Bologna 16 giugno 1939-XVII

Eccellenza:

La nomina ad accademico d'Italia della E.V. colma di viva ed infinita gioia il cuore del Vostro modesto, ma appassionato ammiratore.

A voi, che con la forza gigante della Montagna, avete dato il meraviglioso poema “Lahuta e Malcis” (che non mi stanco mai di leggere e di gustare, il quale ben puo stare a fronte dei poemi dei piu grandi nostri autori latini ed italiani; a Voi, che con “Anzat e Parnasit” e con tutte le altre Vostre opere preziose avete saputo immortalarVi ed assurgere ad unico, vero rappresentante della letteratura albanese, giungnano le mie piu vive, sentiti, cordiali congratulazioni.

L'accademia d'italia puo ben esssere onorata ed orghogliosa di annoverare fra i propri membri il cantore di “Marash Uci” e di “Oso Kuka”.

Vogliate, Eccellenza, gradire, con le rinovate mie felicitazioni, i sensi della mia profonda stima ed i miei cordiali saluti.

prof.dott. Angelo Leoti-Via Clemente Primodi N.10 Bologna)

Bolonia 16 qershor 1937-XVII

Shkëlqesi:

Emërimi si akademik i Italisë i Shkëlqesisë Suaj mbush me gëzim të gjallë e të pafund zemrën e admiruesit tuaj modest, por admirues i pasionuar.

Ju, që me forcën gjigante të Malësisë, keni dhuruar poemën e mrekullueshme “Lahuta e Malcis” (të cilën nuk lodhem duke e lexuar dhe shijuar), e që fare mirë mund t’u rezistojë poemave të autorëve tanë më të mëdhenj latinë dhe italianë; Ju, që me “Anzat e Parnasit” dhe me gjithë veprat e tjera të çmuara keni mundur të përjetësoni veten dhe të bëheni përfaqësuesi i vetëm, i vërtetë i letërsisë shqipe, ju përcjell urimet e mia më të përzemërta.

Akademia Italiane do të mund të jetë e nderuar dhe krenare të përfshijë mes anëtarëve të saj autorin e këngëve “Marash Uci” dhe “Oso Kuka”.

Ju lutem, Shkëlqesi, pranoni, me urimet e mia të përtërira, sigurinë e vlerësimit tim të thellë dhe përshëndetjet e mia të përzemërta.

3 - “Opera omnia”

Sipërmarrja e parë dhe më serioze për botimin e veprës së plotë letrare të Fishtës u ndërmor, siç dihet, nga Instituti i Studimeve shqiptare, kryetar i të cilit qe Ernest Koliqi. Nisma zë fill pak ditë para datës 10 tetor 1942, datë, të cilën mban në krye letra që nga ky Institut i drejtohet provincialit të Françeskanëve, në Shkoder, At Anton Harapi. Letra fillon me :*“I dashuni shok - dhe vijon - Sikurse kemi nda në mbledhjen e pergjithëshme mbajtur me 21 shtatuer k.v [të këtij viti], në të cilën more pjesë edhe Ti, do të ja nisim veprimit për botim të “Opera Omnia [vepra e plotë]” të të ndjerit At Gjergj Fishta, shok i jueji rregulltarie dhe Antar i Institutit tonë.”*² Në korespondencën e mëpasme priten e përcillen propozimet, e përballen idetë rreth botimit. At Antoni, në emër të “grupit që do të kurojë botimin”, i gjegjë: *të botohen të gjitha veprat e auktorit, tue perfshi edhe artikujt e letrat e botueme*. Më pas theksohet rendi kronologjik, veprat të dallohen mbas gjinish: satirika, epika, lirika, dramatika, proza. Proza të rregullohet simbas planit



që ka lanë vetë auktori: I-Sociologji, II-Polemikë, III-Ligjirata, IV-Miscellanea [të përzjera]. Në mbarim do të shtohet epistolari...

Siç shihet ideuesit e botimit të “Opera Omnia”, pra veprës së plotë kanë arsyetuar të përfshihet e gjithë vepra e tij e të gjitha gjinive. Edhe publicistika e epistolari, letërkëmbimi pra, një “gjinì” përtej krijimtarisë së mirëfilltë letrare. Ndërsa, as nuk përmendet në këtë rast arkitektura.



Qoftë vetëm si një produkt i krijimtarisë së tij intelektuale a artistike. Gjë që nuk ka ndodhë me teatrin, bie fjala. Ashtu siç është botuar si gjini më vehte krijimtaria dramturgjike, mjaft e begatë, janë bërë edhe studime e botime të thelluara për veprimtarinë teatrore të Fishtës. Madje janë sjellë e publikuar përfundime se Fishta është edhe themelues i teatrit kombëtar, aty në Kuvendin e shkollën “Illyricum” të Shkodrës. Po a mund të zinin disa prej skicave më të

zgjedhura, qoftë edhe ndonjë fashikull të “Opera Omnia”?

Pasë parasysh se jemi , jo më shumë se një vit e do muaj mbasi Fishta ka ndërruar jetë e ka kaluar në amshim e, gjithçka e lënë prej tij është ende e paprekur, e e ruajtur me kujdes e sqimë të posaçme, deri atëherë. Jemi, gjithashtu, dy vite e do muaj para se me nisë ai çasti i anatemës e rroposjes “shtatë pash nen dhë” të autorit e veprës së tij...



Letër e Institutit të Studimeve (firmosur nga drejtori Ernest Koliqi) dërguar Atë Anton Harapit, Provinciali i Françeskanëve të Shqipërisë për botimin e “Opera omnia”. *Arkivi i shtetit F. 200 (Instituti i Studimeve Shqiptare), V. 1942, D. 37 F.200-1942*



Përgjigje e At Anton Harapit, Institutit të Studimeve: “Plani i botimit të “Opera Omnia” të At Gjergj Fishtës”. *Arkivi i shtetit F. 200 (Instituti i Studimeve Shqiptare), V. 1942, D. 37 F.200-1942*

2 Arkivi i shtetit, F. 200, V. 1942, D.37

Sikur thatësira të vazhdonte edhe pak skohë, liqeni i Nartës do të fshihej nga hartat gjeografike të botës. Si një ogur ndjellakobs, u shfaq në mes të liqenit kryqi i drunjtë i cili shenjonte vendin e tragjedisë së maturantëve të mbytur më 15 Gusht 1966, në tentativën e një pelegrinazhi në manastirin e shën Marisë. Shenjat për një vdekje, shuarje dhe zhdukje të paralajmëruar të lagunës, u bënë plot tregues të tjerë. Peshqit sa vinin e pakësoheshin. Gjallesat e liqenit, që nga dita e çeljes së dajlanit, kishin dy vite që prisnin emigrimin në det. Por tanimë dajlani pothuajse nuk e bënte punën e tij. Rrymat e shumta sidomos jugat e shiroko-levantes, dhe ostro-garbi, kishin mbartur duna të tëra me rërë, baltë, të sjella nga derdhja e Vjoses që ishte veç tre kilometra larg tij. I bllokuar ne ¾ e tij, dajlani veç oksigjen nuk mund të ishte për gjithçka jetonte në liqen.

Kurgjë nuk funksiononte si më parë. Çdo gjë ishte përmbysur. Madje edhe pronari i dajlanit kishte emigruar në Spanjë. Zëvendësi i tij ishte një peshkatar i vjetër, i cili e ndiente veten të pafuqishëm për të përballuar dhe organizuar volume aq të mëdha pune dhe mjetet e rënda si eskavatorë, buldozerë dhe makina transporti për pastrimin e dajlanit. Edhe shpendët, të vrarë pa kriter, të plagosur e të trembur nga gjëmimi i dinamitit dhe krismat e kallashnikovëve, kishin fluturuar në vende të sigurta. Asnjë piskamë kredharaku, kuak-kuaku rose, vek-vek pate... Në shurdhërinë e vet, liqeni ngryste ditën e letargonte net të shqetësua.

Niveli i ujit sa vinte e binte. Nga buzë e ujit deri në manastir, mund të kaloje në këmbë pa qenë nevoja të pajtoje sandall. Burimet e ujit, ishin shteruar dhe barishtet ujore, harlisnin degët drejt sipërfaqes. Rrallë shihje në atë pyll barishtesh të notonte ndonjë bafë e vogël, levrek apo koce e ngjallë. Të dhjetë sandallet e gjata të peshkatarëve, më tepër rrinin në stere se sa dilnin për gjueti. Edhe kur dikush merrte drejt dajlanit në netët me shkrepëtima e bubullima për të kapur ndonjë ngjallë, kthehej të nesërmen duarbosh e më i ngrysur se kurrë. Palluqet e barkave gati sa s'ngecnin në fundin e lagunës, fund që sa vinte po i afrohej sipërfaqes. As që bëhej fjalë për prishje kohe, pa lëre për një shi të mundshëm. Njerëzimit u ishte tharë buza për një pikë ujë. Ashtu si edhe njerëzve që rropateshin disa kilometra rrugë për t'u furnizuar me ujë të pijshëm, edhe mijra rrënjë ulliri që qarkonin gjithandej fshatit Nartë, përvëloheshin për ujë. Nga ana tjetër, me liqenin lidhej edhe fakti se gjysma e banorëve të fshatit ishin të punësuar në ndërmarrjen e kripës. Mosfurnizimi i parcelave të kripores me ujë liqeni, do të thoshte papunësi.

Në muzgun e një dite të nxehtë qershori, dielli që po ulej mbi ishull, përfllaku dhe krahët e bardhë të një çifti pelikanësh. Shpendët si në një rikonjicion luftarak, flatruan mbi liqen disa herë, deri sa vendosën të mblidhnin krahët dhe hidhnin spirancë pikërisht përballë shtëpive të fundit të fshatit.

- Ogur i mbarë, mërmëriti peshkatar i vjetër i dajlanit, i cili i kishte ndjekur qysh kur shpendët ishin shfaqur nga veriu. Ndjeu një ngazëllim fëmijnor nga prania e tyre dhe u përlot kur pa se ata u qetësuan mbi liqen.

- Mbarësi- foli me zë dhe si u drejtua nga manastiri bëri kryqin tri herë Dhe me të vërtetë mrekullia do të ndodhte pas disa orësh. Nga jugu e perëndimi, qiejt u çan nga zigzaku i vetëtimave dhe bubullimave që shoqëruan një shi të paparë për muaj të tërë. Litarë të trashë uji vareshin nga lart. Peshkatarët e rinj nuk pyetën për kohën e keqe dhe u mëshuan palluqeve me këcin e sandalleve, drejtuar andej ku vetëtimat shuanin etjen në ujërat e pakta të dajlanit. Katër prej sandalleve u kthyen ndaj të gdhirë ndërsa të tjerët gjuanin ende. Të kthyerit nuk dinin se ku ta çonin prodhimin. Frigoriferët e tyre ishin për përdorim shtëpiak. Ngjالات ishin ende të gjalla dhe lëviznin në enët plastike që sollën gratë me ngut.

VRASJA E PELIKANIT

tregim nga Spiro Qirzidhi



- Lavdi Zotit... Dhoksa edhe ty Shën Mëri, uroi plaka më e vjetër

- Lavdi krahët tanë mana, qesëndiste i nipi.

Ishte fenomen i njohur fakti që ngjaltat e trembura nga vetëtimat e bubullimat, braktisnin foletë dhe si qafonin njera-tjetrën, tanimë të transformuara në një top të stërmadh, orientoheshin drejt dajlanit në një tentativë për jetë a vdekje për të fituar lirine në det të hapur. Pra koha ishte grackë për to por flori për peshkatarët, të cilëve u duhej vetëm të hidhnin po-të në ujë dhe t'i nxirrnin andej plot peshq.

Në drekë shiu pushoi. Shumica e peshkatarëve i vunë re pelikanët, të cilët po u afroheshin barkave pa kurrfarë ndjenje frike. Era e peshkut i joshte dhe ata notonin pa drojë. Kurrkush nga ata që po ndiqnin këtë skenë nuk u habit nga prania e shpezëve, përkundrazi e quajti pjesë të pandarë të pejzazhit shekullor, që ishte shpërbërë nga lufta civile e 97-tës. U dhanë peshq e ngjala ndërsa çifti rrihte krahët në shenjë falënderimi. Pas pak, pelikanët u larguan nga barkat si me një ndiesi turpi, për aktin që po bënin sepse mashkulli po kërcente mbi kurizin e femrës. Pak çaste më vonë ai rrahu krahët dhe rrëshqiti i lumtur mbi liqen.

- Do të kemi edhe zogj të tjerë- tha peshkatar i vjetër. Asnjë të mos i prekë.

Mbasdite shiu nisi dhe më i vrullshëm. Uji i liqenit po shtrihej e zaptonte tokat që i kishte lënë të lira muaj më pare. Por nga ana tjetër, shiu krijoi një gjendje shpirtërore të mirë tek banorët e dy fshatrave buzë lagunës, të cilët pa nguruar iu kthyen punëve të bujqësisë duke u marrë me vreshtarinë, kurorat e ullinjve e me perimet. Të punësuarit në kripore nisën përgatitjet për sezonin e ri. Pra e ndienin veten të lumtur dhe shumica e njerëzve, ia atribuonte këtë mrekulli Shën Marisë, manastiri i së cilës ishte restauruar dhe priste e përcillte në pelegrinazh të huaj e vendas.

Por kishte plot që mendonin ndryshe dhe këtë mrekulli ua dedikonin atyre shpezëve të moçëm, me atë lloj sqepi katana e që nuk ngopeshin me peshk. Dikush propozoi që t'i ballsanisnin dhe t'i vendosnin në kishën e fshatit. Por peshkatar i vjetër ia preu;

- Të paktën sa të jem unë gjallë, jo.

Çudia vazhdonte ende dhe të gjithë e ndien se përveç pelikanëve në kallamishtet rreth liqenit jeta ishte rikthyer. Piskama e shkurtes dhe mëllenjës sqepverdhë, përzihej në harmoni me flatrimin e thëllëzës, shapkës dhe gugatjen e gugutisë dhe pëllumbave të egër me foletë lart në shtufin e Tri-Portit. Por i tërë ky pejzazh i ri, nuk mund të kuptohej pa praninë e fazanëve të arratisur nga Pish-Poro, shpesë që mbartnin në puplat e tyre vetë ylberin. Apo sëkërxhinat me krahët e pikëluara dhe fluturimin e tyre unikal në ditët e ftohta të dimrit dhe sezonit të vjeljes së ullirit, tek formonin në qiejt e botës, mijëra

pasqyra marramendëse. Nga dita në ditë shtohesh shoqëria e pelikanëve me shpendë të tjerë uji si rosa dhe pata e egër, bajzat e tek-tuk ndonjë mjellmë.

E nesërmja gdhiu me shi. Rigonte i butë e të krijonte përshtypjen sikur sipërfaqen e lagunës e cimbisnin insektet e ujit. Çifti i pelikanëve po fluturonte dhe nuk e di pse nguronte të ulej. Pastaj ata vendosën dhe si rrahën krahët, u paqtuan pikërisht përkarshi shtëpive të fundit të fshatit. Nuk kaloi shumë dhe një breshëri automatiku u dëgjua gjithandej. I pari që vari kokën në sipërfaqen e ujit, ishte mashkulli. Femra e tmerruar nga e kuqja e gjakut, u ngrit në fluturim, por edhe atë e këputën me një breshëri të dytë.

- Pse o Zot, pse na mallkon kështu- hoqi në shpirt peshkatar i vjetër dhe qau.

Kështu kishte qarë edhe për ata që vriteshin më kot gjatë luftës civile. E po ashtu edhe për ato mijëra rrënjë ulliri të prera, sakatosur, masakruar dhe djegur po nga ata vrasës të 97-ës. Kishte qarë e mallkuar të gjithë ata që vrisnin peshk me dinamit në det dhe në liqen. Por këtë radhë lotët ishin për çiftin e pelikanëve që i preu në besë njeriu i keq. Natyra u kishte falur shpezëve një liri të pakufi në liqen dhe i keqi njeri ua rrëmbeu me fishekë kallashnikov. Qanë edhe fëmijët e dy fshatrave. Tanimë ata nuk mund të rrëfenin për çiftin e pelikanëve, prapësitë në kuzhinat e nikoqireve dhe garat buzë liqenit, në prani të tyre.

Po atë natë qielli u flakarit nga vetëtimat që shuheshin fare afër kuadrateve të kripores. Një shi i paparë nisi ndaj të gdhirë. Fushat e kripores u mbytën sakaq dhe ujërat e tyre, me një densitet të lartë kripe, vërshuan drejt liqenit dhe një pjesë drejt hidrovorit, i cili kurrësi nuk mund t'i bënte ballë asaj inondate.

- Filloi Katakлизmoja. Po ti o Noe, ku je?- pyeti i habitur plaku dhe ndali vështrimin nga ishulli i Manastirit ku pritej të shfaqej barka e madhe e kapedan Noes.

Laguna u fry në nivelet maksimale dhe uji i saj hyri në oborret e shtëpive në lagjen perëndimore. Ky kërcënim ishte i papritur. Ishin lutur për një pikë shi pas thatësirës gati tre vjeçare dhe po shpërbleheshin me një kataklizmo të vërtetë. I vetmi shpëtim nga kjo mënxyrë e re, ishte shkarkimi i ujërave nëpërmjet hidrovorit ose dajlanit. Por hidrovorit ishte i tejngopur. Dajlani mbeti si i vetmi shpëtim nga përmbytja.

Pafuqinë për t'i bërë ballë asaj situatë, peshkatar i vjetër e tregonte dukshëm tek e shihje me krahët e varur poshtë. E ndiente veten të braktisur nga pronari, të harruar nga gjindja e fshatit madje edhe nga familja e tij, që e shihnte si njeriun më të paaftë në fshat. Ai e dinte fort mire se hapja e dajlanit mund të arrihej vetëm nga mjetet e rënda. E ato kishin për zot pikërisht ish sekretarin e partisë për kooperativat e bashkuar Nartë, Zvërnec-Panaja. Ai ishte nga Spinarica (Zvërneci

perëndimor) dhe e mbante veten me të madh edhe në kohën e diktaturës. E kjo sipas tij, fal prejardhjes së tij të hershme, nga një fis i dëgjuar vllahësh e kur Spinarica në kohën e pushtimit Anzhuin, jetonte shkëlqimin e vet maksimal.

- Mirë që me gjyshërit e tu mburreshe lartë e poshtë, po me ne të shkretët ç'kishe?- mendoi peshkatar i vjetër dhe për të satën herë mërmëriti;- Jo, jo atij, kurrësi jo. " Kanali pak e nga pak po merrte formën e duhur. Një digë e ngushtë argjili përzierë me zhuka, mbeturina rrjetash peshkimi, barishte pengonte ujë e lagunës të vërshonte e të mbushte kanalin që përfundonte në një basen rrethor në mes të avllisë. Natën peshkatar i prishi digën dhe sakaq ujë mbyti kanalin dhe mbushi basenin. Të nesërmen nga dreka ai vuri re qefujt e parë që notonin çakërcejf nëpër kanal, në kërkim të ushqimit të bollshëm që servite baseni. Një sistem rrjetash i sajuar me mjeshtëri nga ai, i fuste peshqit në një grackë pa kthim mbrapa.

Për disa muaj kanali shërbeu si një lopë që milej për natë. Mjaft të fusje po-në dhe peshqit përpëliteshin në rrjetë. Kërkujt nuk i ra në sy marifeti i peshkatarit, deri ditën kur kaloi aty si rastësisht vllahu i Spinaricës. Ai e denoncoi peshkatarin me akuzën hajdut të pronës socialiste. Ke vjedhur ujin e liqenit dhe me të edhe peshqit e shtetit. Akuza iu bë në sheshin para kishës, para gjithë fshatit dhe në fund dy policë i hodhën hekurat.

Pra atij njeriu që edhe sot e kësaj dite mbeti afendiko nuk do t'i shtrinte dorën. Fshati le të përmbytej. Por për çudi ishte vllahu i cili ofroi ndihmë. Peshkatar i vjetër nuk ishte ndierë, veçse i kujtoi atij se ai dajlan e kishte një zot. Punimet filluan qysh të nesërmen dhe pa ndihmën e ndonjë rrethi tjetër. Për një javë rresht, dajlani u thellua nga të dy krahët deri sa gropat e hapura nga eskavatorët u mbytën nga uji që vërshoi drejt detit. Laguna si t'ishte një qenie e gjallë, diaste e çliruar nga një ankth dhe me mushkri tanimë të pasura me oksigjen.

Gjithçka mori formën e dikurshme. Punët në ullishte, kripore, peshkim etj., rigjetën veten dhe jeta në përgjithësi, ritmin e vet. Por sërish banorët e dy fshatrave ankoheshin sepse jetonin thujasë të braktisur nga qyteti, që s'ishte as dy kilometra larg. Ndireshin si në kohën e diktaturës ku njiheshin me nofkën fyese "bithëkripur" apo "buka rrumbulake", ngaqë u lejohej të hanin vetëm bukë misri dhe ata të gjoërë, detyroheshin të zinin pritë në furrat e bukës në qytet dhe t'u luteshin qytetarëve, të blinin për ta një "buka rrumbulake". As vetë nuk e kuptonin se nga e prisnin një lloj ndryshimi të gjendjes së tyre shpirtërore. Ndaj edhe çdo mëngjes i luteshin shën Marisë dhe në muzg kaltërsive të qiellit. Ndaj edhe fshatçe organizuan shërbimin ditën dhe natën, në gjithë perimetrin e lagunës, për të mos ndodhur më akte makabre, si ajo e vrasjes së pelikanëve. Ua kishin borxh atyre shpesëve paqësorë por edhe vetë liqenit si pjesë e jetës së tyre, që priste të ndodhte një mrekulli.

Magjia ndodhi muajin e fundit të verës. Flamingot e parë u ulën në lagunë pas një fluturimi të gjatë rreth liqenit. Nuk kaloi gjatë dhe dhjetra çifte pelikanësh kaçurelë, shoqëruar nga mijëra shpendë shtegëtarë u ulën pranë flamingove pararojë dhe nisën të çukisnin me sqepin e gjatë fundin e liqenit. Ishte një bekim Perëndie ardhja e flamingove, të cilët po hidhnin mbi një telajo natyrore, ngjyra maramendëse. Një harmoni kolorante e ngjyrës rozë, të bardhës, të verdhës e të kuqes. Prania e tyre nuk ishte një njollë e zakonshme rozë. Gjithçka ngjasonte me një pejzazh të vërtetë të Claude Monet- së

-Jo, Panajaja nuk na ka harruar, mërmëriti peshkatar i vjetër.

I gjithë rrugëtimi poetik i Niko Kacalidhës shtrihet në 534 faqesh, në librin “Heraldikët e borës”, botim i Onufrit. Nëse autorit iu deshën vite për ta përshkruar odisën e tij, ty veçse pak orë, por, duhet të të mos mungojnë vetitë e Magelanit. Ky çast, që mund të përkojë me “gjqin e fundit”, merr kuptimin e gjithë jetës së një autori. Ndaj në poezinë “Në paça vlerë”, ai shkruan, duke mos anuar nga dyshimi: “Më gjykoni për lisat e jetës/se si e kanë hedhur hijen mbi kurrizin e maleve,/se si e kanë pasur kurrizin në rrebesh dhe gjetthin në fllade e ledhatime./Në fund të fundit, më gjykoni/nëse jam ngjizur në eshtren e malit për t’u bërë lëndë fosforeshente,/apo isha pa hije e prisja vetëm festime./Atëherë, në drejt ditëlindjet e ceremonitë e mëdha,/atëherë, në drejt tërë qenia ime.” Siç e shihni ballafaqimi i autorit me lexuesin mbart një dramacitet të lartë. Friket mos ka qenë një hije, që priste festime, lavdërime, rrahje krahësh e bërje qejfi dhe, në fund: vazo me hi pa ambicje sfinks. Mund të ndodh që në të lexuar të librit: poetin ta shohësh, jo aty ku e kanë parë të tjerët, duke u bërë shkak ndoshta të një debati për autorësi se cili ka zbuluar të vërtetin, sikurse ndodh rëndom të grinden qytet dhe shtetet se cilit i përket poeti Homer, për shembull. Sepse po më ndodh edhe mua, të mos e shoh poetin Kacalidha, atje, ku e identifikojnë të tjerët. Nëse do i përmbahemi këshillës së autorit: “prerja e pikës së lotit” nuk është njësoj, si “prerja e pikës së vesës”, doemos që janë dy referenca të ndryshme, se cilën ti merr për bazë. Apo në një kontrast të dytë: “Po mua nuk do të më shqyejnë qentë. Po mua do të më hanë jaseminët.” Në të parën je thjeshtë një viktimë, në të dytën një hero lirikë. Tek viktima apo tek heroi lirik duhet ta shohim autorin, kur ai vetë e shpreh qartë pozicionin e tij?)

Poezi pas poezie ti ecën në ato rrugë, ku ka shkelur Niko, sikurse fluturon në ato hapsira ku shtegëton fantazia e Kacalidhës, (Ecën apo fluturon?!) duke pikasur, jo pa të drejtë se konkretja është më e dukshme në poezitë para viteve `90-të, që përkon me kohën e diktaturës dhe abstraktja me fluturime pindarike, pas saj. Pra, në fillim zgjat rrënjët e më pas shtu degët. Mos vallë mungesa e lirisë të bën toksor, të prekshëm, ndërsa pasja e saj: qiellor, fluid? Nëse në poezitë të shkruara në diktaturë gjen lule, zogj, det, male, cicërima, në këtë të demokracisë një hebarium me lule të thata, zogj të ballsamosur apo fosile të tyre, ku vargje të tëra i kushtohen pagëzimit të zogjëve. Për të qenë konkret po citoj: “U zgjuan fyejt dhe vajzat dolën në dritare.” Këtu zëri, melodia sjell figurën e vajzave, aty ku ato duken më shumë tek dritaret prej nga kanë origjinën dhe vitrinat. Ndërsa: “Peshqit në akuarium mendojnë se s’ka për ta tufan./Vetëm, sa herë, ndërrohet uji, me sy lëmoshë kërkojnë në xham.” Sikurse nuk pritet një furtunë në gotë, po aq dhe një tufan në akuarium. Por, si vajzat dhe peshku janë në një shtëpi prej xhami, ku gjithçka shihet.

Si të gjithë poetët e talentuar, edhe Niko Kacalidha, i shfaq konturet e poetit qysh në fillimet e veta, duke shpallur kredon e tij. “Unë jam paqësor si deti dhe i egër si deti./Edhe i madhërisëm sikur të isha si deti./unë, përsëri emrin tim do të mbaja.”-shkruan ai në poezinë “Credo” e botuar në “Zërin e Rinisë” të vitit 1972. Nuk është e vështirë të kuptohet nënteksti, nëse i referohemi kohës ku individi shtypej nga grandomania e “veprave madhështore”, “heronjtë legjendarë”, “temat e mëdha”, “interesi i përgjithshëm” dhe ti: duhej ta harroje emrin tënd, duke u uniformizuar, ndërkohë që “kulti i njëshit” fetishizohej. “Këndo me zërin tënd, qoftë dhe me zë bretkosë”-do thoshte Esenini, por në plan të parë dilte tharja e kënetave. (“Të

NIKO KACALIDHA: AS KAÇAKI VJESHTËS DHE AS HARRAQ I UDHËVE

Nga Fatbardh Amursi Rustemi

kam thënë se në vizionet e mia, vatrën gjithmonë e kam me vetë.”, një varg ky, që e përforcon edhe më shumë identitetin e autorit. Vatra, me këtë emër njihet dhe shoqata e shqiptarëve këtu në Amerikë, është pjesë e atdheut mëmë dhe për Niko Kacalidhën, kjo është Greqia.)

Autorit i pëlqen të vendos raporte të drejta më kohën, natyrën, njerëzit dhe atdheun, duke mos lënë hije dhe keqkuptime në sjelljet e tij, kur dihet që raportet më të ndërlikuara janë ato me veten. “S’jam kaçak i vjeshtës./S’jam harraq i udhëve./Thirra bashkëkombësin Seferis dhe më tha/se malet këtu me lëkurën tërë rrudha përngjajnë me barqe elefantësh.” Pranon një udhërrëfyes: bashkëkombësin Seferis, vatra nga marrin udhë vizionet e tij. Por, thërret dhe një të dytë: “Plepat ndanë

udhës, ngjanin me penelat e Mios./Po ku ishe ti të më shkundje tërë qiellin me mollë? Ik, më ngjau se foli Vangjush Mio duke larë penelat! Ik, bre djalë i mbarë, më foli Mio, se ka rënë dëborë!” Poeti grek e thërret t’i bashkohet udhëve të vjeshtës, piktori shqiptar e nxit t’i largohet dimrit. I gjendur mes hordhive të reve, rrufeve e gjëmimeve të Zeusit, mes maleve të thepisur, të vetmit që i kërkon ndihmë është autori i romanit “Shpella e piratëve”: “Shpëtova, thashë, kam për të kaluar se kam mik Petro Markon dhe kam për ta thirrur shpellave.” Të tri referencat e përmendura janë 3D-ja e poetit Niko Kacalidha, duke qenë një shembull i të qenit urë lidhëse midis dy grekëve dhe shqiptarëve. I gjithëpranuar.

Familja dhe vendlindja zënë gjithë hapsirën e poezive të tij, ndërsa atdheu



shfaqet i ngjizur brenda tyre. “Sikur më thonë malet e vendlindjes: “U bërë burrë, djalë, u rrite shumë./A të kujtohet bryma mes lirishtes?/Po lundrat e fëmijëve mbi lumë?” I dehur nga harlisjet pranverore: “I pari çeli jargavani në kopshte/dhe donte të thoshte se do të kishim pranverë të bukur./U dendësuan rruginat,/u dendësuan pragjet e shtëpive,/u dendësuan dritaret me lulen e parë/sikur thoshte do të vinte dendësia e ngjyrave”, ndaj: “U vonova ca, i thashë rrobaqepësit, këmishë të bukur sivjet të më qepësh.” Atmosfera djaloshare shoqëron poezitë e hershme të tij, ku më pas do t’i ngadalsohet hapi, sikurse mendimet do të kenë tjetër peshë. “Mbrëmë ishin mbledhur të gjithë në dhomë./Dhe unë isha kthyer në shtëpi./Në mbrëmjen e verës pranë dritares rrija./Si një astronom vështroja yjet./S’isha astronom këtë mbrëmje./Ndoshta qeshë poet, dashnor a diçka tjetër?/U rrite, tha nëna mbrëmë në shtëpi, gjeje vetë nusen tënde dhe leri yjet!/Si e zbuloi nëna ime të fshehtë e mbrëmjes mes mirazhit që dridhej nga hëna?” Dhe për ta shijuar ende këtë atmosferë, po citoj vargjet: “Sonte s’dua të fle,/jo nga marazi i dashurisë si Milosao/ që mbeti në netët e gjata magjike me ëndrra dashurie në peisazhin baritor./Sonte vërtiten pëllumba të bardhë drite.” I referohet Milosaos, por a mund të hiqet një paralele nga pozita e minoritarit? Gjithsesi nuk ka trishtimin e Milosaos.

Por, nuk do mungojnë kumte, ardhur si prej orakujsh: “Katër qiparisa zgjateshin në muzg./Fryu veriu i natës, njëri u këput./Në mëngjes u zgjuam, dheu qe acar./Qiparisi i anës, mespërme qe çarë./Tre të tjerë rrinin mbështjellë në dëborë./Si bardë vështronin brymën dimërore./Në mëngjes rrugicat bora kishte zënë./Me një vig e ngritëm bardin tonë të rënë./Ahe, pisha, bredha, zgjateshin në muzg./Bardët mes dëbore mbartnin lart një bust.” “Zëri i Rinisë”, maj 1970. Edhe pse sheh rënie, rrëzim, kthimi i katër qiparisëve në një bust, i jep kuptim sakrificës sublime. Qukapiku i merr radhë drurët, duke trokitur me sqep, duke çukitur sikur pyet: “Ku je?/pingëron dhe troket duke të kërkuar?” Është pikërisht i munguari, i kthyer në bust. (Leshnicë, maj 1988) “Thashë të përgjoja në drurët e vjeshtës/rrëqethjen e gjetit mes erës,/po drurët m’u vodhën,/s’ma treguan shpirtin./Thashë të çaja gjoksin e erës netësh dimërore që dilnin prej territ,/po s’më lanë vetëtimat të vazhdoja linçimin e erës.” Duke e kërkuar veten brenda natyrës, shpirtin të transferuar jo vetëm tek frymorët, ai shprehet: “Metempsikozën duhet ta kenë shpikur poetët.” Një lloj panteizmi ky, ku në vend të perëndisë, është poeti i shkrirë me natyrën. “Pyetëm rrapin dhe na bëri

(Vijon në faqen 15)

NIKO KACALIDHA



heraldikët e borës

OnufriPoezi

Çështë e trishtë tetorit zë vjollcë

Ç 'është e trishtë tetorit zë vjollcë
Muzgu
Varrimet e pagjasa të sendeve
Zymtësia
Në dhomën rozë e të bardhë prehet një virgjëreshë
E bardhë dhe rozë
Mullinjtë e fshatrave heshtin. Barinjtë kthehen
Mos harro
Nga hapat e maleve midis rrjedhës së burimeve
Të gurrave të tyre
Ditën tjetër me ta. Krye engjëjt bukolikë
O relikë
E ëmbël e një fëmijërie të pagjasë! Dikush midis tyre hesht
Është Fritzi. Ndoshta ai
Dashi që prin kopenë, mbreti i vagabondëve
U prin dallgëve
Hejza. Që e bënë fatkeq! Njëherazi mburoja
Gurrë stralli
Kundër të cilit Koha e pat përdorur limën
Sublimen
Plaku loton vdekjen e vet si një lule dimri
Një kortezh
U formua. Dy krahë vitalë në famulli shpënë
Një lopatë
Në tokën e porsa hapur arratia nga jeta
Që nuhat
Të gjitha hapat e dhimbshme. Kallauz në tokën
E vetmuar
Ndër ëndrra dëgjoj vajtimin mbi kambanat
E të afërme
Në mbrëmje. Mbart për të një kujtim vëllazëror
Luftë e shtrenjtë
Me kohën tjetër. Tek unë, plaga nuk gjakon
Koriçkë ka zënë tashmë
Nga zjarri që përqafton sobën e kuqe
Shkarpat ndër krahë
Kam kaq ethe sa dua krejt botën ta pi
Dhe dallgët e saj
Dhimbje ngulur thellë si një lis mbi truall
I pafjalë
Ç 'është e trishtë tetorit zë vjollcë
Mugëtira

Anija e artë

Një Anije e madhe e mbathur në ar
Kaltërsi preknin velat mbi dete të panjohur
Luspë dashurie, flokë shpupuritur, gjoks zhveshur,
Lundron në kryeradhën e një dielli që djeg

Mbërriti një natë që u ndesh me thellëtitirën
Në oqeanin gënjeshtar ku sirena këndon
Mbytja e tmerrshme ja përkuli kryet
Në humnerat e Vidhimës, të rrethit vicioz

Ishte një anije e artë, ku diafragma e brinjëve
Dëftonte thesaret e marinarëve të pafe
Pështirosje, urrejtje dhe nerva filluan grindjen

Çka ngelur nga Anija asaj stuhie të beftë?
Çka u bë zemra ime, lundër e braktisur?
Nën hijen e rrrokullimës së ëndrrës gjeti strehë!

Natë dimri

Porsi dëborë bora ra! Ah!
Bahçe kristalesh akulli dritarja ime
Ah! porsi dëbora borë ra!
Çfarë tkurrje e tendosur të jetosh
Me dhimbjen që kam, kam dhimbje

Gjithë pellgjet nga cipa e akullit mashtrojnë
Zhgunin e shpirtit tim; ku jetoj? ku vete?
Këto shpresa të ngrira të gjitha mashtrojnë
Norvegjia e re jam
Për ku qiejt biondë janë mërguar

Ngashërohu, o zogu i shkurtit,
Në pafajësi thellimesh të gjërave
Zog i shkurtit, ngashërohu,
Vajto dënesën, trëndafilat e mi
Nën dregëzat e dëllinjës

Porsi dëborë bora ra! Ah!
Bahçe kristalesh xhami i veshur
Ah! porsi dëbora borë ra!
Çfarë spazme të jetosh
Me çmërsin që kam, e gjithçka...

ÉMILE NELLIGAN NJË NGA LIRIKËT MË TË MËDHENJ TË POEZISË FRANKOFONE NË KANADA

Përktheu dhe përgatiti Flurans Ilia

Emile Nelligan lindi më 24 dhjetor 1979 në Montreal. Në moshën 16 vjeç publikon poezinë e parë. I portretizuar si “fëmijë i mbyllur dhe i eklipsuar tërësisht nga poezia” është një nxënës me nota të dobëta në shkollë. Ndikimet e para janë klasikët Millevoye, Lamartine, Musset, gjersa zbulon poezinë e Verlaine, Baudelaire, Rodenbach. Pasi është përjashtuar nga një sërë seminaresh me disiplinë fetare, më në fund pranohet në Shkollën Letrare të Montrealit fal talentit të tij. Përgjatë adoleshencës së hershme është i portretizuar nga institucionet shkollore si “një tip i krisur”. Nga njëra anë fjalët e sarta të babait “*Ti nuk vlen për asgjë!*” duke ia hedhur në zjarr dhe djegur poezitë, edhe nga ana tjetër, zëri i nënës, duke e shndërruar frëngjishten gjuhën në të cilën përzgjedhi të shkruante në një imazh poetik. Përkundër mentalitetit të epokës “*ky i ri i krisur përflitet se ka marrëdhënie me një zezake*”. Asgjë nuk është e dokumentuar përveç karakterit idilin me të cilin gruaja ka hyrë në universin e tij poetik. Gjersa me kërkesën e babait më 9 gusht 1999, në moshën 20 vjeç, poetin e mbyllin në azil psikiatrik me diagnozën “*I degjeneruar mendërisht. Çmenduri polimorfe. Skizofreni e pashërueshme*”. Nelligan kaloi 42 vite nëpër azile psikiatrike gjersa vdiq më 18 nëntor 1941. Njësoj si në vargun i tij “*Ku farëzohen dyshimet e porsaçelura të pemëve*” rreth viteve 1960, interesi ndaj tij tërheq vëmendjen e krijuesve të rinj franko kanadez të cilët shohin te Nelligan “*poetin që kreu kapërcimin e poezisë franko kanadeze nga forma klasike te ajo moderne*”. Në vitin 1991, me rastin e 50 vjetorit të vdekjes, përmblihet dhe botohet për herë të parë vepra e tij e plotë. Emile Nelligan, sikur Arthure Rimbaud, krijoi përgjatë viteve të rinisë së hershme, pjesa tjetër e jetës ngelet një luftë e vazhdueshme me demonët e tij. Konsiderohet si një nga lirikët më të mëdhenj të poezisë frankofone në Kanada.



Varri i zezakes

Asohere vidhisur prej nesh i dimrave thëllim
Në të fundmit qiej të zbehtë të marsit, e shpumë
Nëpër shkorretet funebre me aromë kannelle
Ku farëzohen dyshimet e porsaçelura të pemëve

Të lartave degë shpuar me zogj të ndryshëm
Frymëmarrje të trishta gufojnë shpirtat e tyre
Në limonin e njomë dhe të athët e rikthyem
Që Afrika të flejë në paqe n' gjelbërimin e muajve

Trualli me besim do t'ia mbulojë shpatullat
Ku kumria e bukur në kështjellën e drunjte
Do vajtojë shpesh temën e njëzet viteve të saj

Ndoshta, do të rikthehet në një të largët pranverë
T'ia zbulojmë zemrën ndër kaçube të fshehta
Tek çelet si një zambak midis trëndafilave të bardhë

Romanca e verës

Krenari e gjelbër e qeshura jetësore përziehet
O netë të bukura të majit! Në kor zogjtë
Në zemër shpresat ripërtërihen
Formojnë preludin e tyre në guvën time

O netë të bukura të majit! Mbrëmje të lumtura
Një organo shkrepnin tej një të trishtë melodi
Dhe rezet e diellit, sikur shpata ngjyrëvjollcë
Çapojnë zemrën e ditës që vdes e parfumuar

Jam krenar ! krenar jam ! Brenda kristalit që këndon
Shtir, më shtjer verë ! mbushe akoma edhe çdoherë
Të mund të harroj trishtimin e ditëve
Nga krenaria e shpifur tallava e turmave!

Jam krenar ! krenar jam ! Rroftë vera dhe Arti
Ëndrra kam të shkruaj vargje prej vërteti
Vargje të mbushura me muzikë funebër
Erërash vjeshtuke nëpër mjegull duke baritur

Mbretëria e të qeshurës së hidhur dhe tërbimit
Të njohësh poetin dhe gjësendin e matur
Të njohësh zemrën dhe të mos jesh i kuptuar
Veç nga qartësia e hënës e muzgu portokalli

Gra! këtë doli për ju kur qeshni te sokaku ku epshi
Më thërret duke hapur krahët si petale trëndafil
Këtë dollinë tjetër për ju, burra me balle të zymtë
Që dorën ma keni shtrirë e dinjitet më keni dhënë

Ndërkohë që e gjithë e kaltra vjëzohet madhërisht
Dhe një himn merr zë në ndriçim të ri
Mbi kapitullimin e ditës për të cilën nuk qahem
Unë që eci në terr mbi rininë time ngjyrë gri

Jam krenar! Krenar jam! Rroftë mbrëmja e majit
Çmendurisht kryelartë, i dehur pa qenë aspak
Është gjithë çka jam lumturisht jetuar përfund
A është shëruar duke dashuruar zemra ime?

Këndojnë kambanat flladin mbathur me ar
Ndërkohë vera buron me rrekëza lumturish
Jam krenar, në të qeshurën me zë të plotë
Kaq krenar sa kam frikë të shpërthej në lotë

(Vijon nga faqja 13)

me shenjë andej lart,/nga sheshet e erërave, s’kishte më tutje./Atëherë hipëm lartësive,/burimeve të shpirtit,/që gurgulluan brenda nesh/që të mos thahej shpirti i dheut në netët hënore.” (“Duke kërkuar burimet”) Nëse do ndodhte të shndërroheshin njerëzit në zogj, ai beson se do të ishte një zog paqeje, përkundrejt një zogu grabitqar, sikurse Paridi, ku autori vë dyshimin se nuk ka mundur ta puthë Helenën: “Po ku të gjente një minutë Paridi për ta puthur?/Gjithë gjullurdia e Trojës, pa një puthje!/Gjithë ai gjak i derdhur kot, pa asnjë puthje!/Se po ta kishte puthur do të zbuteshin dhe detet./Me siguri Helenën s’e ka puthur.” (“Me siguri Paridi s’ e ka puthur”) “Unë i di të gjitha shtëpitë e zogjve/dhe kam marrë pjesë i ftuar në të gjitha banketet.” I njeh marrëzitë e murlaneve, sikurse dhe brenda vetes e di që dikush rri në këmbë, sigurisht për të udhëtuar. Gjithsesi i duhet të shlyejë një mëkatë: “Me llastik vrisja zogj dhe krisnin qelqet e qiejve./Krisnin yjet dhe nxiheshin brinjët e lakuriqësisë së tyre./Ra ujërave me flatra të ndezura Dedali i zogjve./Unë, mëkatari, paskam qëlluar fluturimin.” (Krahët artificial ngjitur me dyll përherë bjenë.)

Një reflektim interesant ky, ngaqë kujtimi i hershëm i fëmijërisë bie ndesh me kredon e poetit: pegasin, kalin fluturues. Edhe pse: ka kalë të Akilit, Hektorit, Odisesë, por i tij “hyjo” është tjetër gjë. “Po është një kalë i bekuar/që për mua bëhej erë/e sillte në pragun e shtëpisë/qelibarin e drithit./Se ne s’kishim bukë, dëgjon, se ne s’kishim bukë atë dimër”, duke krijuar kështu një kontrast midis banketit të natyrës dhe sofrës së uritur. Sikurse e thamë, me poezinë “Credo” nis përmbledhja poetike e librit, ku autori e krahason veten me detin, sa “paqësor” dhe “i egër”. Nuk duhet harruar, që poezia është shkruar në diktaturë nga një minoritar, ku sigurisht shtrohet pyetja: paqsor me kë dhe i egër me cilin? Heroi lirik nuk shfaq ndonjë veçanti emocionale, sikurse po duan t`ia vënë në dukje, si përfaqësues i një ndër minoriteteve më të shtypura të botë. Egërsimi i kohës nuk ndihet në vargjet e tij. (Ai shfaqet paqsor kur shkruan për Lefter Talon, dëshmor i lirisë: “Unë lashë pas anëdetin dhe ngjitem përpjetë, varrezave të dëshmorëve. Po kush i tha majit që çeli gëmushat dhe u përgjakën mersinat në varre?”, sikurse i egër në poezinë: “Pashë një djalosh të vrarë që e zvarrisnin anëdetit në mes të ditës rrugëve të qytetit për të matur durimin dhe më krisi zemra.” Ai nuk thotë se ky djalë ishte minoritar. Sikurse do shkruaj një poezi për nënat që u endën dyerëve të burgjeve për të takuar bijtë, pa i cilësuar si minoritare. Këto janë tre poezi ku trajtohet tema aktuale, nëse do flasim me gjuhën e kritikës së kohës, ku ai u rri larg politizimeve.) Deklarimi i tij në poezinë “Identiteti i anëdetit”: “Jam bir i malit, jam bir i detit. Herë më nis njëri, herë pret tjetri.”, nuk është zë i një të shtypuri, por i atij që i krenohet vetes, në një kohë kur preferohej të deklarohesh si “bir i partisë”. Në kohën e kolektivizimit, të rrafshimit të vlerave, dinjiteti mbeti veti e individit, natyrisht me kosto të lartë. Pikërisht këtë dinjitet manifeston dhe hero i tij lirik, duke e vënë veten në raport me detin dhe malet, me të cilët mburret, duke i përdorur ato dhe, si një njësi matëse të vetes. Në këtë kuptim ndez strallin nga del drita, duke ia njohur vetes prometianizmin: “Unë them të bëhet dritë dhe bëhet dritë. Kjo është formula ime edhe nuk e di se nga ma paskan vjedhur perënditë.”

Nëse u nisëm nga poezia “Credo”, ku poeti kërkonte përmasat e veta, pa u fshehur pas madhështive fiktive, qofshin ato dhe të epokave, ia vlen, së fundi, të ndalemi tek dy poezitë: “Mirazhi i librave të mia” dhe “Lule mali e vetmuar”, ku kredoja e tij e hershme ridimensionohet. Duke parë librat e tij në një raft biblioteke pranë Homerit, ai shkruan: “Si u ndodhën në bibliotekë pranë Odisesë?/Kush i ka vendosur rastësisht afër Iliadës?/Ku ka vajtur fisheku i fundit i modestisë?/Hiqini andej se po shpërtheu lufta e Trojës,/as me një gotë ujë nuk do të jem i vlefshëm./Hiqini ato andej që të shpëtoj drurët i mi.” Frikës ndaj një hakmarrje shkaktuar prej zilisë, zgjedh një pozicion tjetër për të kalkuluar sfidën e tij. Në poezinë “Lule mali e vetmuar” shkruan: “Nuk shtirej kurrë, nuk donte të dukej./Asnjëherë s’shiti mend për brishtësinë e kërcellit dhe për elegancën e petaleve./Indiferente, larg syve të botës zhvishej, lahej në gjirin e flladeve buzëmbremjes./... Larg bulevardeve nëpër lartësitë malore dhe nuk e gjenin/as për buqetat e nuseve e nuk preferohej/as për buqetat mortore./Larg bulevardeve/as emrin nuk ia dinin./... Më shihni mua, sikur thoshte, më dëgjoni mua, paçka se nuk marr pjesë në buqeta, ju siguroj se më e bukur do të bëhet jeta.” Duke parë mirazhet e përmbysura mbi liqen i thotë vetes: “As në iluzionet optike mos u ktheshë/kokëposhtë.” Shpresoj që me “brishtësinë e kërcellit” dhe me “elegancën e petaleve” të kenë portretizuar Niko Kacalidhën, zhveshur prej iluzioneve metaforike.

PSE VONON AJO GRUA?

Tregim nga Qazim Shehu



Kishim hipur në një furgon në Prizren dhe shoferi u bë gati të nisej, kur pranë derës së tij gjysmë të kmbyllur u shfaq një vajzë e vogël, e cila duhej të ishte nja dymbëdhjetë vjeç ose pak muaj më shumë. Ishte një vajzë rrezëllitëse, flokëkaçurrele, me sy që i shkëndijonin. Unë isha ulur në sediljen pas shoferit dhe e vura re këtë, por para se të shkoja edhe një herë nëpër mend bukurinë e kësaj fëmije, dëgjova fjalët e saj:

- Xhaxhi Maksi, mami më tha ta presësh dhe dhjetë minuta, se do të vijë me ty në Kukës.
- Mirë, - tha shoferi, - të cilit ia mësova emrin nga fjalët e vajzës, - po e pres, por thuaj të mos vonohet, se mërziten pasagjerët.

Vajza iku. Hodha një vështrim në hapësirën e brendshme të furgonit dhe vura re se dy vajza ishin zhytur në ekranin e celularit, një djalë lexonte gazetën, ndërsa dy pleq rrinin si të ngrirë. Furgoni duhej të kishte edhe trekatër vende bosh, por ne duhej të niseshim. Për të shfrytëzuar këtë kohë, dola jashtë dhe ndeza një cigare, ndërsa pasagjerët e tjerë nuk lëvizën. Gjatë kësaj kohe ata rrinin të heshtur. Pasi e mbarova cigaren, pashë orën dhe nuk kishin kaluar dhjetë minuta, por dymbëdhjetë. Me siguri ajo grua duhej të vinte tani, jo, kjo nuk shkonte ose shoferi duhej të nisej. Nuk kishte kuptim ta priste më, por shoferi po rrinte i heshtur në timon dhe trokiste gishtërinjtë në rrethin e tij. Me sa dukej edhe tek ai kishte filluar mërzia, duhej të kishin kaluar edhe dy- tre muinuta kur sërish erdhi vajza.

- Xhaxhi Maksi, - tha ajo, - mami më tha se vonohet edhe dhjetë minuta të tjera, a mund ta presësh?

Maksi, pasi u mendua, tha:

- Thuaj mamit se edhe dhjetë minuta do ta pres, më tepër jo!

Kisha edhe dhjetë minuta të tjera për të dalë jashtë e për të pirë një cigare, por para meje dolën dy vajzat;ato nuk thanë gjë, vetëm, pasi panë një herë nga shoferi, ikën. As shoferi nuk u tha të prisnin. S’kishte sesi.

Dy pleqtë ende nuk po lëviznin nga vendi. Gjatë këtyre dhjetë minutave, vajta pranë një kioske dhe bleva një shishe ujë. Ishte një vapë mbytëse. E piva ujin me etje dhe po vështroja qytetin, sikur ta shihja për herë të parë. Edhe pse vapa ngrinte avuj të lehtë mbi rrugë, makinat nuk pushonin së vërshtëllyeri gomat, njerëzit lëviznin të përthithur në lëvizjet e tyre. Kur u ktheva, dy pleqtë nuk ishin më aty. As djali. Furgoni i vogël ishte bosh.

- Paskan ikur, - thashë.
- S’kanë faj, fajin e kam unë, por e njoh atë grua dhe s’mund të iki... - tha shoferi dhe hapi kapakun e motorit, i hodhi ujë dhe e mbylli me një përplasje të lehtë. Çuditërisht nuk dukej i mërzitur .

- Edhe ti mund të ikësh!, - më tha.
- Jo, - ia ktheva, - do të pres.

Ai nuk foli, por e kuptova që dëshironte që unë të ikja, siç ikën të tjerët.

- Eja të pimë diçka këtu afër, - tha ai, - ndonjë kola...

Nuk refuzova dhe të dy shkuam aty pranë dhe ai nuk pranoi ta qerasja. Shoferi ishte një mesoburrë trupdrejtë, me tipare të rregullta. Në rininë e tij duhej të kishte qenë më simpatik, dhe hijeshia e tipareve, që kishin filluar një farë venitje për shkak të moshës, e tregonte këtë.

- E ka shtëpinë larg ajo grua?- pyeta.
- Jo, këtu afër...
- Përderisa e njeh, përse nuk shkon ta marrësh. . - Unë pres këtu.
- Jo, - tha ai. - Nuk shkon.

Ndërsa po bisedonim për gjëra të tjera pa lidhje, erdhi sërish vajza. Ai e vuri re.

- Çohemi, - tha, - vajza erdhi... Të shohim ç’lajm sjell.

Vajza po rrinte te dera e furgonit. Dukej se ishte e lodhur...

- Hë moj vogëlushe, - tha Maksi dhe nxori nga xhepi një çokollatë.

Ajo nuk lëvizi. Rrinte si e mpirë. As çokollatën nuk e mori.

- Merre, merre!- i foli ai, - nuk të pëlqen, ta jep xhaxhi me dëshirë...
- Mami nuk vjen edhe për pesë minuta, - tha ajo, - i doli një punë e papritur dhe të kërkon falje.
- Mirë, - murmuriti ai- U kthye nga unë dhe foli si nëpër dhëmbë:Presim!. . .

E pashë shoferin me vëmendje dhe në atë çast më erdhi teë qesh, por, në çast një vetëfrenim që më erdh prej një inati, si ndaj shoferit, dhe ndaj vetes që kisha ngurruar të ikja me kohë, ma ndaloi të qeshurën. Ende nuk po e kuptoja durimin e atij dhe sesi ua kishte dhënë pasagjerët shoferëve të tjerë duke e zbrazur furgonin prej kësaj pritjeje këmbëngulëse që përmbante një mister. Ai prapë dukej i qetë, ëndërrimtar dhe as nuk e vriste mendjen për këtë. Dhe unë duhej të ikja. Dhe i thashë me një zë që më dridhej pakëz, por ai nuk kishte pse ta kuptonte këtë dridhje. S’më kishte mbajtur me zor aty.

- S’kam ç’të pres më, - i thashë, - edhe unë po iki si të tjerët...

Ai nuk foli, por kjo qe miratim, mbase çlirim për të...Dhe shpejt e harrova shoferin ndërsa u përsëdyta të rrekem e të gjej me hamendje se pse vononte ajo grua. Dhe pse pikërisht kërkonte ta priste i njëjti shofer... kur makinat shkonin me shumicë drejt Kukësit. Mos vajza e vogël e pengonte? Kush e di?! . .

Lëkura, rripet vetëm nga njerëzit. Është një nga pak siguritë që ti ke para se të nisësh leximin, i cili, ja ku po ta them unë, mund të shpallë, si shumë herë të tjera, vetë dështimin e ngjarjes si e tillë, por jo patjetër të këtij shkrimi, që, për fat, nuk ka as pretendime të jetë një ngjarje. Së paku nuk është një ngjarje e qëndrueshme. Po, kjo është një e shkruar e ndërtuar, e bërë edhe nga ty, përveç meje, e mëton t'i rrijë vetëm fillimit e fundit.

Po ta tërheq vëmendjen që në fillim, vetëm ngaqë e kam lexuar njëherë këtë tekst, pasi e kam shkruar: nuk flitet për njeriun, i cili, pasi ka vrrarë e rrjepur një kafshë, nuk ndalet me të mbushur barkun me mishin e saj, e pastaj i vesh edhe lëkurën për t'u mbrojtur nga i ftohti. Jo. Se kjo, bashkë me prerjen e druve dhe shfrytëzimin e tokës, është një histori e njohur njerëzore që vazhdon të këndohet me tone heroike nga rapsodë modernë, sipas teksteve që shumohen në forma krejt të ngjashme.

Këtu është ndryshe, mund të zgjedhësh, e unë të këshilloj të përqendroresh vetëm në historinë e bariut shëtitës, që i vesh delet e mbijetuara me lëkurët e deleve të tjera të çara nga ujku, e muaj më vonë, në pranverë, i mbulon qengjat e mbetur gjallë pas një lindjeje, me lëkurët e qengjave që kanë ngordhur. E kjo është pjesa femërore e këtij shkrimi.

Pjesa mashkullore, ajo e pushkatimit të qenve që e hanë bukën kot, mund të lexohet më vonë.

Nga fundi i nëntorit, nëntë barinj, për një javë me radhë, kaluan me trap mijëra dele, bashkë me shtatëdhjetë qen e i çuan në një ishull në mes të një liqeni të madh, pasi ai ruante një klimë të butë edhe gjatë dimrit, edhe se, për dreq, atë vit bora erdhi shumë shpejt.

Stani i stërmadh ishte ndërtuar në një rrafshnaltë mbi malin e vetëm të ishullit. Ishin një numër i kufizuar deshësh që, vërtet përplasnin brirët me njëri-tjetrin, shpesh, por këtë nuk e bënin për të fituar delet, ato ishin të shumta. Yshteshin vetëm nga një shtysë e brendshme zotërimi. Gjatë gjithë ditës dëgjoheshin blegërimat e deleve dhe të qengjave e sundonte një qetësi femërore.

Jo shumë larg, llogarit largësinë sa të mos ndiheshin erërat e të pëgërave, barinjte, të gjithë meshkuj, kishin ngritur kasollen e tyre. Nuk ke çfarë të lexosh për ta. Kalo sidomos paragrafët ku flitet për 'ndërveprimin' midis tyre.

Ktheu tek masakra e deleve. Apo...? Jo, vazhdo e lexo më mirë për jetën e tyre në paqe.

Bariu më i ri, ishte tridhjetë vjeç dhe quhej Zeno. Iu bashkua grupit për herë të parë gjatë kalimit nga toka në ishull. I habiti të gjithë, i donte delet më shumë se të tjerët. Jepte gjithmonë më të mirën nga vetja kur ishte me to. Kjo e dyta ndodhte edhe me barinjte e tjerë, por për të tjera motive. Për ta mbarështimi i bagëtive ishte thjesht punë, edhe pse ndërveprimi me ato qenie të paqta i përmirësonte, sigurisht. Larg kafshëve, ata, si gjithë njerëzit, vetëm hanin, pinin dhe bënin sherr.

Zeno tha se ishte bari shëtitës. Me vete kishte edhe qenin e tij Buzo. U desh të ndaheshin që ditën e parë, qeni shkoi me qentë në kolibe e Zeno me njerëzit në kasolle. Kur takoheshin pastaj gjatë ditës, i vinte re njolla gjaku në qafë, në turinj, nëpër veshë, shenja të luftës me qentë e tjerë. E kjo ndodhi për javë me radhë. Nganjëherë kishte edhe ndonjë plagë më të madhe ku lëkura i qe zhveshur, gjithmonë si pasojë e përleshjeve, pasi e kemi thënë që në fillim: lëkurën dinë ta rrjepin vetëm njerëzit. Kaloi kohë e shenjat u zhdukën, qentë e pranuan Buzon në radhët e tyre.

Nëse do ta lësh leximin për Zenon dhe Buzon, kalo tek Izeti. Po në jetën e tij nuk



LËKURA

tregim nga Durim Taçi

do gjesh asgjë të rëndësishme, përveç faktit që ai, ndryshe nga sjellja e qenve me të ngjashmin e tyre Buzo, nuk e pranoi asnjëherë Zenon si bari i barabartë me të tjerët. Dhe jo për atë që bënte. Ngulmonte të dinte kush ishte ai në të vërtetë. Zeno nuk dukej njeri i fjalëve, ose nuk donte të zbulonte asgjë nga jeta e tij e shkruar, mbase. Parapëlqente të punonte kokulur. Po kjo Izetit nuk i mjaftonte.

Një nga cilësitë që kishte...

Shiko, nuk është e thënë se duhet të më ndjekësh mua patjetër. Çdo lexues ka mënyrën e vet të lexuarit. Mund të kthehesh pas të lexosh nga fillimi, po... të lexosh fillimin, si fillim të fundit, ose të lexosh fundin si fund të fundit.

Buzo, qeni besnik i Zenos, në fund u vesh me lëkurën e ujkut. Të atij që munda ai vetë. Kjo do të ishte fraza e fundit e këtij shkrimi, nëse ky tekst do të ishte vetëm një tjetër histori e shkruar, por nuk është kështu. Siç e shikon, ky shkrim ndryshon edhe leximin e tij të mundshëm, leximin tim, leximin tënd dhe atë të kujtudoje tjetër.

Ujqërit në kope i sulmuan delet nga të gjitha anët...

Jo, lëre këtë fakt për tani, të del më mirë të lexosh për delet në kohë paqeje, kur vjen pranvera, edhe pse rëndom ecet përpara, do duhej të kalohej nga dimri i masakrës në pranverën e lindjes së qengjave. Po kronologjia ne nuk na duhet.

Ai kishte një cilësi të rrallë në krahasim me barinjte e tjerë. Shkonte përtej asaj vetie që kanë racat e ndryshme njerëzore për të dalluar individët brenda bashkësive të tyre. Të bardhët njohin një fytyrë të bardhë midis miliona të tjerash, siç e bëjnë këtë njerëzit me ngjyrë midis tyre, apo aziatikët me të vetët.

Po deri këtu kjo bën pjesë në atë që e quajtmë historia në mes, ajo që flet për atë që bëjnë njerëzit me njëri-tjetrin. Nëse mbetemi këtu, nuk do nxjerrim gjë në dritë. Lëre fare këtë pjesë.

Kthehemi te Zeno. Ai, si të gjithë njerëzorët e tjerë, nuk është në gjendje të dallojë mirë nga njëri-tjetri individë brenda bashkësive që nuk i përkasin, njerëz me ngjyrë, aziatikë, hispanikë, eskimezë. Jo. Por, nga ana tjetër, është mbase njeriu i parë që unë njoh, si lexues, i cili arrin të dallojë midis mijëra deleve të tij, njëren,

pikërisht atë që do ta veçojë. Përqendrohet në tiparet e tyre, u shikon sytë, u veçon timbrin e blegërimit, njeh gjuhën e tyre të trupit, tonin vajtues e mbase edhe të qeshurës. Zeno i shikon delet e tij si individë, gjë që bëhet shumë e nevojshme, sidomos në pranverë kur fillojnë lindjet...

Mbase po mërzhitesh me paqen. Po, ne njerëzve paqja na mërzhit.

Po të kujtoj prapë fillimin, pra, masakrën. Lexojmë për masakrën e pastaj kalojmë fill në fundin e fundit e përqendrohemi te delet e mbijetuara, për të cilat Zeno duhet të kujdesej, duke harruar për një çast vuajtjen për humbjen e të tjerave, të atyre që i kishte çarë ujkun. Nuk po e largonte vështrimin nga barku i hapur i një deleje, nga frika se po ta shikonte në fytyrë do e njihte. U afruan qengjat na nuhasin. Vështrimi i ndaloi te fytyra e saj më në fund, i pa sytë e xhamtë mbetur hapur në një shprehje të ngurtësuar terrori, të cilën vetëm ai dinte ta lexonte. Qengjat zunë të blegërinin vajshëm. Gati blegëriu edhe ai, por u ndal në çast. Filloi menjëherë ta rripte. Ishte më i zoti ndër të gjithë për të rrjepur. Barinjte e tjerë kishin hapur shishet e rakisë, të cilat i mbanin në dorë. Pse të gjitha, thua, kishin zët të pinin nga shishja e njëri-tjetrit? Jo, donin të deheshin, e nuk prisnin dot radhë për të pirë. Kishin ndezur zjarr dhe erdhën e ia rrëmbyen delen e rrjepur nga duart. E vunë në hell. Zeno mbeti me lëkurën e saj në dorë. Asnjë njollë gjaku, krejt e bardhë. Ujku e çan delen në bark e i ha drejt e mëlçinë.

"Hidhe, mor, lëkurën tutje dhe eja të pimë" i thirri një zë. Nuk ishte Izeti. Nuk priste të ishte ai. Tre qengjat e deles nuk i largoheshin lëkurës, i merrnin erë. Zeno e dinte mirë çfarë duhet të bënte.

Ditën e masakrës stani me mijëra dele u sulmua nga disa kope ujqërish njëherësh... Sapo ta kujtova këtë. Buzo ka veshur lëkurën e ujkut. Kjo është në fund fare. Duhet të zbresësh në fund, po nuk është e thënë të kalosh në fundin e fundit, mjafton kaq: në fund. Buzo e fitoi betejën e tij me vdekjen. Po çfarë beteje? Kalo edhe një herë në fillim. Pikat e ngrohta të gjakut të deleve që vrmonin dëborën ngjanin me plumba që shpojnë trupin e njeriut. Ujqërit nuk kanë kohë. U çajnë barkun dhe u hanë

në fillim mëlçinë. Edhe këtë e ke lexuar. Më poshtë. Nga mëlçitë ngrihet një si avull. Ujqërit janë kaq të uritur sa pranojnë përleshjen me qentë e egërsuar e ndërkohe vijnë në hanë. Dëgjohet thithja e mëlçive. Njëri prej tyre guxon më shumë. Mbetet i vetëm, çan një dele tjetër e fillon ta thithë nga barku, kur ujqërit e tjerë janë larguar të ngopur. Buzo sulet drejt tij dhe i kërcen përsipër...

Ah, e more vesh çfarë i kishte fshehur Zeno kryebariut Izet? Ta them unë. Një cen në biografi, po jo në të tijën, në atë të qenit...

E për çfarë hynte në punë kjo aftësia e Zenos për të njohur delet, mendon ti, besoj. Them se ia vlen të merremi me biografinë e tij. Kërkojmë në tekst, diku do të flitet për të.

Kalojmë në fillimin e parë të fundit. E kemi lënë bariun Zeno me lëkurën e deles së vrrarë në dorë dhe qengjat që blegërijnë duke kërkuar nënën e tyre. Zeno e di se çfarë duhet të bëjë. Veçon një dele nga tufa që nuk ka më qengja. Në dorë ka ende thikën e përgjakur. E shikon kryebariu Izet. Shkëputet nga grupi ku janë shtruar me mish e raki, ndërpret këngën polifonike e i lë të tjerët duke mbajtur ende iso. Delja i ikën Zenos nga dora e bashkohet me tufën... qengjat mbeten aty pas lëkurës së deles mëmë e vazhdojnë të blegërijnë 'sa të këpusin shpirtin', është shkruar këtu nga unë. Do ta ndryshoj.

"Këtu urdhrat i jap unë! More vesh? Po meqë je i zoti të rrjepësh, ja ku e ke! Dua lëkurën e ujkut! Shpejt dhe hajde të pish me ne!"

Zeno u mundua të kuptonte se ku donte të dilte. Nuk ishte aq i marrë sa të piqte në hell mishin e ujkut! Gjetiu e kishte ai. Ja ta shohim.

"Pastaj do e marrim vesh sa i zoti është Buzoja yti!" shtoi Izeti teksa largohej.

Të kthehemi te qengjat. Tani ishin të frikësuar. Zeno e vari lëkurën e deles në një hu dhe filloi me rrjepjen e ujkut. Qentë e mbyllur në kolibe pushuan të lehurat.

Ti do të pyesësh me siguri se çfarë do bënte Zeno me lëkurën e deles së çarë nga ujku. Edhe unë mezi pres ta di. Do kem harruar ta shkruaj. Mbase e shtoj gjatë rishikimit. Ja, prit. Kjo pjesë lidhet me fundin në fakt, me paqen. Sepse në fund gjithmonë paqja triumfon.

Ai bëri diçka të pazakontë. Veçoi një dele çfarëdo dhe e veshi me lëkurën e deles së masakruar. Qengjat e saj e ndoqën si të ishte nëna e tyre deri në pranverë, kur u bë gati të lindte. Po edhe qengjat jetimë, tanimë të rritur, i ngarkuan në një trap e i dërguan t'i therin për mish. Jo, se tragjeditë tek kafshët janë 'të padukshme'. Pasi fëmijët e birësuar u çuan për therje, Zeno i hoqi deles lëkurën, sepse edhe barku i saj ishte rritur shumë. Vdiq edhe ajo në lindje, pasi bëri katër qengja të cilët mbetën jetimë.

Në trapin që erdhi për të marrë qengjat e rritur për mish kishte hipur edhe një inspektor policie që vinte nga një qytet i largët. Po për këtë është më mirë të lexojmë më vonë.

Kthehemi në ditën e masakrës. Izeti atë mbrëmje ishte si një dirigjent orkestre në mesin e kolegëve që pinin e këndonin. Zeno, ndërkohe, kishte larë duart nga gjaku dhe kishte zënë vend pranë të tjerëve. Qeni kishte lënë kolibën kolektive e i qe vënë pas. Nuk i shqitej, dukej shumë nervoz, me sa duket, nga përleshja me ujkun. Dy herë i kishte skërmitur dhëmbët pak më parë, kur Zeno po i rripte lëkurën. Ishte në anktë për qenin, po edhe për vete. Çfarë kishte në mend Izeti? A dinte gjë vërtet për të dhe Buzon? Mbase po. Izeti, si kryebari, ishte i vetmi që e kishte lënë ishullin disa herë.

"Tani do kënaqemi. Ky është teatër. Teatër me aktorë kafshë. Keni parë ndonjëherë?" tha Izeti. "Siç e dini, jemi

të izoluar. Liqeni ka ngrirë po jo aq sa për të lëshuar slitat. Duhet të racionojmë ushqimin. Mishi i deleve të çara nga ujku duhet të na nxjerrë deri në pranverë”

Ra heshtje, askush nuk guxonte të pyeste. Izeti kishte në dorë lëkurën e rrjepur të ujkut. Buzo u fsheh në këmbët e Zenos. Izeti e mbushi lëkurën me bar dhe e lidhi pas një huri të lartë.

“Duhet të seleksionojmë qentë, t’i shfarosim ca!” tha Izeti. “Do mbeten vetëm ata që janë të zotë të përballojnë ujkun! Nuk kemi ushqim për frikacakët!”

Mori në dorë mauzerin dhe një kuti me fishekë. Shkoi tek kolibja dhe afroi një qen, që i doli para duke iu përkëdhelur. E ndërseu ndaj ujkut dordolec. Qeni u frikësua dhe u tërhoq ‘me bishtin ndër shalë’, paskam shkruar. Do ta heq edhe këtë më vonë. Izeti mori pushkën i futi një fishek në gojë dhe e çoi qenin te rripa. E qëllloi pas qafe.

“Tjetri!” thirri. Një bari shkoi të merrte qenin e radhës.

Zenos nuk iu ndejt.

“Përse i vret, o Izet? Do që qentë të jenë të fortë? Hiqi nga ajo vathë ku i ke futur. Qeni jeton i vetëm, në një kolibe, e pret që deriçkën në mëngjes t’ia hapë padroni i tij.”

Izeti shkrep i mauzerin edhe një herë.

“Tjetri!” vijoi dhe i hodhi një sy Buzos poshtë këmbëve të Zenos.

Si ishte puna e atij inspektorit? Pyes tani unë si lexues. Kalo në temë. Inspektori pra, tha se kishte ardhur vetëm për qenin e tij. Zeno nuk hynte në këtë mes. Ishte njeri. Urdhri i arrestit ishte vetëm për qenin. E shoqëronte Izeti. Nxori një letër të palosur dhe filloi ta lexojë.

I fundit që u përball me lëkurën e ujkut ishte Buzo. E morën gati me forcë nga poshtë tavolinës. Nuk i bindej as padronit, Zenos. Mbase e kishte nga ajo ndenjja në koliben e madhe me qentë e tjerë. Po bastardohej. Erdhi vetë Izeti dhe e mori. E çoi tek shtylla. Shtylla apo huri? Njësoj është. Buzo as që i skërmiti dhëmbët fare. Dukej më shumë pa dëshirë, se sa i trembur. Fati i tij ishte tanimë i shënuar, si në tokë dhe këtu në ishull, mendoj Izeti. E priste një plumb pas koke.

Zeno u ngrit në këmbë, krejt i djersitur. Buzo për të nuk ishte thjesht një qen, ose më mirë, ishte thjesht një qen, një mik që ishte arratisur bashkë me të në këtë ishull. Sikurse Izeti nuk ishte thjesht një bari, ishte bariu shëtitës, e më parë thjesht një udhëtar që ecën me qenin e tij, siç ka ndodhur për mijëra vjet. Nuk dihej kush nga të dy mbronte tjetrin.

Po çfarë ndodhi me qenin atë mbrëmjen e masakrës?

“E kam marrë vesh se ti nuk je thjesht bari... thikën po, di ta përdorësh mirë!” tha Izeti. “Buzo, nuk ka nevojë të përballtet me një ujk të ngordhur, aq më tepër kur ishte ai vetë që e mundi të gjallë!” Heshti pak. “Tani, Zeno, merr lëkurën e ujkut dhe qepja mirë Buzos për trup, po kur them mirë e kam fjalën të mos duket fare në është qen apo ujk, ose le ta quajmë qen-ujk. Këtë që them merre si të duash, ose si çmim ose si ndëshkim për të!”

Zeno edhe një herë nuk mundi të interpretojë sjelljen e Izetit. Afroi Buzon, e përqafoi dhe filloi t’i vishte lëkurën e ujkut, kaq saktë, sa ajo ju bë lëkura e tij e dytë. Atë natë qentë nuk e pranuan në koliben e madhe. E Buzo ndenji në koliben e tij.

Zeno sapo kishte rrjepur lëkurën e deles që la qengjat jetimë e po bëhej gati t’ia vishte një tjetre, kur inspektoi mbaroi së lexuari aktakuzën për Buzon. Kishte kafshuar një zonjë me kone dhe ishte dënuar me vdekje. Inspektori, më pas, kontrolloi gjithandej, përqasi të gjitha fotografitë që kishte, por asnjëri prej qenve nuk e bindi. Qenit-ujk as që ia hodhi sytë.

“Ah,” shtoi më në fund. “Ai ishte i shoqëruar nga padroni i tij. Një udhëtar. Kot e kërkoj në ishull!”

MES BRYMËS SË LOTIT

Poezi nga Rexhep Polisi

ERËRAT E JUGËS

Në Jug tani fryjnë erërat e Jugës,
Rrugët kanë ngrirë nga dimri i acartë;
Gurët e mallit lartësohen drejt qiejve,
Malli im tretet në qytetin e lashtë...

Gurët e mallit lartësohen drejt qiejve,
Ëndrra përkundet në dallgët joniane.
Me mijëra herë i hipur në kuajt e erës
Jam nisur në udhën e shpresës asaj ane.

Në Jug tani fryjnë erërat e Jugës;
Ka ngrirë pasioni brenda meje;
Do nisem dhe, në mbetsha udhës,
Do të prehem në një vello reje...

KUR TI NUK JE

Kur ti nuk je,
Mbrëmja
Tretet
Në harresë,
Nuk është
Më mbrëmje...
Kur ti
Je aty
Brenda
Një fshehtësie,
Si vetë fshetësia,
Mua më ikin
Krejt mendimet
Dhe veten
E shoh
Të robëruar
Tek puthja...

MIMOZAT...

Në sythet e çelura
Të mimozave
Shoh sytë e tu,
Që vështrojnë
Përmes qelqit të shpirtit tim.
Ti nuk i dallon lotët e mi
Që njomin dhembjen e verdhë.
Aroma e mimozave
Shpërndahet në gjithësi,
Në qiellin e paqhtë
Fluturojnë ëndrrat tona
Të bardha, ndërsa
Sytë e tu magjepsin
Sythet e çelura
Të mimozave...

PRANVERË

Çelën pemët, rrugët shndrisin
Gjithandej plot shkëlqim.
Të rënduar e kam shpirtin:
As hir, as gëzim...

Dhe eci rrugëve, kuturu...
As vetë s’e di ku shkoj,
Sikur të vije ti këtu,
Do të ishte tjetërsoj...

Më mungon buzëqeshja jote,
Shikimet e tua si shigjetë.
Eh, s’ia gjetën fundin kësaj bote,
As filozofë, as poetë...!

Dhe rri pastaj, mendoj me vete,
Kërkoj një puthje në ajrin flu,
Për atë puthje do të çaja dete,
Veç të më prisnin krahët e tu...

MURI

E shemba murin që na ndante shtëpitë,
I shqeva me dhëmbë telat me gjemba.
Po, si ta shemb, si?
Murin që ti mban përbrenda...

I qelqtë ajri me parfum bliri,
Rruga me argjend hëne larë.
Krejt e qelqtë kjo mbrëmje prilli,
Veç ti nuk je si më parë...

DHEMBJE

S’i shquaj lotët e mi,
Veç i ndjej
Si pikojnë
Së brendshmi
Në shpirt.
Ndjej si digjen
Pendetat,
Hidhërimi,
Fjalët pa kuptim
Dhe loti jetim...
Digjet gjithçka
Brenda shpirtit tim,
Ndërsa hiri
Ditën ma nxin
Dhe ec kuturu
Në harrim...

MALL

Mallin për ty
E ndera mbi letër.
Letra s’e mbajti dot.
E shtrydha,
Pikoi lot...



VRASËSIT

Edhe vrasësit
Çojnë lule në varreza.
Lulet në duart e tyre,
Tyta të errëta...

PUTHJE DIELLI

Kam mall për atë puthje dielli,
Kam mall për atë përqafim...
Ti vështtrimin ktheve nga deti
E u përsquqe me perëndim.

Ku ndodhesh këtë mbrëmje?!
Më kot të kërkoj në largësi...
Muzgun e puthjes pi me ëndje
Dhe vdes në perëndimin e tij...

DIMËR

Qajnë pemët,
Rrugët heshtin gjithë lëndim...
Asgjë s’pipëtin në motin gri,
As borë nuk bie në qytet.
Veç pemët qajnë;
Qajnë prej mallit tim
Për lulet, për zogjtë,
Për Njeriun
Gjithnjë në shtegtim...

VALË E NXEHTË

Kur deti puthet me diellin në muzg
E valët qetohen nga dallgët në breg,
Mbrëmja vjen lodhur rrugë pa rrugë
Dhe me trillet e dashurisë më djeg...

Ti je në bregdet tani,
Detin pushton me vështime,
Ndërsa unë të sjell ndërmend
E pështjellohem nga mijëra vegime.

Më tërbon bronxi i trupit tënd,
Pushi i mëndafshtë në vendin e shenjtë.
Aty do të doja të përhumbe
Dhe të zgjohem nga ajo valë e nxehtë...

MES BRYMËS SË LOTIT

Të gjithë po ikin,
Po ikin e s’dinë ku venë.
Po ikin harruar,
Të zbrazur, pa shpresë...

Të gjithë po ikin,
Larg dheut, drejt mallit...
Vetëm unë mbeta vetëm,
S’di si të dal pas të parit.

Çapitem udhëve përhumbur,
Mbuluar nga terr i shortit.
Me sytë nga ikja e të gjithëve,
Tek çajnë mes brymës së lotit.

1.

Ra një yll

V-së

Endem në univers, nëpër yjësi...
përtej fantazisë.
Në mend të kam ty.
Zbres në Hënë,
te Det' i Qetësisë
atje një shenjë lë,
për hir të dashurisë,
inicialin tënd "V",
që koha kurrë s'e fshin.

(E di ti të fshehtën: Erë në Hënë s'fryn.)

E pazakontë duket, sublime...
Në Hënë, si në ëndërr,
ngadalësohet ritmi i fluturimit.
Sendet e humbasin peshën,
por jo esencën.

Ëndrra, si një balonë ajri,
më merr në largësi...

Endem qiellit si eremit,
gjashtë herë më i lehtë se trupi im,
i çliruar nga rëndesa e vetes,
nga çdo paradigmë.
Dashuria përherë enigmë,
gravitacion biblik.
E di nga Ajnshtajni, ekuacioni magjik: V-ja afron dy skaje
në një pikë
dhe i çon ato në infinit.

Nga shkëlqimi i përkohtë një meteor u fik.
Teksa shkrihet në rënie, terri e përpin.
E fal trupin, jo dritën e tij!

Mendoj për ty.
Nesër, sa të lindë dielli,
krahët të m'i shkrijë,
si meteor, në s'u djegsha,
a mbetsha qiellit varur,
do të vij.
Në ekuinoks.
...
prej largësisë ekuivalente mes nesh,
në ditën baras me natën,
nga koha kur ishim aq larg
dhe po aq pafundësisht afër.

Largësisë dashuria humb,
nëse s'mbërrin në fund.
(Për dashurinë, në këtë botë,
Sa pak është një jetë, o Zot!)

Të kujtohet?
Ekuinoks... '81,
21 mars.
Në kohën pas,
Si oazë.

2.

Loti

U këput një lot,
Ra syrit rrëke,
U rrit u bë lumë
Dhe u derdh në det.

Nga dhimbja në shpirt,
Pa fund e pa anë,
Lumi u bë det,
Deti oqean.

3.

Lejleku misterioz

(Kujtimet të nënës)

Kur pyeta njëherë nënën si erdha në botë,
"Të ka sjellë, - më tha, - mbi krahë një lejlek".
Shtegtar ëndërrova të bëhem atëherë,



BURGU I ZEMRËS

Poezi nga Timo Flloko

Udhën e lejlekëve qiejve të ndjek.

I parritur ende s'e rrokja kuptimin,
Qiejlor të jem, bëja habi me vete,
Mbi krahë shpendi ardhur se nga ku, Ndoshta nga hiçi, përtej
kësaj jete.

...
Në zgrip të gjumit një natë beft u çova,
U nisa për rrugë misterin të prek,
Të fshehtën të zbuloj, folenë misterioze,
Nga ku më kish sjellë në jetë ai lejlek.

Humbi sensi i kohës, kufijtë, largësitë, U enda botës, m'u duk
sa për dy jetë,
Por kurrë nuk e gjeta ku fshihej enigma,
Miti i krijimit, Grali im i Shenjtë..!

Largësitë braktisa, endjet horizontesh,
Kur shpresat i humba, m'u shfaq një vegim,
Ai imazh hyjnor që më pat thënë nëna,
Lejleku shtegtar qiejve në kthim...-

Në kulm të natës më çuçuriti në veshë,
Disa fjalë të një gjuhe që s'kuptohej lehtë,
Mbi krahë të solla, me krahë po të marr,
Si shpirtra njerëzit, vijn'-e-ikin në jetë!

4.

Manekinet

Nëpër vitrina pozojnë manekinet. Syshkruara,
të brishta,
sensuale,
të trishta,
qafëgjata si pata.
Seksit i bëjnë fetish!
Oh, Krisht!

Të përkryera,
pa moshë,
as plaken as vdesin.
Nuk e përfillin as e shpërfillin,
virtytin dhe vesin.
S'njohin braktisje,
ndarja s'u dhimbset.

Detit të shpresave
as notojnë as mbyten.
Sajohen, stolisen, vitrinash veniten. Hidhen e priten, eshtrat
s'u vriten.

(Për statistikë,
në jo pak raste,
Adhuresë të marrë,
Për to kryejnë vetvrasje).

E ftohta manekinë që feks në vitrinë,
Unë s'mund të të ngjall, të të jap frymë.
Ik nga ky burg, ti s'je një robinë,
Shtegëto, dashuro... jeto lirinë!

Por zemër ti s'ke, bukuri e ngrirë, ndryshe do të kërceje,
do merrje arratinë,
pozat do braktisje, për t'u ndier femër, sikur copë ta bëje,
xhamin dhe zemrën.

5.

Xhelozi e detit

Det, sa duheshim atëherë,
Kurrë s'e kuptova
pse më ngrije kurth
kur zhytesha thellë teje,
me dallgë përpirëse në furtunë frymën ma merrje,
pastaj bregut më përkëdhelje,
me ledha valësh më dehje.
S'munde dot, për hir të së vërtetës,
të ma merrje jetën, se t'i dija hiletë.

Në vite nga ajo kohë u ftohëm,
si dy dashnorë të largët mbetëm,
kufij vendosëm mes njëri-tjetrit
dhe u ndamë heshtur.

Mbrëmë, për inate të vjetra, meskine, fundose një imazh në
bregun e syve, gjithë fotot e kaltërsive i përpive,
i fshehe, i fshive...
inatçor, me dallgë zemërimi
ndaj qiellit plot yje.

Ti s'e ndien fajin, hakmarrjen primitive,

por unë kam një vend të shenjtë në zemër ku i ruaj kujtimet.
Sa të bjerë stuhia, do të vish në vete.
Ti m'i mbylle përngaherë portat e të fshehtave.
(Kurrë nuk e mendoja se ajo urrejtja jote ataviste, dashurinë do ta vriste.)

Si i harrove netët
kur sytë i mbyllja si i verbër,
shpërfillja yjet feksës, mahnitës mbi vete,
gjithësinë,
teksa shihja poshtë, i harruar, thellësitë?
Ty ta falja, det, jo qiellit, dashurinë.

E fundit fjalë:
Kush dashuron fal,
unë prapë të dua.
Xhelozia vret,
kush dashuron vuan.

6.

Miqhtë

Falini gjithmonë armiqhtë. Asgjë s'i mërzit më shumë.
Mark Twain

Kot e ke, më tha vetëdija,
Njerëzit s'janë përherë miq,
Ti pandeh se ata të duan,
Por, në fakt, i ke armiq.

I them vetes, pse, s'kanë shkak, S'kam pushtet, as ofiq,
Nuk urrej askënd në jetë,
S'ndaj të mirë dhe të ligj.

S'ka të bëjë, ata s'të duan,
Udhës shko, pas mos i ndiq.
(Dashuri ti s'fal, thotë Krishti,
Po s'i deshe dhe armiqhtë!)

S'është çudi, në këtë jetë
Mes armiqsh ka të tillë “miq”
Helm i egos i ngërthen
Dhe i bën, oh, sa të ligj!

Mos u lig, mos u mpak,
Thotë vetvetja, je një hiç,
I pavlerë në këtë botë,
Po nuk pate dhe “armiq”.

Veç një jetë, njerëz, kemi,
Si të mirë edhe të ligj,
Në pusí një ditë në rënça,
Mos qoftë thënë ta kem nga miqtë!

7.

Bisedë me Ajnshtajnin

Pse nguten njerëzit në jetë pa pushim
kur i pret fundi fatal?
A ka formulë që kohën ta zgjasë,
ta kthejë mbrapsht,
ta ngrijë e ta ndalë?
Përgjigja e Ajnshtajnit,
profetike,
e saktë,
si një lëvizje në shah,
pyetjes time pa takt,
shpërfillshëm i bën mat:

“Lëvizja kohën zgjat!”

Pyes veten:
Ka një kufi shkenca,...
sensi i saj, fuqia,
teksa ... Ajnshtajni thotë:
“Imagjinata është më sublime se dija.”?!

Ndoshta, më kot, nga dobësia,
pasiguria në vete,
rrekem të kuptoj ç'fsheh sekreti,
koncepti vrasës
i relativitetit:
Kjo jetë e brishtë, e përkohtë,
e shkurtër si një shi veror,

një ditë ndal, si gjethi këputet,
(Për shpëtim as Zoti s'na i dëgjon lutjet..)
Pse vdekja mizore
të jetë e përhershme,
kur relative është çdo gjë absolute?

Duket se Ajnshtajni, këtu m'i mbyll shtigjet,
I ngurosur në mur, hesht e s'jep përgjigje.
Ç'të thotë tek e fundit,
S'mund të flasë së koti,
Jeta, përjetësia,
Janë domen i zotit!

8.

Burgu i zemrës

Për rebelim e burgosën zemrën,
Jo në Alkatras, as në kështjellën **If** a të **Uindsorit**,
Ngase rrihte fort dhe ishte e paepur,
E mbyllën në burgun e krahavorit.

E ngujuan në asht, pas eshtrash me jetë,
Me burgim të përjetshëm e dënuan,
Në tortura e vunë, nga më mesjetaret,
Por rrahjet dhe zjarrin dot nuk ia shuan.



9.

Treni imagjinar

Sa herë matem me kohën që rend,
në çdo rast ndihem i humbur.
S'i kam jetuar, i kam shpenzuar më kot,
mijëra ditë e net të ikura,
nga shkujdesja, në të shkuarën...

Shpesh
më bëhet në ëndërr se pres,
në një stacion të shkretë
një tren imagjinar,
për kthim në të shkuarën.

Sado që rend të mos humb një sekondë,
përherë mbërrij vonë,
tepër vonë, në stacion.
Por s'e humb shpresën, pres.
Një tren tjetër do të vijë,
treni i fundit me ndalesë,
që mbledh të vonuarit.
...

S'dua ta humb atë tren,
i vetëm të mbes,
si Mohikani i fundit,
në mes të askundit...

Ndoshta, më mirë të harrohesh, shkujdesur,
në pakohë,
nëpër vagonë vitesh,
pa e ditur
se në ç'stacion të largët
ndal treni që ke pritur...

10.

Shkallë për qiell

Ngrita sytë, qiellin pashë,
Ku është skaji i tij, thashë.
A i soset fundi vallë?
Ndoshta duhen shpikur shkallë.
Të padukshme, pa dyshim,
Shkallë që zgjaten pambarim,
Që takojnë fund e fillim,
Prej këtej në askund,
Gjithësisë pa anë e fund.

Fantazova të shkoj larg,
Botën poshtë ta shoh nga lart,
Gjithë ç'pata pas ta lë,
Historitë një nga një,
Dashuritë pa shpirt në të,
Miq, të afërt që s'janë më,
Mitet, ëndrrat dhe çdo gjë.

Sa ngjita shkallën e parë,
Ndjeva frikë, të jem i marrë?
N'atë udhë katrahurë,
Humb përjetë, s'kthehesh kurrë.
Nëse ndodh atje të mbes,
Zbrazëtisë, në univers,
Fillikat e i pashpresë,
Kush kujtohet të më presë?
Nëna la një det me lot,
Iku herët nga kjo botë.
(Kthehem s'kthehem, çfarë pastaj,
Fatin tim mbi shpinë e mbaj)

U enda vite të tërë,
Jeta - një kështjellë në rërë.
Në çdo skaj me stërmund,
Fundin prekja por s'kish fund,
Ishte fund sa ish fillim,
Hapësirës pa mbarim.

(S'ka fillim as fund ky bosh,
Nis e sos ku ta mendosh.)

*
Rrugëtova aq kohë qiellit,
Mend sa preka yjet, diellin.
Rënie ngjitje na shkon jeta,
Që nga lindja gjer te vdekja.

*
Mbërrin koha që të zbres,
Yjet fikur një mëngjes...

Këmbën ula kur, për djall,
Mend u vara, s'kishte shkallë (!)
Udha çonte veç për lart
(Kurth qiellor, thirra në çart).
Pas në tokë kthim s'kish më,
Shkallët shpinin në mosgjë,
Me shigjetën Udhë pa Kthim,
Gjithësisë pa mbarim,

Zbrazëtisë së askundit,
Shkalla ime ish e fundit.

Por u zgjova atë çast,
Çfarë vjen pas, ska përmasë,
Askund qiellit s'është e shkruar,
Portë e hyrjes në parajsë.

Kurrë s'e dimë se ç'të fshehta,
Na i ngre fati më pas..!

SYTHET

Ishim të dy në lirishtë. Kërkonim lulet që bëheshin gati të çelnin. Të fryra prej epshit të natyrës, apo nga fantazia e shfrenuar? Ajo ishte bashkëstudente me mua, me një trup të hollë dhe me gjoks të madh. S'kisha parë gjoks aq të ngurtë e të plotë dhe një fytyrë me tipare të imta por me rumbullakësi të rrallë. Mendova një çast se sythi i lulelofatës kishte një fryrje të tillë që të ngacmonte, madje të përfshinte. Nganjëherë përfytyroja se sythet ngjanin si formë me gjinj të e saj. Mandej ajo qeshte, me një vështrim që s'di pse më dukej disi i ashpër, ndonëse me sy të mëdhenj xigluës. I mbahej goja. Nuk e kuptonte sesi i këputeshin fjalët dhe i mbeteshin në cepat e gojës së madhe sensuale, si flluska të vogla. Të ngjante se në buzët e saj do të çelnin sythe dhe pastaj përplot mëri s'e kishte për gjë të këpuste në mes të fjalës një nga ato të sajat që dinte t'i kripte mirë. Me bisht të syrit, rrudhur në cep - fryt i të qeshurit aq të ëmbël, - dukej se çante muzgun e mbrëmjes së verës me ca yje të veshur me mjegull, hedhur si vello përsipër, në nusërimin e ajrit të kaltëremë. I preka me sy gjithë çka ishte përreth dhe u ndala te sythet e lulelofatave, kisha frikë t'i prekja se mos më plasnin në mollëza prej bymimit. Më dukej sikur do bëhej hataja nga shpërthimi i tyre. Isha i bindur se sythet po përjetonin dhimbje të padurueshme. Si foshnja që sapo del në kontakt me botën e re ku përplasen, i kredhur në britmat e para dhe tmerrësisht i llahtaritur... Edhe ajo po shihte sythet. Më pëshpëriti duke i quajtur se ata qenë shkaktarë të asaj dhimbjeje, krejt e pafajshme, po që të trondiste me themel. Sa herë të gabosh fjalët që të ngecin në buzë, do t'i kafshoj e t'i bëj gjak, jo fjalët e tua, po buzët, do sillem brutalisht. Dhe sa herë ta shqiptosh saktë do t'më puthësh ti. Fillojmë?

«I çmendur je? Kjo është jeta jonë e fshehur»...

«Tani një strofë nga Mjeda, pastaj një strofë nga Migjeni.»

Ajo e kuptoi se e kisha me të vërtetë. E kisha diskutuar me të disa herë dhe e ndjeva që më kuptoi. Pengca e saj ishte *frenimi* që i ndodhte papritur, ndaj dhe e vendosëm së bashku që ta mënjanonim me ushtrime të tërthorta, që ta gënjenin mendjen. Jo të bësh me sikur, po të bësh diçka tjetër, të largët, që, me një të goditur vrisnim dy zogj: edhe njihnim më thellë Migjenin, edhe i largoheshim asaj pengce.

«Sythat mbajnë dietë? - më pyeti duke qeshur me sytë nga lulelofatat që në muzg të krijonin përshtypjen e një velloje vjollcë.

Ajo e qeshur mahnitëse!

«Eh? Po të mbanin dietë, do të ishin si ti. Ato janë fryrë nga lëngu veshtullor që ushqen

petlat që rriten tërë marramendje dhe jashtëzakonisht shpejt. Ato do të shpërthejnë tani, këtë

çast.

Sa filloi të fliste atë e përfshiu pengca. Menjëherë tha strofën e Mjedës dhe më pas të Migjenit. Këtë të fundit e përsëriti dy herë. Dhe fjala e ngecur u tha lirshëm dhe natyrshëm. Dhe më mbyti me të puthura, ndërsa unë i kisha harruar kafshimet e premtuara.

«Po çfarë atëherë, thuaj? Çfarë të doni, bëni! Çift. Çoçarja...»

Zëri i saj më erdhi ngasës dhe ajo nëpër muzg dukej më e bukur se ç'ishte. U ul sërish.

«Kështu vazhdo. Mëso përmendësh Migjenin dhe s'do të kesh kurrë pengca në të folur. Ç't'i bësh, ky qenka njeriu!»

Nuk iu mbajt goja, nuk i lëndoi fjalët, mendova. Le të thotë sa më shumë «ç». Dhe tek Migjeni ato paraprijnë pasthirrmat dhe janë tërë shfrenim nëpër vargjet e tij.

«Ona!», thirra i habitur nga skena që pashë pas kokës së saj. Kishin shpërthyer

TREGIME TË SHKURTËR

nga Xhevair Lleshi



sythet të gjithë menjëherë, pa zhurmë por me klithma të heshtura, duke krijuar në sfondin e muzgut një re të mahnitshme vjollcë. Sythet ishin bërë lule. Të nesërmen aty do të vinin bletët. Në atë sfond të ndezur në muzgun që mori i gjithë ngjyrën vjollcë mbetëm duke u puthur...

BURIMI I THATË

Çdo mëngjes me të, po edhe në muzg e çnjëjta gjë. Si me akull më dukej. E ndarë në dy pjesë: edhe burim, edhe i thatë... Sipër burimit kish çelur një lofatë e bukur e hajthme. Thoshin se rrënjët e lofatës, që e donin të gjithë sidomos për lulëzimin e saj të veçantë, e kishin tharë burimin. Natën te *Burimi i thatë* vallëzonin zanat. Zanat që s'dilnin kurrë ditën. Ata që i kishin parë tregonin gjëra të mahnitshme. Mbrëmjeve aty frynte një brizë e hollë që dukej sikur ta përshkonte trupin tejprtej dhe ajri i pastër ta mbushte gjoksin plot. Aty, askush nuk vinte re gjëra të papërfillshme.

Burimi i thatë, me dy lyfite gjithashtu të thatë dhe dy anësore muri shtruar me pllaka e rrasa guri, priste e përcillte fëmijë, vasha e djem, burra e gra, pleq e plaka, që vinin drejt e nga rruga dhe ia shtronin me fjalë. Njerëzia, aty, qeshnin sa gajaseshin, bile mbyteshin me lot, ndërkohë që nuk e fshihnin buzëqeshjen e hollë sa herë binte fjala për ndonjë gjë të rrallë. Një nga gratë që në fillim pëshpëriste dhe pastaj e ngrinte zërin lart, natën që gdhiu mëngjesin dhe burimi mbeti pa ujë, tha se ujin e kishin pirë zanat e pyllit, të cilat më pas kishin tundur dheun me vallet dhe s'u dukën më. Kurse tundja e dheut mbeti.

Zanat nuk i zinte gjumi kurrë. Ku s'të çonin mendimet për to. Një cigane që kërcente më bukur se to, në shtegtimet e saj të verës, thoshte se burimit do t'i vinte uji po të kthehej mëma e saj. Mirëpo e ëma s'po kthehej! Ajo kishte ikur me një cigan të ri fare, mustaqe pa dirsur. Se ajo të merrte më qafë kur të shihte në sy. Të binte të fikët. Tërë qyteti e harroi *Burimin e thatë*, bile edhe premtimin e ciganes dhe po të mos kish ndodhur ajo që ndodhi, fare pa prituri e pa kujtuar, as që do t'i binte në

mend kujt për ta sjellë në bisedat e ditës. Shkak u bë një udhëtar i rastit që e zuri nata e harruar. Ai njeri, shkonte sa andej këtej, nga të frynte era. Kur plasën ujërat! Një grua erdhi po aq papritur dhe po këndonte një këngë të vuajtur. Ishte një gjë sa e bukur, edhe e shthurur. Gruaja kërcente lakuriq dhe lahej. Ishte dimër. Frynte erë e marrë. Britmat shponin qiellin. I mbaj mend të gjitha ato që tregonin ata që s'i kisha parë kurrë në shtëpinë time dhe në qytet. Gruaja, cigania, dhe burri udhëtar ikën, u larguan nëpër natë. Por Burimit i erdhi ujët dhe lofata e bukur u tha. Ujët e burimit nuk pihej më dhe nuk ua shuante dot etjen njerëzve. Pikërisht këtu më humbi filli edhe mua, aty te *Burimi i thatë*...

PORTRETI

Herë-herë aty i përqeshnin fluturimet e njëri-tjetrit. Sa mbaronte ajo skenë, më jepnin të shtymën. Kaq i shkurtër të jetë një çast humori?

Im bir kishte zgjedhur një kënd tejet të veçantë, një kaluç me ligustra të qethura bukur, krejt i gjelbër, me muret e kruar nga shpatullat e gjithë shokëve të tij, gati t'i nxirrnin tullat përjashta, të gjenin pezhishka të varura në cepat e lartë të tavaneve, si të tymosur me art. Rrinte vetëm dhe mendonte kot për ndryshimet e orarit për mësimet të nesërmen, apo për sytë e varur të melankolisë dhe hapjes tej mase të gëzimit...

Në fund të korridorit pa shoqen e bangës së tretë nga ana e dritareve, që shikonte nga lagjja, ku përditë mund të gjeje lloj-lloj skenash. Ato fytyra, gra, burra, djem, vajza, nuse, fëmijë të vegjël, pleq e plaka, dasma, vdekje, festa të vogla, sherre të papërmbytshme, britma dhe... të qeshura të llahtarshme. E gjithë lagjja, meqë ngitej në kodër dukej në pëllëmbë të dorës. Oborre, pjergulla, trarë, dritare, sy njerëzish që herë-herë vërenin të habitur. Mësimi harrohej brenda klasës. Ditë për ditë ajo dhe Xhani ishin atje, tek shtëpitë e ulëta të lagjes së shkollës. Në njërën nga dritaret ishte një vajzë e bukur, me flokët gështenjë që shihte nga ata. Çdo ditë. Çdo orë. Gjithnjë kur

kishin mësim. Vetëm kur qenë në palestër jo, ose në natyrë, në kopsht, në fushë, apo në laboratorin e fizikës e të kimisë. Herët e tjera e kishin aty. Ia mësuan emrin dhe habiteshin me qëndrimin e saj të pa lëvizur, të qeshur. Me orë të tëra, shikonte një pikë të pacaktuar. Tiparet i dalloheshin qartë, s'dukej se mund t'i kapte syri ndonjë gjë, ngrinte tufën e flokëve me një lëvizje plot hijeshi të kokës, pa zhurmë dhe me një përpulje tërë fshetësi...

Shoqja e bangës së tretë nga ana e dritareve nuk shihte kurrë nga dritarja. Kurse të tjerët vdisnin për të parë andej, jashtë qelqeve. Edhe kur i lyen xhamat me gëlqere, ata i rropën të gjalla e i bënë të ndritshme, pak si qiqërim. Dritaret qenë nga lindja dhe dy orët e para e kishin të vështirë. Nuk i linte dielli me përqeshjet e tij të mahnitshme. Dhe ajo ishte po aty, paksa e përkulur mbi pezul, me kokën e anuar, flokët e dalldisur, sytë e hapur tej mase, sikur të kërkonte diçka nëpër mjegull. Ajo si të gjitha vajzat vishej lehtë dhe fustanet, bluzat apo fundet i rrinin bukur dhe i shkonin shumë. Më ngacmojnë fort, thoshte një nga ata të bangos pas Xhanit dhe ndihej një e hequr e thellë. Dukej se i vuante shpirti. Ajo që s'ta kapte syri tek ajo, dhimbja, nuk shihej dhe as kuptohej se ekzistonte. E kush i donte hollësisht që s'duken? Ajo i bëri djemtë të çmendeshin. E kërkonin pasditeve, mbrëmjeve, gjatë shëtitjeve, në lulishte, në park, nga bregu i lumit, nga rruga e Kalasë, nëpër sokakë, kudo. Nuk e gjetën kurrë. Kurse të nesërmen kur sa uleshin nëpër banga hidheshin fjalë e romuze të kripura, ndaheshin e pajtoheshin me njëri-tjetrin, rriheshin edhe me grushte ose qëllonte të shanim e të pështyeshin. Dukej se vërtet ndiheshin të përkëdhelur që dikush atje matanë, as tridhjetë metra nga dritaret tona, i shihte krejt indiferente. Çfarë budallallëqesh, çfarë ekrani që kishin, as në filma jo ashtu. Diçka që i bënte të ndiheshin të famshëm. Dikush i shihte, kurdoherë me një sy të mjegullt, sikur mezi priste ndonjë skandal, sidomos nga ata që mbahen mend, që shkëlqejnë ashtu kot së koti... As emrin nuk ia mësuan kurrë. Nga viti i parë në të dytin, nga i dyti në të tretin ajo aty. Sikur ndiqte rritjen tonë. Dukej se i përkëdhelte me sy. Por ajo nuk shihte asnjëherë nga dritaret e tyre. Edhe kur e kapnin fluturimthi shikimin e saj mbeteshin keq. Ulnin sytë. Psherëtinin...

Ata mendonin sesi do të qe bota kur ajo do të ishte larguar përfundimisht, po befas Xhanit ia kapi syri. Një psherëtimë e gjatë, e bukur, si frymë e ngrohtë e përshkoi tërë klasën. Kishin hartim dhe asnjë nuk po shkruante. Tema «Portreti». Ajo u mbështet si më shumë dhe gati do varej mbi pezul. Përsëri një psherëtimë. Profesori nuk po na ndiqte. Diçka lexonte, duket. Ajo ishte psherëtimë më e bukur që kishin dëgjuar ndonjëherë. Portreti u tërhoq pas dhe një «ah» mbeti pezull. Shoqja e bangës së tretë bëri një lëvizje dhe vajza në dritare mbeti në profil. Një dorë burri ra mbi faqen e kundërt, pas profilin të vajzës... Një «uuu» e gjatë, fëshfëritëse, i mbuloi si një cergë. Përsëri profesori nuk i dëgjoi. Ata besonim se i dëgjoi tërë shkolla, kurse zërat tanë do kenë qenë të shuar... Ajo u largua duke mbajtur kokën me dorë.

Nuk e pamë më as ditët që erdhën.

Nuk e pamë më...

- Hartim më të keq se ai i asaj dite s'kam bërë kurrë, - më tha Xhani. - Vonë, në mbarim të vitit shkollor, dëgjova një zë të ngrohtë: Për ty kam ardhur. Ktheva kokën. Ishte shoqja e bangës së tretë. Nuk të shkon fare mërzia, tha. E njoha nga zëri. E ktheva kokën prapë dhe pashë që ajo po fliste me Lean, shokun tonë, që buzën e poshtme e kishte të varur tmerrësisht keq...

Kujtoi për një çast se do kishte ardhur në korridorin e jashtëm të shkollës vajza me portretin më të bukur në botë, që do t'i duhej ta përfytyronte si të gjithë, çdo ditë...

Nuk e di pse Kristaq Mitron fillova ta nshikoj nga brenda trupit; zemra, mendja, mushkëritë, veshkat, mëlcia, gjer tek e padukshmja, shpirti. Ishte nje stetoskop hyjnor, pastaj një skaner që vinin prej blusë qiellore dhe maste të fshehtën e sëmundjes së mikut tim. Nuk parandieja asgjë të keqe, asgjë pothuajse. Sepse në atë kohë ishim rrëmbyer të dy nga ëndrra për të bërë film. Ëndrra nuk ka punë me asgjë lëndore, rron jashtë organizmit dhe vëmendjes sonë për çfarëdo lloj sëmundje. Përderisa ëndrra ishte aq e fortë, kishim besimin se na mbronte Zoti. Sa iluzion ka në punën e një artisti. Ai është dhe s’është. Vihet re vetëm kur një punë e tij pëlqehet. I heqin kapelen. Kaq. Pastaj e harrojnë. Ai është i padukshmi midis të dukshmëve që rrojnë natyrshëm pa i kaluar caqet këtej ëndrrës. Ëndrrës së artit që djeg dhe zhurit trupat e të padukshmëve. Po ç’është ajo botë e andej ëndrrës, e blusë qiellore, që s’dihet prej ç’fryme perëndie rron? A besohet po ta pohojmë këtë gjë? Do të na kuptojnë? Jo. Kurrë s’u kuptua. Sa herë jemi penduar për pak kohë dhe jemi ankuar; ç’e patëm këtë fat, si nuk u bëmë elektrikistë apo hidraulikë... të gëzonim jetën e thjeshtë! Ç’fuqi duhet për të bërë art të mirëfilltë? Duhet t’iu drejtohem miteve se realiteti nuk sugjeron asgjë. Madje do të më qeshin po të them se fuqia e Herkullit është fuqia e artit (por në planin shpirtëror, të kësaj zeje që s’kuptohet.)

Ishte një karrige e qëllimshme, që nxirrej nga poshtë banakut dhe ftohej Kristaqi të ulej në të. Ai, pa e bërë të gjatë, ulej menjëherë dhe, pasi e merrte veten, lëshonte një nga ato batutat e tij që i bënin vajzat të qeshnin. Ishin shitëset e supermarketit italian Conad, ku ai blinte më shpesh ushqime, një oaz i çuditshëm, ku s’kishte beduinë me deve, apo pelegrinë që shkonin në vendin e shenjtë e që ndalonin aty gjatë rrugës, po një regjisor filmi, pa Mekë. Qëkur pa Mekë, pikërisht ai që dikur kërkoej ngulmueshëm të bënte film. Tani s’kërkohet më, po refuzohet. Ç’ka ndryshuar? Shqipëria. Ajo i vret artistët. Pa mëshirë. Edhe atë oaz të vogël, një karrige te Conadi, ajo s’ta jep më. Politikanët e rinj, bijtë e të vjetërve, i shkruajnë vete skenarët, i xhirojnë vetë filmat dhe po ata janë aktorët. Në filmat e tyre ka ujë, në jetë s’ka, në filmat e tyre ka rini të qeshur, në jetë s’ka, sepse ata ikin, ia mbathin nga Shqipëria, në filmat e e tyre ka Europë, po në jete s’ka, në filmat e tyre ka Amerikë, po në jetë s’ka, në filmat e tyre ka bollëk, po në jetë s’ka, të rinjtë ikin, pleqtë vdesin në mizerje.

U deshën katër vjet të shkruhej skenari (unë jetoja në Amerikë) dhe takimet tona ishin të rralla. Ai ishte skrupuloz, gjer në manierë, i rishkruante episodet, bënte tekniko - regjisorialin dhe pastaj e prishte. Është artificiale, thoshte, flitet për jetë, jetë të vështirë, është historia e një vajze të re të pafajshme, që dashuron mësuesin e vet dhe e vrasin, e therin në mes të qytetit. Skenari bënte fjalë për një vajze të përjashtuar nga shoqëria, sepse s’kishte asnjë mbështetje, përveç vetvetes. Asnjë ndihmë. Sepse, për më tepër, ishte shumë e bukur. Dhe për këtë arsye lehtësisht e vdekshme. Ai qytet i vogël nuk e duronte të bukurën. Ajo i shndërrohej në armike.

Dhe ne të dy herë e gjenim mirëkuptimin, herë nuk e gjenim. Ai kërkonte të pamundurën në art, atë që ishte iluzion, por jo mundësi. Katër vjet. A është normale kjo? Po. Me Kristaqin, po!

Në art koha nuk është koha reale. Katër vjet mund të jetë dhe një muaj, por edhe një ditë. Përsosmëria nuk njeh kohë. Pra, po flasim për kohën artistike, asnjanesën. Më hyjnoren dhe m të papërfillshmen.

Kristaqi ishte 73 vjeç, kur u rinjohëm pas 15 vjet shkëputjeje, ai në Shqipëri dhe Vienë, unë në Amerikë. I hajthëm, teper i qeshur e i sjellshëm, i thjeshtë gjer në ngasjen për ta ngacmuar, aq e pabesueshme dukej kjo thjeshtësi e tij. Kishte një të ecur prej atleti, gati i ajërt kur nxitonte per të takuar. Por në art ishte i vështirë, kërkues i marrosur. I paqetë. Ky shndërrim ishte dhembja e tij që nuk vërehej prej të dukshmëve të përditshëm. Atë kohë rrinte shumë me Kristaq Dhamon, e priste me padurim kur kthehej nga Amerika. E donte shumë për zgjuarsinë, dijen e gjithanshme kinematografike. Më ka



ndihmuar shumë, Roland, më thoshte, më ka mbrojtur. Ai ishte nxitja që unë, pas dy tre dokumentarëve të suksesshëm, të guxoja të mendoja për filmin e parë artistik me metrazh të gjatë. Ashtu pa u kuptuar, krejt natyrshëm, (ai fshihej pas kësaj lidhjeje) më sugjeroi të gjeja nje regjisor tjetër, për ta patur më të lehtë. Eh, biografia, gracka e mallkuar. Ai s’donte që unë të bija në atë grackë. Kështu u realizua filmi i parë me Ibrahim Muçën; Dimri i fundit. Të gjithë filmat i bera me të. Ishim miq të ngushtë, plotësonim njëri-tjetrin. Por tani ka ardhur një moment tjetër në jetën time, dua të xhiroj filmin e fundit, të vë firmën time; Kristaq Mitro, një film autor. Kjo është ëndrra ime. Pse e dua kaq shumë këtë film? Ja sepse; sa herë nuk e kam mirë me ndonjë koleg, dëgjoj fjalë; e mo, se filmat i ka bërë Ibrahim. Kur e kam mirë; e mo, se filmat i ka bërë Kristaqi. Ç’ditë të paharruara kemi kaluar; filmi zinte filmin. Shpejt, filloni filmin tjetër. Nuk kemi kohë. Duhën 14 filma. Është muaji dhjetor. Tek ju e kemi varur shpresën, që të dërgojmë lart lajmin e mirë; u plotësua plani, u bënë 14 filma. Vërtet, ç’ditë kanë qenë ato kur xhironim; Nusja dhe shtettrrethimi, Duaje emrin tënd, Njeriu i mirë, Apasionata, Një djalë dhe një vajzë, Vdekje a liri. Jam mbushur me kujtime, me dhembje, me lumturi, me pengje, mospëlqime, por gjithsesi ndjem i paplotësuar, pa filmin që dua të bëj vetë. Ja, kjo tema e njeriut, sidomos e gruas, të përjashtuar nga shoqëria, që kërkon ndihmë dhe s’gjen, që shpik ndihmë nga vetvetja, më pëlqen shumë dhe e shoh filmin, e shoh gjer në detaje. S’fle. Më del përpara figura e saj ende e paplotësuar. Kemi ende punë.

Të shkruhet një skenar shtatë herë gjersa t’i mbushet mendja Kristaq Mitros. S’kishte patur fat me skenarin e parë, (sipas një romani të FluturA Aqkës) tani kishte shpresa të mëdha te skenari i dytë, te Tereza që e therin burrat në mes të qytetit.

ËNDRRA

Sa do të rrish? Dy muaj. Mirë, kemi kohë. Ishte shumë entuziast. Vapë përveluese. Do të shkojmë te Senatori, më thoshte, aty ka kondicioner, është një mjedis i qetë, i pastër, me shumë dritë, si te tregimi i Heminguejt. Senatori është nje hotel luksoz, pranë shtëpisë së tij, atje mblidheshim mëngjeseve dhe mbrëmjeve, pjesën më të madhe të kohes ia kushtonim filmit të ardhshëm. Sa të miratohet, do ta përkthejmë skenarin në anglisht dhe do ta dërgojmë në Euroimazh. Dhe ëndrrat

s’kishin fund. “Unë kam një ëndërr” më kujtoheshin fjalët e Martin Luther King.

Dhe buzëqeshja e tij ishte e tjetërllotjë, hapi i tij elastik prej të riu që i ka dalë e drejta e studimit dhe niset për në Universitet. Të gjitha ëndrrat e filmave qenë realizuar, tani priste një triumf të fundit, ndoshta, një Kengë Mjellme, më tepër vetjake, se sa për të tjerët. E quante si plotësim të të gjitha ëndrrave. Ishte ende një vrimë e zezë, një vrimë ozoni qe nxinte. Diçka eterne, si një fiksion emblemantik. Zgjohej me të, e kalonte ditën me të, shikonte ëndrra me ëndrrën. Një natë e kaluar me ëndrra për ëndrrën, këtë më tha një ditë me shqetësim. E kishte një dyshim, një si parandjenjë zhgënjyese, sepse e shikonte se ç’bëhej. Më tha një ditë me humor; e di, Roland, ç’thonë për Qendrën e Filmit disa të rinj? Ec shkojme andej nga Kinostudioja se mos bojmë ndonjë dorë pare...

Pjesa më e madhe e filmave të tridhjetë viteve të fundit kishin përfunduar në harresë. Atje provohej dhe dështohej. Me aq pak para që jepej për filmin duhej një talent i madh që ta përballonte atë rrugë drejt Golgotës. Po talentet e vërtetë janë shumë të rrallë dhe prandaj kishte dalë ajo gastrole tallëse. Por unë do të bëj një film të mirë, e ndiej, natyrisht me një mbresë dyshimi që herë më rritet e herë më pakësohet. Ky do të jetë talismani im, filmi i fundit, më thoshte Kristaqi i përfshirë në ëndrrën e tij. Të them të vërtetën, unë nuk besoja kurrsesi, sepse e shikojta me sy të ftohtë gjendjen e Qendrës, zhytur në një mjerim artistik. Duke shtyrë dëshpërimisht diellin e sukseseve, siç largojmë perden për të parë më mirë jashtë, asgjë e re, por veç fluska entuziaste përplot ngjyra që të marrin mendtë. Premiera me zulmë e bujë, salla plot me miq e gazetarë të paguar, darka dehëse, çmime hipotetikë, tek e fundit asgjë e re. Nihilizëm? Jo, realitet. Ku ishim? Atje ku u nis. Përsëri e përsëri shikohen filmat e vjetër, megjithë mëkatin ideologjik që i shoqëron mjerueshëm. Aty-këtu ndonjë fushqetë shprese që shuhet shpejt. S’ka para as për filma, as për dokumentarë, as për teatër, as për... por lavdia është e madhe! Me sikur... bëhet, sidoqoftë! Me sikur... ç’zhgënjim! Shikoj çdo natë nga një film të ri te kanali; Film autor. Mjeshtëri e lartë, Roland! Dhe më përmendëte emra regjisorësh që nga Felini, Trajkovski, Vajda, Polanski, Spilbergu, Kubriku... Shkonte çdo ditë te një tregtizë te rruga e Kavajës dhe blinte kaseta me filma. Ishte gëlltitësi më i madh optik dhe lexuesi më i zellshëm i letërsisë së mirë. Njohës i shkëlqyer i teknikës së filmit, provues i krisur i metodave te reja, tejet i suksesshëm si regjisor, filmat e tij

shihen gjithmonë, por sot çuditërisht dyert për të mbeten të mbyllura. Dhe për kastën e kineastëve të vjetër, mësuesve të kineastëve të rinj. Është një refuzim elegant duke i mburrur e përgëzuar, por gjithsesi duke i përjashtuar. Sidoqoftë ëndrra është atomike, ajo s’pyet për dyer të mbyllura. Me këtë iluzion përkëdhelës mund të krijosh një jetë të dytë, atë të artistit kokëforte që s’pyet për dyer të mbyllura. Këtë jetë të dytë bënte Kristaq Mitro.

Kushedi sa libra më ka dhuruar; që nga romanet e Bukowskit, Saramagos, Modianosë... e gjer te klasikët e mëdhenj; Hygo, Balzak, Tolstoi, që unë s’i kisha më, se m’i kishin vjedhur. Më ofronte literaturë kinematografike, më shpjegonte sekretet e teknikes se filmit, të regjisurës në përgjithësi, të aktorit, operatorit, rrinte me orë të tëra duke skicuar mjedise dhe personazhe , pastaj i prishte e serish ia niste nga e para. Iluzioni nuk e lodhte, jeta e rraskapiste. Jeta e artistit në një kohë refuzuese.

Shkonte shpesh te libraria Adrion dhe pyeste për librat e rinj. Por një ditë nuk mund të shkonte më. Ishte koha kur vajzat e Conadit i nxirrnin karrigen për t’u ulur. Skenari nuk u pranua. Kjo ishte një goditje për të, goditja e dytë që merrte, pa e pranuar si arsye, por duke e pranuar si realitet, që kurrsesi nuk i pëlqente. Por e mbloodhi veten shpejt, dukej sikur nuk u trondit dhe aq shumë. S’kam kohë thoshte, po ma vrasin dhe kohën. Ishte vajza dhe dhëndri i tij, ata që i premtuan t’ia gjenin paratë. Por s’ishte puna vetëm te paratë, duhej të lëvizte nëpër Europë, të gjente shtëpi filmike, partnerë, bashkëpunëtorë, se filmi nuk bëhet vetëm. Pastaj erdhën tërmetet, pandemia, izolimi, që ndikuan fuqishëm dhe në psikikën e tij. Në vitin 2000 m’u ankuar për një dhembje të qafës. Ndoshta kam cervikale, më merrën pak mendtë, më thoshte me njëlloj frike. Nuk ecte më aq lehtë, nuk e kishte atë buzëqeshje aq vëllazërore. Dhe komunikimit me të në Messenger sikur i erdhi një ngadalësim, njëlloj mungese dëshire. Ishte kapluar nga depresioni, që s’donte kurrsesi ta pranonte. I shmangej të vërtetës, mbyllej në ëndrrën e tij dhe mbyllte deren pas vetes. Donte të ishte fillikat vetëm në ëndrrën e tij. Sikur u mbyll pak në vetvete, s’jepej, edhe kur unë bëja përpjekje për ta nxjerrë nga ajo gjendje e çuditshme. Dhe ia arrita, ai më pranoi në ëndrrën e tij. Ç’duhej bërë për ta rigjallëruar? E mbaja fort të lidhur pas ëndrrës, i jepja kurajë, se gjithçka ishte e mundshme, se ai s’kishte asgjë serioze, një dhembje cervikaleje dhe aq. Ëndrra. Po ta lija jashtë saj, fillonte kallkanosja e fjalëve. Nuk mund të përmend gjithë atë kohë që kemi komunikuar bashkë, sepse zë shumë vend, por po shkëpus nga Messengeri fillimet e tij me filmin e parë; Dimri i fundit.

MESSENGER, FRAGMENTE.

Unë: S’më the gjë për Dimrin... Si doli film aq i mirë, ku qëndron sekreti?

Ai: Skenari ishte ndërtuar thjeshtë, gratë luajtën veten.

Ndihmoi shumë dëbora dhe të ftohtit e madh.

Unë: Dëbora duket që ka luajtur rol, është parë nga një sy...nga syri yt sikur të ishte një personazh.

Ai: Po.

Unë: Ndihmoi dhe muzika e Aleksandër Lalos.

Ai: Po... edhe kërkesa për një aktrim realist deri në “kockë.” Bora hidhej me lopata përpara helikave të ventilatorit.

Unë: Keni patur ditë që s’keni xhiruar dot?

Ai: Po, shumë ditë për shkak të mjegullës së madhe. Dhe të natës që vinte shpejt. Në fillim kemi vuajtur shumë me digat ruse... shumë... peshonin nga 100 kg secila... Nuk kishte burrë nëne që i lëvizte. Dhe erdhi Dhamo, na shpëtoi. Na solli tre diga Arifleks, 25 kg njëra. Ishin gjermane, të saponxjerra nga kutia. Të mrekullueshme. Dhe kablo me trashësinë e gishtit që tërhiqeshin lehtë në dëborë. Ah, sa këshilla praktike më ka dhënë! Mos trego, më thoshte, kur lëviz pikën e xhirimit. Se ke shumë informatorë rreth teje... Gjithashtu më shpetuan dhe këpucët e diversantëve (kështu

(Vijon në faqen 23)

Marc Chagall arriti në New York në Qershor 1941, duke mbajtur një reputacion të madh botëror arti por bagazhe të lehta. Veprat e tij folklorike po vinin veças në një anije nga Spanja – ose të paktën kështu mendonte ai – si aktorë mbështetës në një hile që i mundësoi artistit hebre të shpëtonte nga një Evropë gjithnjë e më e pushtuar nga nazistët.

Alfred H. Barr, drejtor i Muzeut të Artit Modern në New York, e ftoi Chagall-in për të çelur një ekspozitë solo si një marifet për të marrë vizën amerikane. Mbështetur prej organizatave hebraike-amerikane dhe koleksionistëve që paguan për udhëtimin e tyre, artisti dhe gruaja e tij Bella, përfituan nga kjo mundësi dhe u larguan nga Franca sa më shpejt që mundën. Morën sa mundën, por në mënyrë të pashmangshme lanë pas disa thesare të çmuara.

Një prej këtyre ishte fëmija i vetëm i çiftit, Ida, e cila nuk arriti të merrte vizë me anë të ftesës së Barr-it. Tjetri ishte ngarkesa me pikturat e artistit.

Para se të largohej nga Europa, Chagall-i u përpoq të niste për në SHBA, valixhe me kanavacët e tij plot ngjyra që shfaqnin lopë, fyellistë, dhe fshatarë rusë. “Kapitali më i madh i Chagall-it ishin pikturat e tij”, shpjegon Susan Tumarkin Goodman, kuratore e nderuar te Muzeu Hebre në New York, e cila organizoi ekspozitën “Chagall: Dashuri, Luftë, dhe Dëbin” në 2013. Por artisti, sidoqoftë, nuk kishte bërë marrëveshje që njëzetepesëvjeçarja Ida dhe i shoqi i saj, Michel Gordey, të kapërcenin Atlantikun drejt sigurisë.

“Ishte tepër urgjente për të bërë plane të tjera,” vuri re Galya Diment, një profesore e letërsisë ruse e cila ka bërë kërkime mbi marrëdhënien e Chagall-it me Ida-n, rrethanave kaotike mes të cilave artisti (i cili shkurtimisht u

Artisti Marc Chagall dhe e bija e tij Ida Chagall, 1945



SI I KONTRABANDOI E BIJA E SHAGALLIT PIKTURAT E TIJ NGA EUROPA E PUSHTUAR PREJ NAZISTËVE

Nga Karen Chernick

arrestua nga policia Vichy në Marseille) u largua nga Franca. “Patjetër që ishin të shqetësuar për mirëqenien e Ida-s por menduan se Chagall-i, prej dukshmërisë së tij, ishte në rrezik të vërtetë për t’u arrestuar sërish dhe për t’u dërguar në kampe,” vijon Diment. Jo vetëm që Chagall-i ishte hebre, por nazistët

gjithashtu e kishin etiketuar si artist “të degjeneruar”.

Kështu që Chagall-i dhe Bella u arratisën me nxitim, duke i dhënë fund dy vjet shmangie nga Rajhu i Tretë. Çifti u largua nga Parisi në 1939, duke migruar gjithnjë e më në jug ndërkohë që trupat gjermane i afroreshin kufirit verior

francez, duke transportuar sërish arkat me vepra arti me çdo shpërngulje.

Kur Chagall-ët mbërritën në Amerikë, zbuluan se dogana spanjolle kishte sekuestruar arkat e tyre. I shqetësuar, Chagall-i i shkroi Ida-s, ende të bllokuar në jug të Francës. Ajo filloi një përpjekje heroike për të shpëtuar veprën e të atit nga humbja në luftë, dhe udhëtoi vetë për në Spanjë për t’i liruar arkat.

Michel, pak ditë më vonë, u arrestua në kufirin spanjoll, duke i shtuar përpjekjes së Ida-s për të liruar pikturat e Chagall-it nga dogana, nevojën për të nxjerrë të shoqin nga burgju. Ajo ia doli të dyjave me zgjuars. “Ida luajti harpën burokratike me aftësi dhe këmbëngulje, duke tërhequr telat e duhur,” shkruan Sidney Alexander, biografia e Chagall-it.

Pastaj u shfaq një pengesë tjetër në dukje e pamundur: zor se po largohej ndonjë anije nga Europa.

Në fund të verës së 1941, ishin të pakta anijet si ato Mouzinho të refugjatëve që çuan çiftin Chagall në New York. Me pak fat – dhe para nga prindërit e tij – Michel bleu dy bileta të shtrenjta nga \$600, që vlejnin \$11,000 sot (Chagall-ët nuk kontribuan), i hipën një anije refugjatësh hebrej. Më ambicie, çifti tentoi të hipte jo vetëm me jetën e tyre, por edhe me një arkë të madhe me piktura të Chagall-it.

Të nxirrje piktura kontrabandë nga Europa gjatë fillimit të tërbuar të Luftës së Dytë Botërore nuk ishte e lehtë, edhe me mjete. Koleksionistja hebreje-amerikane Peggy Guggenheim bleu furishëm piktura nga artistët më të mirë bashkëkohorë në Paris deri në pushtimin gjerman në 1941, ajo i nxorri nga Europa duke mbështjellë kanavacat në një ngarkesë batanijesh e pëlhurash.

Këto kushte të rehatshme ishin shumë më superiore ndaj rrethanave në të cilat Ida, Michel, dhe një arkë 2-me-2-me-3 metra me vepra arti, u përballën së fundmi në anijen me avull *Navemar* në gusht 1941. Anija, e ndërtuar për të akomoduar ngarkesa dhe 15 njerëz, shpejt u mbush me 1,180 pasagjerë (plus katër dema të gjallë që shërbyen si furnizim me mish gjatë udhëtimit 40-ditor në mungesë të frigoriferëve). Kushtet ishin mizore, por kjo ishte mënyra e fundit e refugjatëve për t’u arratisur, disa prej të cilëve vdiqën, dhe trupat e tyre u hodhën në det.

Anija e famshme *Navemar* u largua nga Lisbona në 17 gusht. Në New York, Chagall-ët shpejt lexuan në gazeta përshkrimet e udhëtimit. “Lexojmë sot... se ‘Navemar’ është një kamp pluskues përqendrimi”, i shkroi i dëshpëruar Chagall-i Morris dhe Ethel Troper, drejtorët europianë të organizatës së ndihmave American Jewish Joint Distribution Committee. Në një mesazh tjetër, Chagall-i përshkruan një letër të cilën ia kishte dërguar Ida kur u ngarkua anija në Lisbon. “Ishin të sëmurë, me temperaturë 40 gradë, pa mjekime, pa ujë, pa ushqim,” u ankua Chagall-i. “Nuk flemë natën. Nuk mund të hamë, duke menduar se si jetojnë si kafshë fëmijët në kushtet më të këqija.”

Ida dhe Michel po jetonin vërtet si kafshë, mes kafshëve. Çifti udhëtoi në kuvertë – ku gjithashtu ishte një stallë me dema – për të shmangur dëmtimin e pikturave nga lagështia. Është e paqartë se sa vepra solli Ida në *Navemar*; sidoqoftë, do të ishte sfiduese në një anije ku çdo centimetër përdorej për të shpëtuar jetë njerëzore.



Marc Chagall, *Ditëlindja*, 1915



Marc Chagall, *Promenade*, 1918

Gjithsesi, Ida, Michel, dhe pikturat i mbijetuan udhëtimit. Intuita e saj për të udhëtuar në kuvertë qe me mend, duke qenë se gjithë bagazhet në anije ishin kalbur dhe u hodhën në New York.

Ida mund t'i ketë vazhduar heroizmat e saj pas luftës, në 1945, sipas pasardhësve të Konrad Kellen, një ushtari amerikan që shërbeu në Europë në ato vite. Në historinë e pakonfirmuar të Kellen-it, Ida u afhua në një kafene parisienne, dhe e pyeti nëse do të kthehej në shtëpi. Kur iu përgjigj se po, ajo e bindi të transportonte një pirg të madh të kanavacave të babait të saj (dhe të mbante një për vete, në shenjë mirënjohjeje). Kellen pranoi jo fort me dëshirë, duke i përcjellë pikturat

përmes shiut (e me siguri në kushte të tjera të rrezikshme) përgjatë një muaji para se të arrinte në Amerikë.

Vitin e ardhshëm, në 1946, Chagall çeli ekspozitën e tij solo te MoMA, si ajo që i kishte premtuar Barr në fillim të luftës. Ishte një mirëseardhje për në normalitetin e karrierës së tij pas vitesh kaosi global e personal. Në pasojat e menjëhershme të holokaustit, shfaqja nxori në pah një artist hebre në lulëzim – dhe pikturat prizmatike të dashnorëve duke pluskuar, të gjelave të mëdhenj, dhe lepujve të menduar të cilat do të ishin zhdukur po të mos kishte qenë për vendosmërinë dhe trimërinë e Ida-s.

Përktheu Enxhi Hudhri



Marc Chagall, *Kryqëzim i bardhë*, 1938

(Vijon nga faqja 21)

i qanimit) që ishin me bateri. Ato... vetëm ato! Në dëborë këmbët e mia ishin valë të ngrohta.

Une: Edhe unë po të mos mbathja këpucë ushtarake, nga ato të zboreve, me kambale, s'do ta kisha të gjatë në Pukë...

Ai: Eliana më thuri me shtiza dy palë çorape leshi. Fusja kartona në gjoks. Pastaj kërkuam ushtarë se kishte ujë. Na sollën dhe një doktor.

Në këtë kohë ai dhe Eliana, e shoqja, nuk kishin shtëpi, e kalonin herë në një hotel, herë në një tjetër; Pensioni, Parku, Vjosa... Dy episode nuk do t'i harroj asnjëherë. Paraja nuk u dilte. Ishte e vështirë të qëndroje gjatë në një hotel. (Në hotel lindi dhe fëmija e parë) Ishin dy bohemianë të kinemasë, të ëndrrës, dy varfanjakë që kishin si monedhë të fortë, celuloidin, imazhin. E di ç'bëja Roland, më tregonte Kristaqi, i thoja dezhurnit te RGL-së (Rojas së Gatishmërisë Luftarake të Kinostudios) që merrte turnin e natës në gjashtë pasdite; shko fli në shtëpi, se na nxorrën nga hoteli, dua të vijë me Elianën të flejë këtu! S'gjetëm hotel tjetër. Po sikur të ketë vërtet alarm ajror? Po sikur të vijë kontrolli? përgjigjej ai. Ishte frikë e madhe të bëje nga këto prapësi, të thyeje rregullat ushtarake. Mund të pushoheshim të dy nga puna. Dëgjo, i thoja, bëje për mua, për Elianën, ajo është shtatzënë, ku të flemë, në stolat e parkut? Mirë, po në gjashtë të mëngjesit mbathjani, mos t'iu gjejë ai i turnit të parë. Ishte një dhomë e vogël me një shtrat, një tryezë, një telefon dhe një sahat me zile. Na dukej gjë e madhe, kishim gjetur shtëpi.

Dhe episodi tjetër, i paharruar. Për shkak të reformave, Kinostudioja u mbyll. S'mbeti njeri, të gjithë s'dinin ku të fusnin kokën. Pak personel mbeti, por askush s'vinte në punë. Vitet më të errët, ku njerëzit nuk punonin dhe kioskat pushtuan Tiranën. Po kishte shumë entuziazëm. Përditë mitingje, thirrje gjëmimtare; E duam Shqipërinë si Europën. E di Roland, as vetë nuk e besoj tani se si ndodhi, pushimet e verës i kaluam në Kinostudio. Ishim fillikët vetem, unë dhe Eliana. Pa para, të mbytur prej një nostalgjie të hidhur që e humbëm tempullin tonë. Eliana s'ma priste, e dinte dalldinë time për atë Eldorado ku kisha gjetur arin kinematografik. Arin me të cilin s'blije dot shtëpi, po ëndrra të mëdha. Ajo ishte inxhinieri, po asnjëherë s'ma prishi. E donte artin, më donte mua, e donte dhe ajo atë vend të shenjtë qe më kishte bërë të njohur. Pesëmbëdhjetë ditë në Kinostudion e zbrazët, roje të saj, ku vinin veç zogj, spektator nostalgjikë, se netëve shikonim filma në studion e vogël te kinofikimit, filma me pullë të kuqe, filma të ndaluar. Mbaj mend se aty kam parë “Tetë e gjysmë” dhe “Amarkord” të Felinit, “ Nata” të Antonionit, “Martesë italiane” të De Sikës, “Muzgu i perendive”, të Viskontit, filma të Vajdës, të Kurosavës, të Bondarçukut, Skollomovskit... Hanim pak, se s'kishim, po ngopesim me filma. Dhe kur ikem ndezem dy qirinjtë të shkallët e Kinostudios dhe u lutëm për filmin, si për një shpirt. Dhe tani, Roland, unë jam i harruar. Dy herë më kanë refuzuar të bëj film këta pinjojtë e rinj. Mosmirënjohja është gjëja më e keqe në botë, shkruhet në Bibël. Të gjithë kolegët e mi u bënë “Mjeshtër të Mëdhenj,” për mua s'u kujtua njeri. Nuk na duan, iu duket se ylli ynë ka perënduar me kohë. Prandaj jam kaq i mërzitur. Mjeku vienez, kur me bëri operacionin e parë, më tha; e ke nga stresi, nga puna e lodhshme. Po, ai e gjeti, kam qenë maniak, pasi i rishkruaja episodet gjer në hollësinë më të marrëzishme, bëja skica për secilin personazh, mjedis... Në fakultet jam shquar si karikaturist, më jepej për pikturë. I kam në shtëpi të gjitha skicat e filmave të mi. Dhe në sheshin e xhirimit e ndieja si harxhohesha trup e shpirt. I ndryshoja gjërat, gjithmonë vija syrin në lupën e kameras për të gjetur pozicionin e duhur. Dhe kufiri i natës dhe ditës u zhduk. Ja, ku mbërrita, te stacioni i shëndetit, të lënë pas dore prej punës. Tani s'mund të udhëtoj më, ndonese autobuzi më pret, por do t'ia dal, filmin do ta bëj! Edhe kur u krye operacioni i dytë ai përsërishte; jam ketër. Si ai eci... Por kjo nuk zgjaste shumë, ai s'ërrish mezi ecte. Viena e magjepste. Sa herë kthehej ai serish thoshte; tani kam ecjen e një kaprolli. Do të merrem me filmin.

Ëndrra e tij. Dhe aty, në atë zonë shpëtuese, e fusja gjithmonë, sepse artisti është shpirt, e harron trupin. Aty donte të mbetej, te ai oaz, ç'mbetej përtej ishte shkretëtirë. E ndiente gjer në kockë perjashtimin, harresën. Roland, Shqipëria më dha lumturinë, tani po më vret! Pse s'duan që unë të bëj film? Unë s'jam ndonjë mediokër, jam profesionist. Sa fillestarë marrin para dhe bëjnë filma të dështuar?

Ç'është ky instinkt i turbës që pa ditur kurrëgjë di gjithçka e qe po kthehet në model? Jemi pjesë e një lirie pa cak që është kthyer në të kundërtën e vet. Këtë e thotë dhe Kamy. Qenka sëmundje botërore, por që tek ne bën spikamë të madhe, alarmante. Më duket sikur jetoj në mes të një talljeje dhe të një neverie që më zhbën si identitet, si artist. Apo e kam gabim? Ç'ti thoja? A mund të shikohej ajo fytyrë aq e pikëlluar, pa i ulur sytë? Dhe ato çaste unë, i përfshirë nga një tërbim i sinqertë (me falni per jomodestine) mendoja se, po të isha drejtor i Qendrës do ta lusja të bënte film dhe sot ai ndoshta do të ishte gjallë. Jo i vdekur para dyerve të mbyllura prej zilisë, poshtërsisë, injorancës. Dhe kush isha unë? Një artist ende gjallë para dyerve të mbyllura. Kudo djer të mbyllura.

Autobuzi e priste, po ai s'hipte dot, nuk kalonin as dy tri ditë dhe ai i kthehej sërish gjendjes së mëparshme. Mezi ecte. Dhe më në fund, kur ngrihej nga kafeneja, e priste ajo karrigja te Conadi, ajo mirënjohje e vazhate që ia kishin parë filmat dhe e nderonin. Viena nuk po bënte dot gjë, s'po e shëronte, po ai e adhuronte atë gjer në mahnitje. Dëgjoj si bien kambanat, më thoshte, dhe pastaj bie menjëherë muzgu. Ata tinguj kanë aromë. Më kujtohet nëna që bënte kryqin. Vërtet Roland, siç thua dhe ti për Nju Jorkun, aty edhe ajri ka muzikë, ka film.

Viena, operacioni i tretë, ndërhyrja vendimtare. Të pres, i shkruaja, edhe unë mendoj se filmi do të bëhet, por tani le të merremi ca me shëndetin, ç'ti bësh, i dashur mik, jemi prej mishi, jo prej hekuri. Në verë kur te vij atje do te merremi me filmin. Kjo më kishte mbetur, t'i përkedhelja ëndrrën. Vetem keshtu e vija plotësisht në gjendjen e një ekstaze të shpikur, të shndërrimit të ëndrrës në filmin e ardhshëm. Dhe më vinte prej larg kënga e fundit e mjellmës. Por, a do të kishte këngë të fundit? Ai më përgjigjej; po, sa të kthehem bashkë me Elianën do të shkojmë te Kepi i Rodonit (atje, e bija kishte ndërtuar një resort të mrekullueshem), është shumë qetësi dhe gatuhet mirë.

Nga data 7 gjer në 24 mars asnjë përgjigje. I shkruaja, po s'më përgjigjej njeri. Diçka parandjeva, por nuk doja ta mbaja mendjen aty. Eliana më ktheu përgjigje; “Përsëndetje, Roland! Ishte fat që nuk u kthyem në Tiranë se një natë përpara Kristaqit i filluan ca dhembje të forta, të padurueshme në të gjithë trupin. Mjeku na tha se ka të bëjë me nervat e trupit. E shtruar me urgjencë në spital. Dhembjet e forta vazhduan nga data 7 deri para dy ditësh. E qetësonin vetëm me morfinë. Nga dhembjet është më mirë, por pësoi hemoragji cerebrale. Po e mbajnë në regjim monitorimi, çdo gjashtë orë i bëjnë tomografi të kokës. Deri tani është jashtë rrezikut.

Por unë këmbëngulja të dija më tepër, vazhduan pyetjet e mia të nesërmen, të pasnesërmen, gjersa më erdhi përgjigjeja tjetër nga Eliana; Kristaqi këto dy ditë është njëlloj. Nesër besoj do t'i bëjnë rezonancën e kokës për të par gjendjen e hemoragjisë. Qëndrimi shtrirë po i shkakton probleme të tjera. Të shpresojmë shërimin e shkaqeve kryesore e pastaj me radhë.

Me vone erdhi lajmi i vdekjes. Kishte ndodhur një hemoragji e dytë të cilën ai nuk e kishte përballuar dot. Në fillim nuk e besova siç ndodh në këto raste kur humb përfundimisht një mik. Dhe ato çaste gati sa nuk thashë me zë; jo, një kirurg i zakonshëm, jo, qoftë dhe primari, duhej një kirurg artist që të dinte të operonte ëndrrën. Ajo ishte goditur për vdekje!

Ai nuk i dëgjoj kambanat e Vienes kur ranë dhe gjithmonë i kujtonte nënën teksa bënte kryqin dhe lutej, as muzgun nuk e pa, muzgun vienez aq blu dhe të shndritshëm. As Elianën e tij, as vajzat, as... Patjetër në orët e pakta të kthimit të vetëdijes, në atë grimë filmi të ëndrrës, ai e pa filmin e tij të fundit që ia refuzuan. Shqipëri, ti të vret!


STEPHEN A. SCHWARZMAN

Kryetar bordi, CEO dhe
bashkëthemelues i Blackstone

Rruga drejt suksesit

Mësime
në kërkimin
e përsosmërisë

Minerva



*New York
Times
Bestseller*